

SQ

SQ

Error! Unknown document property name. SQ



KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 9 nëntor 2010
SEC(2010)1329

DOKUMENTI I PUNËS SË STAFIT TË KOMISIONIT
RAPORTI I PROGRESIT 2010 PËR KOSOVËN*

i shoqëruar nga

**KOMUNIKATA E KOMISIONIT PËR
PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN**

Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011

{COM(2010)660}

* Nën RKSKB 1244/1999

PËRMBAJTJA

| | | |
|---------|---|---|
| 1. | Hyrje..... | 2 |
| 1.1. | Parathënie..... | 2 |
| 1.2. | Konteksti..... | 2 |
| 1.3. | Marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës..... | 2 |
| 2. | KRITERI POLITIK..... | 2 |
| 2.1. | Demokracia dhe sundimi i ligjit..... | 2 |
| 2.2. | Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave..... | 2 |
| 2.3. | Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare..... | 2 |
| 3. | Kriteret ekonomike..... | 2 |
| 3.1. | Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut..... | 2 |
| 3.2. | Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit..... | 2 |
| 4. | Standardet evropiane..... | 2 |
| 4.1. | Tregu i brendshëm..... | 2 |
| 4.1.1. | Lëvizja e lirë e mallrave..... | 2 |
| 4.1.2. | Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes..... | 2 |
| 4.1.3. | Lëvizja e lirë e kapitalit..... | 2 |
| 4.1.4. | Doganat dhe tatimet..... | 2 |
| 4.1.5. | Konkurrenca..... | 2 |
| 4.1.6. | Prokurimi publik..... | 2 |
| 4.1.7. | Ligji për pronën intelektuale..... | 2 |
| 4.1.8. | Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik..... | 2 |
| 4.1.9. | Arsimi dhe hulumtimet..... | 2 |
| 4.1.10. | Çështje që lidhen me OBT-në..... | 2 |
| 4.2. | Politikat sektoriale..... | 2 |
| 4.2.1. | Industria dhe NVM-të..... | 2 |
| 4.2.2. | Bujqësia dhe peshkataria..... | 2 |
| 4.2.3. | Mjedisi..... | 2 |
| 4.2.4. | Politikat e transportit..... | 2 |
| 4.2.5. | Energjia..... | 2 |
| 4.2.6. | Shoqëria informative dhe mediat..... | 2 |
| 4.2.7. | Kontrolli Financiar..... | 2 |
| 4.2.8. | Statistikat..... | 2 |
| 4.3. | Drejtësia, liria dhe siguria..... | 2 |
| 4.3.1. | Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi..... | 2 |

| | | |
|--------|---|---|
| 4.3.2. | Pastrimi i Parave | 2 |
| 4.3.3. | Narkotikët..... | 2 |
| 4.3.4. | Policia..... | 2 |
| 4.3.5. | Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit..... | 2 |
| 4.3.6. | Mbrojtja e të dhënave personale | 2 |

DOKUMENTI I PUNËS SË STAFIT TË KOMISIONIT

Raporti i Progresit 2010

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Që nga marsi i vitit 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit rreth progresit të vendeve të rajonit të Ballkanit perëndimor.

Ky raport ka strukturë kryesisht të njëjtë me ato të viteve të kaluara. Raporti:

- Shpjegon shkurtimisht marrëdhëniet në mes të Kosovës¹ dhe Unionit;
- Analizon situatën politike në Kosovë sa i përket demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve dhe çështjeve rajonale;
- Analizon situatën ekonomike në Kosovë;
- Rishikon kapacitetin e Kosovës në implementimin e standardeve, që do të thotë, përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me ato të *acquis*, sipas prioriteteve të Partneritetit Evropian.

Periodha e mbuluar nga ky raport është nga mesi i shtatorit 2009 e deri në fillim të tetorit 2010. Progresi është matur në bazë vendimeve të marra, miratimit të legjislacionit si dhe masave të implementuara. Si rregull, legjislacioni apo masat, që janë në përgatitje e sipër apo duke pritur aprovimin e Parlamentit, nuk janë marrë parasysh. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë të të gjitha raporteve dhe mundëson një vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informata të grumbulluara dhe të analizuara nga Komisioni. Janë shfrytëzuar edhe shumë burime tjera, duke përfshirë kontributet nga autoritetet e Kosovës, shtetet anëtare të BE-së, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, EULEX-i, raportet² e Parlamentit Evropian, dhe informatat nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare.

Komisioni jep konkluzione të detajuara për Kosovën, përmes një komunikate të veçantë për zgjerimin në bazë të analizës teknike që përmban ky raport.

1.2. Konteksti

Në muajin korrik, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) doli me një opinion këshillëdhënës, i cili theksonte se deklarata e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare apo rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me 9 shtator, miratoi një rezolutë të përbashkët, të paraqitur nga Serbia dhe e bashkë sponsoruar nga vendet anëtare të BE-së, si vazhdimësi të opinionit të GJND-së. Rezoluta ka për qëllim që t'i hap rrugën procesit për dialog në mes të Prishtinës dhe Beogradit, të promovojë bashkëpunimin, të arrijë progres drejt rrugës në Bashkimin Evropian dhe të përmirësojë jetën e njerëzve.

Deri sot, Kosova është njohur nga 71 vende anëtare të OKB-së, duke përfshirë 22 vende anëtare të BE-së.

¹ Nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99

² Raportuesi i PE në Kosovë është znj. Ulrike Lunacek.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së doli me katër raporte për Kosovën — në shtator 2009, në janar, prill dhe qershor 2010. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se rrethanat e ndryshuara në terren kanë çuar në përmirësimin gradual të funksioneve dhe prioritetëve të misionit të OKB-së në Kosovë. Qëllimi strategjik i misionit është që të promovojë sigurinë dhe stabilitetin si dhe të respektojë të drejtat e njeriut.

KFOR-i, prezenca ushtarake e udhëhequr nga NATO, vazhdon të kujdeset për sigurinë në tërë Kosovën. Gjatë periudhës së raportimit, prezenca e saj është reduktuar gradualisht. Në këtë kontekst, Policia e Kosovës ka marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e objekteve të caktuara kulturore dhe fetare.

Situata në Kosovën veriore mbetet e tensionuar, por stabile. Autoritetet kosovare hapën një zyre për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Emërimi i patriarkut Ortodoks Serb ishte i organizuar sipas traditës në objektet patriarkale në Kosovë. Ceremonia e emërimit u bë në një atmosferë paqeje nën mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës. Mungesa e dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës ka parandaluar progresin drejt përmirësimit të jetesës së komuniteteve vendore.

Në korrik, Kosova nënshkroi një marrëveshje *stand-by* me FMN.

Në muajin shtator, Gjykata Kushtetuese vendosi që mbajtja e dy pozitave në të njëjtën kohë, ajo e Presidentit të Kosovës dhe e Kryetarit të Partisë politike, është në kundërshtim me Kushtetutën. Pas vendimit, Presidenti i Kosovës dha dorëheqje. Më pas, LDK-ja u tërhoq nga koalicioni qeverisës. Zgjedhjet janë caktuar të mbahen me 12 dhjetor.

1.3. Marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës

Kosova është pjesë e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Procesi i dialogut të Stabilizim-Asociimit (PDSA) filloi në muajin janar. Faza e parë e takimeve mbaroi në korrik. Sektorët e mbuluar përfshijnë "drejtësinë, lirinë dhe sigurinë"; "inovacionin, shoqërinë informative, politikën sociale"; "tregun e brendshëm, konkurrencën, mbrojtjen e konsumatorit/shëndetit"; "çështjet ekonomike dhe fiskale"; "transportin, energjinë, mjedisin, zhvillimin rajonal" dhe "bujqësinë, peshkatarinë, pylltarinë, sigurinë e ushqimit". Në korrik, Kosova mbajti takimin plenar të PDSA dhe takimin e parë të dialogut të shoqërisë civile të PDSA, që u bashkë-kryesua nga Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social. Për të promovuar dialogun ekonomik, mekanizmi i vëzhgimit fiskal dhe Komisioni Evropian vazhduan me mbajtjen e takimeve dy herë në vit.

Në nëntor të vitit 2009, një delegacion i anëtarëve të Parlamentit Evropian e vizitoi Kosovën në lidhje me zgjedhjet lokale. Në korrik, Parlamenti Evropian adoptoi rezolutën për Kosovën. Kjo i inkurajoi vendet anëtare të BE-së që të përshpejtojnë qasjen e tyre unike ndaj Kosovës. Parlamenti Evropian nënvizoi se perspektiva e hyrjes në BE është një stimulim i fuqishëm për kryerjen e reformave të nevojshme në Kosovë dhe i bëri thirrje qeverisë dhe qytetarëve që të ndërmarrin hapa praktike për ta bërë këtë perspektive më të prekshme.

Misioni i sundimit të ligjit të BE-së (EULEX), vazhdon të operojë dhe të përmbushë mandatin e vet. Situata në veri të Kosovës ka pasur ndikim në aktivitetet e EULEX-it, si për shembull prezenca e vazhdueshme e zyrtarëve të doganave në portat 1 dhe 31 si dhe stafin në Gjykatën e Mitrovicës. Gjithashtu, EULEX-i ka bërë disa arrestime në veri. Ka pasur një numër të kërcënimeve dhe sulmeve kundër personelit të EULEX-it. Situata duhet të normalizohet. BE-ja ka rikonfirmuar angazhimin e saj për Kosovën, duke e hapur një Shtëpi të BE-së në veri të Mitrovicës. Ambasadori Italian në Kosovë është caktuar si ndihmës/facilitator për veri. Shefi i Zyrës Ndërlidhëse Greke në Prishtinë është caktuar si facilitator për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze në Kosovë. Ata kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushat e

tyre përkatëse. Kjo e ka rritur dukshmërinë dhe influencën e BE-së. Autoritetet duhet të sigurojnë bashkëpunim dhe mbështetje të plotë dhe të pakushtëzuar për EULEX-in.

Në muajin shkurt, Këshilli i BE-së e zgjati mandatin e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë për 6 muaj. Mandati u zgjat në muajin gusht edhe për gjashtë muaj tjerë. Përfaqësuesi Special i BE-së është po ashtu edhe përfaqësues ndërkombëtar civil në Kosovë.

Në prill, Kosova mbajti forumin e dytë të nivelit të lartë për koordinim të donatorëve. Qeveria raportoi tek donatorët rreth progresit të arritur sa i përket koordinimit të donatorëve. Ky forum është krijuar si mekanizëm për të shqyrtuar dhe vlerësuar progresin e zhvillimeve socio-ekonomike dhe efektivitetin e ndihmës së dhënë në Kosovë.

Kosova vazhdon të përfitojë nga Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (IPA), ndihma makro-financiare, Instrumenti për Stabilitet (IfS) dhe burime tjera të fondeve. Kosova merr pjesë në programet shumë-përfituese të IPA-së, duke përfshirë edhe paketën e reagimit të IPA-së në rast krizash, të krijuar në vitin 2008. Paketa do të jetë funksionale në vitin 2010. Një shumë prej 508 milion € nga ndihma e BE-së i janë dhënë Kosovës për periudhën 2008–2011. Në shtator, Komisioni bëri transferimin e pjesës së parë të ndihmës makro-financiare për Kosovën.

Është duke u përgatitur dokumenti planifikues indikativ shumëvjeçar për vitet 2011-2013. Ky dokument do të identifikojë fushat kryesore dhe prioritetet për ndihmat e IPA-së.

Gjatë vitit 2010, 67.3 milion € të dhëna nga programi vjetor i IPA-s për 2010, u alokuan në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Integritetit Evropian dhe institucioneve qeverisëse. Programet e KE-së po vazhdojnë ta mbështesin sundimin e ligjit, reformat e administratës publike, komunitetet, kulturën, rininë dhe çështjet e gjera socio-ekonomike, duke përfshirë tregtinë, zhvillimin rajonal, arsimimin, punësimin dhe bujqësinë.

Në vitin 2009 janë ndarë 1.7 milion € nga IPA për të përmirësuar pjesëmarrjen e **shoqërisë civile** në diskutimin dhe hartimin e politikave. Fushat, si për shembull, mjedisi dhe mundësitë e barabarta (masat kundër diskriminimit, përfshirja e grupeve të cenuara në shoqëri) po tërheqin vëmendje të veçantë. Një shumë tjetër prej 3 milion € është ndarë nga IPA 2009, për përfitime të shoqërisë civile, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe fuqizimin e grupeve të pafavorshme. Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, gjithashtu po i mbështet këto çështje.

2. KRITERI POLITIK

Ky sektor ekzaminon progresin e Kosovës drejt plotësimit të kriterëve politike të Kopenhagës, që kërkon stabilitet nga institucionet, duke garantuar demokraci, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu, monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira ndërmjet fqinjëve me vendet nën zgjerim dhe shtetet anëtare si dhe përputhshmëria me obligimet ndërkombëtare, siç është bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish Jugosllavi (TNKJ).

2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

Parlamenti

Kuvendi miratoi rregulloren e punës të amendamentuar, duke e harmonizuar me Kushtetutën. Buxheti i vitit 2010 i ka mundësuar administratës së Kuvendit punësimin e ekspertëve tematikë shtesë, për të mbështetur punën e Komisioneve. Sekretariati i Kuvendit ka shtuar llojet e shërbimeve të ofruara për Komisionet, duke forcuar kapacitetin hulumtues të tyre. Bashkëveprimi në mes të Kuvendit dhe shoqërisë civile është përmirësuar. Seancat gjyqësore publike janë organizuar në një numër të fushave të legjisllacionit.

Në muajin shkurt, Kuvendi aprovoi Planin e Veprimit për Integrim Evropian për vitin 2010. Raporti i parë i implementimit është miratuar në shtator. Në qershor, Kuvendi miratoi ligjet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit, për hetimin parlamentar dhe për Gazetën Zyrtare.

Është përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet Komisionit për Integrim Evropian dhe komisioneve tjera të Kuvendit, e gjithashtu edhe me Ministrinë e re për Integrim Evropian. Komisioni ende ka nevojë të zhvillojë kapacitetin e saj financiar dhe administrativ në mënyrë substanciale.

Mbikëqyrja e ekzekutivit nga ana e Parlamentit bëhet përmes pyetjeve parlamentare, përmes seancave plenare të rregullta, me pjesëmarrjen e anëtarëve të qeverisë. Ky mekanizëm ka nevojë të bëhet më efektiv, duke përfshirë kërkesën dhe përgatitjen e raporteve të shkruara.

Ende mbesin shqetësime në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore nga sekretariati i Kuvendit. Duhet që të bëhet një proces transparent dhe meritohet i rekrutimit. Komisionet nuk e kanë shpenzuar buxhetin e ndarë për vitin 2009 dhe për tremujorin e parë të vitit 2010. Numri i lartë i lëvizjeve të stafit të kualifikuar ka penguar përpjekjet e ngritjes së kapaciteteve. Duhet të përmirësohet kapaciteti i Kuvendit për shqyrtimin efektiv të legjislacionit në bazë të normave të BE-së. Strategjia legjislative e Kosovës për vitin 2009 dhe 2010 është zbatuar vetëm pjesërisht.

Në nëntor të vitit 2009, Kosova organizoi zgjedhjet lokale. Këto ishin zgjedhjet e para të organizuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës, me mbështetjen e OSBE-së. Zgjedhjet u kryen në mënyrë të rregullt me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Tani, Zyra për Regjistrimin e Partitave Politike është plotësisht funksionale.

Numri i votuesve në veri të Mitrovicës ka qenë shumë i ulët. Në maj, Serbia organizoi zgjedhje lokale paralele në veri të Mitrovicës.

Zgjedhjet lokale kanë nxjerrë në shesh disa të meta sistematike në sistemin e zgjedhjeve në Kosovë, si për shembull ankesat dhe procesi i apeleve dhe dispozitat për vëzhgimet e zgjedhjeve. Sistemi zgjedhor nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kapaciteti i sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor mbetet i kufizuar.

Në muajin nëntor, u shpërnda Kuvendi si pasojë e votimit të mosbesimit ndaj qeverisë. Zgjedhjet e përgjithshme janë caktuar të mbahen më 12 dhjetor.

Në përgjithësi, Kuvendi ka bërë progres në ndërtimin e institucioneve dhe përfshirjen e agjendës për integrim Evropian në punën e tyre. Korniza legjislative është përmirësuar edhe më shumë. Është krijuar Komisioni për Llogaridhënie Publike. Sidoqoftë, kapaciteti i Kuvendit mbetet i dobët. Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore është esencial në këtë fushë. Duhet të përmirësohet procesi i mbikëqyrjes së ekzekutivit. Të metat e sistemit zgjedhor duhet të adresohen dhe duhet të forcohet roli i Kuvendit në shqyrtimin e legjislacionit për të siguruar cilësi.

Qeveria

Strukturat kryesore të qeverisë janë kompletuar. Gjashtë ministra janë zëvendësuar në muajin prill, si rezultat i riorganizimit të parë ministror, që nga zgjedhjet e përgjithshme të fundit.

Është krijuar Ministria e re për Integrim Evropian dhe është caktuar një ministër i ri për këtë pozitë. Ministria ka përfshirë edhe Agjencinë për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrim Evropian. Ministria koordinoi me sukses fazën e parë të PDSA-së në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera të qeverisë. Duhet ta konsolidojë tutje këtë rol qendror, në mënyrë që të sigurojë zbatim efektiv të konkluzioneve të PDSA-së dhe caktimin e prioritetëve reale në agjendën legjislative të Kosovës.

Ka pasur progres në reformimin e administratës së qeverisë lokale. Kosova ka arritur progres të rëndësishëm sa i përket decentralizimit. Në prill, qeveria e zgjati planin e veprimit të decentralizimit për dy vite tjera.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bëri një vlerësim të kapaciteteve në komuna, duke mbuluar të gjitha shërbimet publike. Duhet të adresohen rezultatet dhe të krijohet një mekanizëm për azhurnime të rregullta.

Në muajin janar, autoritetet miratuan një qasje gjithëpërfshirëse në veri të Kosovës, me qëllim të kompletimit të decentralizimit dhe reformës së qeverisjes lokale dhe përmirësimit të kushteve socio-ekonomike. Është caktuar një koordinator për mbikëqyrjen e zbatimit. Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal ka caktuar një grup përgatitor për komunën e Mitrovicës veriore.

Megjithatë, duhet të forcohet kapaciteti i Ministrisë për të mbikëqyrur autoritetet lokale në bazë të parimeve të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Interpretimet kundërthënëse të legjislacionit mbi vetëqeverisjen, shumë shpesh e bllokojnë bashkëpunimin në mes të autoriteteve lokale dhe qendrore. Kjo çështje duhet të zgjidhet duke e adresuar para gjykatave kompetente.

Pas tërheqjes së LDK-së nga koalicioni qeverisës, qeveria mori votën e mosbesimit nga Kuvendi.

Në përgjithësi, qeveria ka forcuar kapacitetin e saj për implementimin e agjendës së integritetit Evropian. Ka pasur progres në reformimin e qeverisë lokale. Megjithatë, sfidat kryesore mbesin në implementimin e legjislacionit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve komunale.

Administrata Publike

Ka pasur progres sa i përket reformave në administratën publike. Në muajin maj, Kosova aprovoi dy ligje kryesore në këtë fushë: për shërbimin civil dhe pagat e nëpunësve civil. Ligji për Bordin e Pavarur Mbikëqyrës u miratua në korrik. Në muajin shtator, u aprovuan ligjet rreth kontesteve administrative dhe administratën shtetërore. Ministria e Administratës Publike themeloi një departament për reformimin e administratës publike dhe integritetit evropian në tetor të vitit 2009. Komisioni ndër-ministror për reformimin e administratës publike u takua në intervale të rregullta. Ky Komision jep udhëzime politike të nivelit të lartë në këtë fushë. Dy ministri kanë miratuar planet e zhvillimit strategjik.

Instituti i administratës publike në Kosovë ka bërë një vlerësim për nevojat e trajnimeve dhe ka dizajnuar një program të ri për trajnime. Plani për zhvillim strategjik i Institutit është miratuar në muajin shtator.

Megjithatë, korniza ligjore duhet të zbatohet në mënyrë të plotë. Rregullat e domosdoshme që janë miratuar duhet të zbatohen si prioritet për të siguruar zbatim në kohë të legjislacionit për shërbimin civil. Ligji për procedurë administrative, i vitit 2006, është shpërndarë dhe zbatuar në mënyrë të dobët. Sigurimi i përfaqësimit të mjaftueshëm komuniteteve pakicë në shërbimin publik mbetet brengë.

Është implementuar më pak se një e treta e strategjisë për reformimin e administratës publike. Në muajin shtator, qeveria aprovoi strategjinë e plotësuar që reflektonte arritjet dhe sfidat e deritanishme.

Në muajin korrik, Kosova miratoi ligjin e ri për ombudspersonin. Megjithatë, është vonuar rekrutimi i zëvendësve të tij/saj. Duhet të adresohen dobësitë e pranishme të institucionit të ombudspersonit. Autoritetet duhet të reagojnë me vendosmëri rreth të gjitha rekomandimeve dhe hetimeve nga ana e ombudspersonit.

Vendimet e komisionit ndër-ministor duhet të formalizohen dhe të shpërndahen gjerësisht. Reformat duhet të kenë buxhet adekuat, me konsultime të vazhdueshme me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Planet e zhvillimit strategjik duhet të implementohen në mënyrë adekuate nëpër tërë administratën e Kosovës. Kapaciteti i departamentit për reformimin e administratës publike dhe i departamentit për administrimin e shërbimit civil duhet të forcohen.

Në përgjithësi, reforma e administratës publike në Kosovë mbetet një sfidë e madhe. Krijimi i një administrate publike profesionale, përgjegjëse, të qasshme dhe përfaqësuese dhe ofrimi i shërbimeve publike nëpër tërë Kosovën duhet të adresohet, si një çështje me urgjencë të lartë politike. Ky është prioritet kryesor i Partneritetit Evropian. Kapaciteti i administratës publike të Kosovës mbetet i dobët.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Gjatë periudhës së raportimit, Kosova ka miratuar Strategjinë për Sigurinë Kombëtare dhe legjislacionin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin/kontrollin e sigurisë. Janë krijuar dy organe për mbikëqyrje të sigurisë — Komisioni për Agjencinë Inteligjente të Kosovës dhe Komisioni për Forcat e Sigurisë së Kosovës. Megjithatë, mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë është ende duke u zhvilluar dhe ka nevojë të forcohet.

Sistemi i drejtësisë

Ka pasur progres në fushën e drejtësisë. Me miratimin e Ligjit për Gjykatat, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorinë, Kosova ka nisur një reformë të madhe gjyqësore. Përveç kësaj, ligji mbi gjykatat aplikon një sistem të ri të pagave, i cili do të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme gjendjen e gjykatësve. Megjithatë, duhet të bëhen plane dhe të ndahen resurse për zbatimin e këtyre reformave të mëdha. Ministria e Drejtësisë ka demonstruar kapacitet të kufizuar për përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e politikave në drejtësi. Zbatimi i ligjit për ndërmjetësim kërkon përpjekje më të mëdha. Ligji për ndihmën ligjore reciproke për çështje penale, për ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar si dhe për rrëmbimin e fëmijëve ende mungojnë.

Ministria e Drejtësisë ka marrë përgjegjësi shtesë për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar – për t'u marrë me kërkesat për, dhe nga, të gjitha vendet. Kapaciteti dhe siguria e njësisë përgjegjëse duhet të rritet. UNMIK-u mbetet pika formale e kontaktit me Interpolin dhe TNKJ. Kosova ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me Belgjikën për transferimin e personave të dënuar dhe marrëveshje tjera *ad hoc*. Po ashtu ka vazhduar bashkëpunimin me disa vende në bazë të reciprocitetit. Nuk ka bashkëpunim ligjor ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo ka pasur ndikim të veçantë posaçërisht në rastet civile, penale dhe pronësore. EULEX-i mund të lehtësojë këtë bashkëpunim.

Është emëruar Komisioni për Provimin e Jurisprudencës dhe janë organizuar provimet e para. Gjykatësit dhe prokurorët e parë të ardhshëm kanë diplomuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në muajin dhjetor 2009.

Është kompletuar me sukses procesi i verifikimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Në të gjitha tri fazat, përfshirë Gjykatën Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale, Zyrat e Prokurorëve, Gjykatat Ekonomike dhe Dhomat e Veçanta, Presidenti emëroi mbi 340 kandidatë. Në muajin tetor 2010, Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial ka organizuar një provim të etikës me qëllim të identifikimit të kandidatëve të përshtatshëm për pozitat e mbetura. Këshilli gjyqësor duhet të mbështetet mbi udhëzimet dhe procedurat e përcaktuara nga Komisioni pas marrjes së përgjegjësisë së plotë për rekrutim, verifikim dhe përzgjedhje të kandidatëve.

Ndërhyrjet politike në procesin e riemërimit dhe propozimeve të bëra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës është shqetësim serioz. Numri i aplikacioneve për riemërim nga pjesëtarët e pakicave ka qenë më i ulët sesa i numri i nevojshëm për plotësimin e të gjitha pozitave. Janë raportuar raste të frikësimit të anëtarëve të komunitetit serb. Serbia nuk ka qenë konstruktive në krijimin e një klime të përshtatshme politike në këtë proces. Si rezultat, nuk është siguruar balanci ndëretnik në gjyqësi.

Tetë anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë emëruar Kryetarin e tyre, i cili ka filluar të adresojë çështjet kritike strategjike dhe logjistike. Këshilli ka filluar trajtimin e rasteve disiplinore, por kapaciteti i tij në këtë fushë mbetet i kufizuar. Është miratuar manuali për menaxhim të gjykatave. Bashkëpunimi me EULEX-in do të jetë vendimtar për të siguruar zbatimin e tij. Po ashtu, janë miratuar paga më të larta në drejtësi.

Megjithatë, menaxhimi i emërimeve, dorëheqjeve dhe transferimeve ka mbetur një sfidë e madhe në mjedisin nën tranzicion të shkaktuar nga procesi i riemërimit. Këshilli nuk ka qenë në gjendje që të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Duhet të jetë më proaktiv në ngritjen e shqetësimeve dhe të veprojnë në mënyrë më të vendosur në rastet disiplinore. Gjithashtu, duhet të zhvillojë kapacitetin e tij për t'u marrë me një numër të çështjeve strategjike siç janë reformat e drejtësisë, buxheti, stafi dhe trajnimet. Të gjitha rekomandimet e Njesisë për Auditim Gjyqësor duhet të zbatohen. Duhet të fillojë procedura për përzgjedhjen e drejtorit të ri të sekretariatit të Këshillit.

Gjykata Kushtetuese është funksionalizuar dhe është marrë me një numër të ankesave si dhe ka marrë vendimet e para në bazë të parimeve bazë të të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut. Megjithatë, gjykata duhet të forcohet më shumë. Sekretariati i saj ende nuk është kompletuar.

Në muajin shtator, Gjykata morri vendim se është jokushtetuese nga ana e Presidentit të Kosovës që të mbaj postin e Presidentit të Kosovës dhe Kryesimin/Kryetarin e një partie politike. Rrjedhimisht, Presidenti i Kosovës dha dorëheqje.

Puna e përgjithshme e sistemit gjyqësor të Kosovës mbetet e dobët. Ende ka mbingarkesë të konsiderueshme të rasteve gjyqësore dhe efikasiteti i përgjithshëm është shumë i ulët. Bashkë me sfidat siç është korrupsioni dhe nepotizmi, ndërhyrjet e vazhdueshme politike në nivele të ndryshme dhe në forma të ndryshme në një numër të rasteve, përfshirë punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, paraqesin shqetësim serioz. Në disa raste, gjykatësit dhe prokurorët kanë refuzuar të merren me raste të ndjeshme. Ka pasur raporte për kërcënime dhe frikësime ndaj tyre. Disa komuna kanë refuzuar vazhdimisht zbatimin e vendimeve të gjykatave. Niveli i ulët i zbatimit të vendimeve gjyqësore paraqet një pengesë të madhe drejt krijimit të besimit në gjyqësi. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ka nevojë të operacionalizohet më shumë dhe duhet të bëhet emërimi i të gjithë gjykatësve vendore. Situata aktuale rrezikon marrëdhëniet ndëretnike dhe ushtrimin e të drejtave pronësore. Zbatimi i Sistemit Informativ për Menaxhim të Rasteve është vështirësuar nga mungesa e lidhjes së rrjetit në një numër të gjykatave të qarkut, komunale dhe të kundërvajtjes. Disa gjykatës ende hezitojnë ta përdorin atë. Trajnime më intensive janë të nevojshme në nivel të gjykatave nëpër rajone.

Gjykata në Mitrovicë ende përbëhet vetëm nga gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it dhe është duke funksionuar me kapacitet të kufizuar. Sundimi i ligjit në veri të Kosovës nuk është plotësisht i garantuar. Task Forca e EULEX-it për veri është duke u përqendruar në krimet që prekin qytetarët në jetën e përditshme dhe ka bërë arrestimet e para. Rastet e ndërlydhura me ngjarjet e marsit 2004 janë ende në pritje. Gjithashtu, institucionet e Kosovës ende nuk po i kushtojnë rëndësi të mjaftueshme mbështetjes së hetimeve dhe gjykimeve të krimeve të luftës.

Janë shënuar përmirësime në bashkëpunim ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Megjithatë, koordinimi i përgjithshëm ndërmjet zbatimit të ligjit dhe gjyqësisë, si dhe brenda gjyqësisë, duhet të përmirësohet tutje me qëllim të luftimit të krimit në mënyrë proaktive. Menaxhimi i dobët dhe mungesa e stafit mbështetës i kanë rrezikuar edhe më shumë angazhimet e prokurorisë. Mbikëqyrja e zyrave rajonale të prokurorisë nga ana e Zyrës së Prokurorit Shtetëror nuk ka qenë adekuatë. Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe Ministria e Drejtësisë kanë treguar bashkëpunim të kufizuar.

Pas dekretimit të ligjit për amnistinë, gjashtëdhjetë e dy të burgosur janë falur nga Presidenti i Kosovës. Kjo ka përfshirë edhe disa dënime për krime serioze dhe shumica e të burgosurve të cilët kanë refuzuar lirimin me kusht. Procesi i vlerësimit të rasteve të përgatitura për falje duhet të përmirësohet.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë progres në këtë sektor. Procesi i reformave të mëdha në drejtësi është nisur me miratimin e ligjit për gjykatat, i cili duhet të përmirësojë situatën e gjykatësve. Procesi i verifikimit është pothuajse i kryer. Megjithatë, Kosova është ende në një fazë të hershme të adresimit të prioritetëve në fushën e drejtësisë. Ndërhyrjet politike dhe tjera janë çështje për shqetësim serioz. Mbingarkesa e madhe me raste në gjykata dhe mungesa e efektivitetit të sistemit gjyqësor vazhdojnë të pengojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Kjo duhet të adresohet përmes rritjes së efikasitetit të sistemit e jo përmes rritjes së numrit të stafit. Përmirësime të mëtutjeshme drejt bashkëpunimit të të gjitha agjencive përkatëse janë të nevojshme urgjentisht për të adresuar sfidat ekzistuese.

Politika kundër korrupsionit

Kosova ka bërë pak progres në luftimin e korrupsionit. Korniza ligjore kundër korrupsionit është përmirësuar. Është miratuar ligji për financimin e partive politike, por ende nuk është në përputhje me standardet Evropiane. Një prej mangësive kryesore të ligjit është se as nuk ndalon e as nuk rregullon në mënyrë strikte donacionet nga personat juridik të cilët ofrojnë mallra ose shërbime për administratën publike. Këto tri ligje janë miratuar: ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe ligji për deklarimin e origjinës së pronës dhe dhuratave nga ana e zyrtarëve të lartë publik. Si rezultat i miratimit të këtij ligjit, deklarimet e aseteve janë publikuar online. Megjithatë, deklarimi i aseteve nga disa zyrtarë të lartë nuk janë publikuar. Kjo është çështje për shqetësim serioz. Informatat në dispozicion kanë shfaqur mospërputhje ndërmjet të hyrave dhe pronave të zyrtarëve të lartë në Kosovë. Kjo dëshmon praninë në shkallë të gjerë të korrupsionit në nivele të larta në Kosovë. Ky fakt nuk është përcjellë me debat publik ose hetime nga organet përkatëse që tregojnë mungesën e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin.

Kuvendi ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit për vitet 2009-2011. Kushtet e punës së Agjencisë kundër Korrupsionit janë përmirësuar. Agjencia ka azhurnuar planin e veprimit. Po ashtu, ka filluar monitorimin e zbatimit të planit të veprimit dhe ka pranuar raporte nga rreth 40 agjenci të përfshira. Megjithatë, ata demonstrojnë pronësi dhe përkushtim të kufizuar për ta zbatuar atë. Edhe pse janë përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet Agjencisë kundër Korrupsionit dhe prokurorisë, ende ka nevojë për përmirësim. Janë ngritur një numër i rasteve të ndërlidhura me keqmenaxhim të fondeve publike, të cilat i janë raportuar Agjencisë kundër Korrupsionit. Është ngritur vetëdija publike. Gjatë periudhës raportuese, kryeshefat ekzekutiv të pesë agjencive të pavarura janë shkarkuar ose degraduar në pozitë mbi bazën e punës së dobët dhe akuzave për korrupsion. Ende mbizotërojnë shqetësime rreth arsytimit të mjaftueshëm që dëshmojnë veprimet e tilla.

Policia e Kosovës ka themeluar drejtoratin kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, i cili duhet të operojë në mënyrë profesionale pa ndikim politik. Shërbimi Doganor i Kosovës,

Shërbimi Korrektues dhe Policia kanë bërë një numër të hetimeve të brendshme që kanë rezultuar me një numër të sanksioneve, përfshirë suspendimin. Prokurorë shtesë janë emëruar në Zyrës e Prokurorisë Speciale. Brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale, është themeluar një task forcë kundër korrupsionit. Megjithatë, EULEX-i ka vazhduar me ushtrimin e mandatit ekzekutiv në rastet e ndërlidhura me rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Autoritetet e Kosovës dhe EULEX-i kanë iniciuar një numër të hetimeve, kryesisht për guvernatorin e Bankës Qendrore, Ministrin e Transportit dhe të tjerë. Zyrtarë të lartë të Qeverisë janë treguar të përmbytur në këtë drejtim.

Sjellja e rezultateve në luftimin e korrupsionit nga ana e autoriteteve të Kosovës duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Shqetësimet kryesore ende sillen rreth punës së sektorit publik, prokurimit, gjyqësisë dhe zbatimit të ligjit, ndërsa numri i dënimeve për rastet e korrupsionit mbetet i ulët. Nuk ka mekanizëm për të përcjellë hetimet, paditë, ndjekjet penale dhe dënimet që do të siguronin transparencë rreth statusit të rasteve të korrupsionit. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive rreth korrupsionit është i pamjaftueshëm dhe rezulton në zbatimin kontradiktor të legjislacionit, strategjive dhe planeve të veprimit si dhe të informatave për publikun. Grupi punues ndërministror për masat kundër korrupsionit nuk ka arritur rezultate të prekshme. Drejtorati kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në Policinë e Kosovës ka mungesë të pajisjeve adekuate dhe duhet të forcohet. Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të rrisin aktivitetet e tyre në luftimin e korrupsionit të brendshëm pa ndërhyrje politike.

Korniza ligjore është ende e pakompletuar dhe nuk është në përputhje me standardet evropiane. Duhet të miratohen dispozita shtesë për të mbrojtur informatorët bashkë me legjislacionin për përgjegjësinë e personave juridik. Ligjit për konflikt të interesit i mungojnë obligimet përkatëse për raportim. Rastet e konfliktit të interesit vazhdojnë të mosraportohen dhe të mos adresohen. Mungesa e vullnetit politik dhe përkushtimit adekuat të autoriteteve të përfshira në hartimin ligjor ka rezultuar më dispozita ligjore të paqarta. Dispozitat që rregullojnë sistemin e sanksioneve në këtë ligj dhe në ligjin për deklarimin e origjinës së pronës dhe dhuratave nga zyrtarët e lartë publik nuk janë të qarta sa duhet. Për më tepër, procedura para gjykatave e paraparë me këtë ligj është joadekuate. Duhet të shmangen ndërhyrjet politike dhe nepotizmi në riemërime, ricakte (transfere) dhe shkarkime. Procedura e apelit para gjykatave, e paraparë me ligjin për deklarimin e pronës dhe të dhuratave, është joadekuate. Po ashtu, mungon regjistri i përcjelljes së zbatimit.

Është arritur progres i kufizuar nga institucionet kryesore rreth zbatimit të objektivave strategjike të sektorëve specifik. Raportimi i fokusuar duhet të përmirësohet nga ana e agjencive kryesore. Shumica e rasteve të korrupsionit të deklaruar janë të ndërlidhura me gjykatat. Kjo është çështje për shqetësim serioz. Korrupsioni i nivelit të ulët në institucionet e shëndetësisë dhe të arsimit është një shqetësim tjetër dhe pengon qasjen e barabartë të të gjithë qytetarëve në shërbime.

Me qëllim të rritjes së përpjekjeve për luftimin e korrupsionit, autoritetet e Kosovës duhet t'i orientojnë angazhimet e tyre në krijimin e një sistemi funksional të kontrollit dhe balancit. Kjo përfshin një sistem modern të kontrollit financiar, mekanizma transparent të përgjegjësisë, metoda të fuqishme të adresimit dhe shmangies së ndërhyrjeve joadekuate politike dhe nepotizmit në emërime, ricakte dhe shkarkime, posaçërisht në institucionet e sundimit të ligjit.

Në përgjithësi, pak progres është arritur në luftimin e korrupsionit. Megjithatë, korrupsioni mbizotëron në shumë fusha dhe ende paraqet shqetësim serioz. Pas shqyrtimit të pjesshëm të kornizës legjislative dhe institucionale, Kosova ka nevojë të demonstrojë rezultate në hetime, padi, ndjekje penale dhe dënime në rastet kundër korrupsionit.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

Respektimi i të drejtave të njeriut sipas të drejtës ndërkombëtare

Sa i përket **ratifikimit të instrumenteve të të drejtave njerëzore**, Kosova nuk është anëtare as e KB-ve e as e Këshillit të Evropës, prandaj nuk i nënshtrohet kornizave të këtyre organeve ndërkombëtare për raportim të rregullt dhe bashkëpunim në të drejtat e njeriut (përfshirë **Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut**).

Megjithatë, Kosova duhet të vazhdojë të bashkëpunojë në bazë të aranzhimeve *ad hoc* dhe të raportojë për të drejtat e njeriut para organeve të traktatit të KB-ve dhe mekanizmave të Këshillit të Evropës. Duhet të zbatohen rekomandimet e lëshuara nga këto organe.

Progres i kufizuar është arritur në lidhje me **promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut**. Gjykata Kushtetuese ka luajtur rolin e vet në aspektin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut. Kosova ka vazhduar të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për të drejta të njeriut për vitet 2009 – 2011.

Megjithatë, mekanizmat për të drejtat e njeriut nuk janë të koordinuara në mënyrë efektive si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal. Kjo pamundëson raportimin efektiv për zbatimin e të drejtave të njeriut. Njësitë qendrore për të drejta të njeriut mbeten të kufizuara nga mungesa e fondeve dhe trajnimeve. Ndërveprimi i dobët i tyre me administratën e ministrive dhe komunikimi i pakët me ombudspersonin nuk i kontribuojnë vetëdijesimit rreth të drejtave të njeriut. Në nivel komunal, njësitë për të drejta të njeriut nuk kanë arritur një nivel të kënaqshëm të performancës. Shumica prej tyre janë të marginalizuara brenda strukturës komunale dhe janë kryesisht joefektive.

Në përgjithësi, ka pasur progres të kufizuar në këtë fushë. Si korniza institucionale ashtu edhe përkushtimi financiar i Kosovës janë joadekuate për zbatim të legjislacionit për të drejtat e njeriut. Sigurimi i respektimit të plotë të të drejtave të njeriut është një prej prioriteteve kryesore të Partneritetit Evropian.

Të drejtat civile dhe politike

Qeveria duhet të bëjë më shumë sa i përket **parandalimit të torturës**, akuzave për **keqtrajtim** dhe përdorim të tepërt të forcës nga policia dhe stafi i burgjeve. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për **të luftuar mosndëshkimin**. Tanimë, janë shënuar disa trende pozitive.

Në fushën e qasjes në drejtësi, ka pasur progres të kufizuar. Komisioni për Ndhimë Ligjore është duke vazhduar funksionimin me Odën e Avokatëve dhe OJQ-të për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë. Është miratuar ligji për ndihmë ligjore. Fushata publicitare shtesë janë organizuar për të përmirësuar zbatimin e programit për ndihmë ligjore falas. Janë hapur edhe pesë zyra shtesë përveç atyre pesë ekzistuese. Zyra për ndihmë ligjore është hapur në veri të Mitrovicës me tre punonjës serb të Kosovës.

Megjithatë, rritja e vazhdueshme e rasteve, procedurat e gjata, perceptimet për korrupsion të gjerë në gjyqësi, kapaciteti i kufizuar i zyrave për ndihmë ligjore për të ndihmuar viktimat në procedura ligjore, moszbatimi i ligjit për ndërmjetësim, numri i pamjaftueshëm i gjykatësve në procesin e riemërimit, ekzekutimi joadekuat i procedurave të kontestuara civile dhe vendimet e paekzekutuara kanë dëmtuar besimin e publikut në kapacitetin, profesionalizmin dhe paanshmërinë e drejtësisë, duke rezultuar në kufizimin e qasjes efektive në drejtësi.

Ministria e Drejtësisë ndihmon qasjen në drejtësi për viktimat (e trafikimit, dhunës familjare, etj.) dhe pakicat përmes një rrjeti të zyrave ndërlidhëse me gjykata, të cilat ende nuk janë plotësisht funksionale. Ka ndërthurje me Komisioni për Ndhimë Ligjore. Në veri të Kosovës, qasja në drejtësi është ende e penguar nga mungesa e gjykatësve dhe prokurorëve shqiptar dhe

serb të Kosovës. EULEX është dashur të merret me rastet më serioze, posaçërisht kur të dyshuarit kanë qenë në paraburgim të gjatë. Kjo krijon numër të madh të mbingarkesës me raste të cilat duhet të trajtohen nga autoritetet vendore. Në zonat e tjera të banuara me komunitetet joshumicë, janë një numër i pengesave për qasje në drejtësi. Mbingarkesa e rasteve civile përfshin edhe një numër të madh të dimensionit ndëretnik. Dështimi në zgjidhjen e tyre është duke dëmtuar besimin në drejtësi. Përfundimisht, mungesa e bashkëpunimit ligjor me Serbinë rezulton në mospranimin e drejtësisë në disa raste.

Qasja në drejtësi për viktimat e trafikimit, fëmijët dhe femrat, duhet të përmirësohet. Agjenci të ndryshme që mbrojnë viktimat dhe hetojnë trafikuesit duhet të ngrisin kapacitetin e tyre. Ka mungesë të njësive të mjekësisë ligjore të specializuara në rastet e dhunimit, trafikimit të genieve njerëzore dhe dhunës familjare.

Në përgjithësi, Kosova ka arritur progres të kufizuar në këtë fushë. Një numër i pengesave ende e kufizojnë qasjen në drejtësi në Kosovë. Kosova është në një fazë të hershme të sigurimit të qasjes në drejtësi.

Sa i përket **sistemit të burgjeve**, një numër i shqetësimeve të sigurisë janë adresuar dhe kushtet materiale janë përmirësuar në qendrat e paraburgimit dhe ato korrektuese. Akuzat për keqtrajtim dhe/ose përdorim të tepërt të forcës nga policia dhe stafi i burgjeve kanë shënuar rënie. Ekziston një numër i kufizuar i raporteve për keqtrajtim në qendrën e paraburgimit në Dubravë. EULEX ka filluar trajnimin e njësive që punojnë atje. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale është miratuar. Një hapësirë e veçantë është ndarë për femrat e mitura. Është marrë vendim për ndërtimin e Institutit Psikiatrik të Mjekësisë Ligjore të Kosovës për të adresuar mungesën e objekteve adekuate paraburguese për kundërvajtësit me kapacitet mendor të dobësuar. Është arritur pak progres në adresimin e të burgosurve me nevoja të veçanta. Ministria e Drejtësisë ka vazhduar të mbikëqyrë dënimet dhe punën në shërbim të komunitetit nga gjykata për kundërvajtësit e mitur. Numri i raporteve për keqtrajtim dhe përdorim të tepërt të forcës ka shënuar rënie.

Megjithatë, kushtet e përgjithshme në burgje dhe objekte të paraburgimit mbesin shqetësuese. Madhësia e qelisë së përmendur në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk është në përputhje me standardet evropiane. Njësia për Transportim të të Burgosurve ende nuk mund ta kryejë punën në mënyrë adekuate për shkak të mungesës së pajisjeve dhe standardeve të ulëta të sigurisë. Nuk ka plane për menaxhimin e numrit të rritur të të varurve nga droga në burgje. Janë bërë përpjekje për të adresuar çështjet disiplinore. Megjithatë, ka pasur raportime për keqsjellje të pasfiduar, nepotizëm, korrupsion dhe ndërhyrje politike nga stafi. Mbikëqyrja nuk është adekuate dhe nuk mundëson hetim sistematik të ankesave dhe mbrojtjen e informatorëve. Alternativat për paraburgim duhet të shfrytëzohen më shpesh. Shtrirja e programeve të komunitetit për kundërvajtësit e mitur vazhdon të jetë e kufizuar dhe ka mungesë të objekteve për vendosjen e të miturve. Shërbimi nuk ka sistem adekuat të informimit që të regjistrojë dhe ofrojë informata të besueshme rreth të burgosurve. Kjo pengon nxjerrjen e statistikave, për shembull për recidivizëm, dhe definimin e programeve të punës për riintegrim social.

Shumica e të paraburgosurve serb mbesin në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë. Vetëm disa prej tyre janë në qendrat e paraburgimit në Gjilan dhe Prishtinë. Këto qendra nuk janë të pajisura për paraburgim korrektues afatgjatë. Bashkëpunimi ndërmjet zyrave qendrore të Shërbimit dhe qendrës së paraburgimit në Mitrovicë duhet të përmirësohet.

Në përgjithësi, është arritur progres sa i përket objekteve korrektuese. Kosova ka filluar të adresojë objektivat e veta në këtë fushë.

Sa i përket **lirisë së shprehjes**, mund të raportohet për progres të limituar. Ligji për qasje në dokumente publike është miratuar. Zbatimi i tij është esencial. Gazetarët vazhdojnë të jenë nën presion, përfshirë presionin nga zyrtarët e zgjedhur si pasojë e raportimit të tyre. Struktura e medieve mbetet e favorshme për interesa dhe pronësi partizane të gazetarëve. Autoritetet e Kosovës mbeten një prej reklamuesve më të mëdhenj në mediet e printuara, duke krijuar pozitë dominuese ndaj medieve. Gazetarët ballafaqohen me vështirësi për t'iu qasur dokumenteve zyrtare. Arsimimi dhe trajnimi profesional për gazetar është duke u përmirësuar. Gazetaria hulumtuese duhet të forcohet. Mospërputhshmëritë ndërmjet ligjit për fyerje dhe shpifje dhe Kodit Penal nuk janë zgjidhur. Kjo krijon paqartësi ligjore rreth dispozitave për shpifje.

Bordi i transmetuesit publik, RTK, është emëruar dhe është operacional. Të gjitha pozitat janë plotësuar. Megjithatë, një model afatgjatë i financimit të RTK-së nuk është gjetur ende. RTK ishte para bankrotimit dhe është dashur të shpëtohet nga fondet emergjente të buxhetit të Kosovës. Pavarësia dhe paanësia e RTK-së ende nuk është siguruar plotësisht. RTK dhe Komisioni i Pavarur për Media mbesin në kontest rreth asaj nëse RTK është duke plotësuar zotimet e saj për transmetim për pakicat sa i përket numrit të orëve të ndarë në televizion dhe mbulimin e sinjalit në radio.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të kufizuar në lirinë e shprehjes. Kjo nuk është plotësisht e garantuar në praktikë dhe struktura e medieve është e favorshme për ndërhyrje të fuqishme politike.

Liria e asociimit dhe tubimit nuk është përmirësuar. OJQ-të marrin pjesë në procesin legjislativ në formën *ad hoc* si dhe në punën e administratave qendrore. Planet e qeverisë për të amendamentuar ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare ka ngritur shqetësime të **shoqëria civile**. Kuptimi publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i ulët. Kjo e fundit vazhdon të varet kryesisht në financim ndërkombëtar që pamundëson ndonjë strategji afatgjatë. Kapaciteti monitorues i OJQ-ve është në rritje, por mbetet i kufizuar.

Në përgjithësi, nuk mund të raportohet për progres në këtë fushë. Mjedisi në të cilin operojnë OJQ-të duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Qeveria nuk shfrytëzon sa duhet ekspertizën e shoqërisë civile.

Sa i përket **lirisë fetare**, ka pasur pak progres. Bartja e përgjegjësive për ruajtjen e objekteve fetare dhe historike, përfshirë ato Ortodokse Serbe, nga KFOR-i të Policia e Kosovës pasqyron një mjedis më të sigurt. Komisioni Implementues për Rindërtim, i kryesuar nga Këshilli i Evropës, është duke bërë progres në zbatimin e mandatit të vet për riparimin e 34 objekteve ortodokse të dëmtuara në muajin mars 2004. Një e treta e punëve mbetet për t'u bërë. Ka përfunduar ndërtimi i katedrales katolike në Prishtinë.

Megjithatë, një numër i vogël i objekteve të trashëgimisë fetare, përfshirë Kishat Ortodokse Serbe dhe varrezat myslimane janë vandalizuar. Duhet të miratohet korniza ligjore që mundëson lirinë dhe aktivitetet fetare. Komunitetet fetare janë ende të regjistruara si OJQ. Disa besime të vogla potencojnë se janë diskriminuar nga autoritetet, përfshirë edhe parandalimin e hapjes së varrezës.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në lirinë fetare. Rindërtimi i objekteve fetare vazhdon por duhet bërë më shumë për të pajtuar komunitetet e ndryshme fetare. Ky është një prej prioritetëve kryesor të Partneritetit Evropian.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Në fushën e të **drejtave të grave**, mund të raportohet për progres të kufizuar. Është miratuar Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna Familjare. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ka vazhduar të

lehtësojë, promovojë dhe monitorojë zbatimin e Programit për Barazi Gjinore (2008 – 2013) të miratuar përfundimisht nga Kuvendi.

Megjithatë, mungesa e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës familjare mbetet problem. Edhe pse ligji penal thekson që krimet e lëndimit trupor të kryera në marrëdhënie familjare mund të ndiqen penalisht *ex officio*, prapëseprapë gjykatat nuk e bëjnë këtë. Ndërprerjet e parregullta të ndjekjeve penale janë të shpeshta. Hetimet e papërfunduara, bashkëpunimi i dobët ndërmjet policisë dhe prokurorisë dhe dështimi në arrestimin e kryesve të veprave kanë ndikuar në brishtësinë e viktimave ndaj recidivizmit dhe kanë rezultuar në mosdënimin e kryesve të veprave. Stafi në institucione që ndihmon viktimat e dhunës familjare ka nevojë për trajnim. Njohuria e kufizuar e tyre pamundëson nivelin e duhur të përfaqësimit ligjor.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të limituar rreth të drejtave të grave. Korniza ligjore është forcuar por zbatimi i përgjithshëm i legjislacionit përkatës mbetet joadekuat, prandaj ka ndikim të kufizuar në jetët e grave.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve ka shënuar përmirësim të lehtë. Progres është arritur në fushën e drejtësisë për të miturit përmes miratimit të kodit të së drejtës për të miturit të plotësuar dhe të përmirësuar. Kjo ka sjell standarde më të mira për zbatim nga ana e gjykatave, prokurorisë dhe sistemit sproves ndaj të miturve dhe fëmijëve. Kosova ka hartuar raportin e parë për zbatimin e konventës mbi të drejtat e fëmijëve.

Megjithatë, zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve ka nevojë për përkushtim më të madh politik dhe financiar. Fëmijët nga pakicat ballafaqohen me rrezik edhe më të madh me një shkallë të përlllogaritur të varfërisë prej 60%. Skema e ndihmës sociale për zvogëlimin e varfërisë së fëmijëve nuk është miratuar: shumica dërmuese e fëmijëve të varfër jetojnë në ekonomitë familjare që nuk marrin ndihmë sociale. Shkallët e braktisjes së shkollës, qasjes në drejtësi për fëmijët, lypjet e detyruar e fëmijëve dhe trafikimi mbesin shqetësuese. Vetëdija për këto probleme është e ulët si te publiku ashtu edhe te autoritetet. Përpjekjet për të identifikuar dhe ndjekur penalisht kryesit e veprave duhet të intensifikohen. Duhet të miratohen instrumente për nevojat e të dënuarve të mitur.

Në përgjithësi, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbetet e dobët. Janë të nevojshme përpjekje të prekshme për të garantuar dhe zbatuar të drejtat e fëmijëve.

Mund të raportohet për progres të limituar për **grupet e cenuara sociale dhe personat me aftësi të kufizuara**. Zbatimi i Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2009-2011) ka vazhduar, përfshirë aktivitetet monitoruese. Qeveria ka promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara përmes mbështetjes së disa projekteve në instanca të ndryshme siç janë Ditët e Mundësisë së Barabartë Profesionale, Dita Ndërkombëtare e Personave dhe Aftësi të Kufizuara dhe Dita Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë. Qeveria ka vendosur të zyrtarizojë gjuhën e shenjave. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nisur zbatimin e planit strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin para-universitar në Kosovë 2010-2015.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të kufizuar në këtë fushë. Nevojat e grupeve të cenuara sociale dhe të personave me aftësi të kufizuara kërkojnë më shumë përkushtim.

Në fushën e **të drejtave të punës dhe sindikatave të pavarura** është miratuar Ligji për Grevat.

Sindikatat e pavarura që përfaqësojnë shërbimin publik kanë organizuar protesta gjatë periudhës raportuese duke ndikuar në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, administratës publike, drejtësisë, shërbimeve korrektuese, minierave, shërbimeve të zjarrfikësve, policisë dhe shërbimeve të energjisë. Të gjitha protestat rezultuan me ngritje pagash dhe, në disa raste,

në përmirësime të kushteve të punës. Ende nuk ka Ligj të Punës. Resurset e inspektorateve të punës mbesin të dobëta dhe nuk mundësojnë monitorim efektiv në tërë Kosovën.

Në përgjithësi, legjislacioni i punës dhe ai social mbesin joadekuat. Miratimi i Ligjit të Punës dhe Ligjit për Këshillin Ekonomik e Social janë çështje urgjente. Sfidat e tjera janë të ndërlidhura me kapacitetet e ulëta në këtë sektor. Duhet të intensifikohet dialogu ndërmjet sindikatave të pavarura dhe qeverisë (*shih edhe nën 4.1 Tregu i Brendshëm*).

Qeveria ka vazhduar me zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit. Po ashtu, ka organizuar një fushatë kundër diskriminimit me theks të veçantë në diskriminimin mbi baza të orientimit seksual ose të moshës. Ka kombinuar transmetimet në televizionin publik, të publikuar në të gjitha gjuhët zyrtare, secila prej tyre theksonte shembujt e përbashkët të një lloji të veçantë të ndaluar të diskriminimit.

Megjithatë, duhet të sigurohet zbatimi dhe monitorimi i mëtutjeshëm i legjislacionit kundër diskriminimit. Vetëdija për çështjet e lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve (LHBT) mbetet e ulët. Debatet rreth homoseksualitetit janë të përjashtuara nga sferat publike dhe private. Niveli i lartë i mbrojtjes formale të paraparë me ligj duhet të zbatohet në mënyrë efektive (*shih Ligjin për Ombudspersonin nën administrata publike*).

Sa i përket **të drejtave pronësore**, qasja aktuale në pronë dhe gëzimi i saj, nuk janë të garantuara plotësisht.

Janë emëruar dy anëtarë vendor të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) si dhe zëvendës drejtori i Agjencisë. Janë regjistruar 40,855 kërkesa, prej të cilave 26.468 janë vendosur nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës. Të gjitha, përveç rreth një qind kërkesave të vendosura janë duke pritur rinitifikimin. Zbatimi i urdhrave për dëbim është përmirësuar pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe AKP-së për këtë qëllim. Autoritetet serbe kanë lejuar përcjelljen e vendimeve të pronarët e zhvendosur që kanë të bëjnë me pronat e tyre në Kosovë nga ana e zyrave të UNHCR-së në Serbi.

Megjithatë, riposedimi aktual mbetet një proces i gjatë dhe i vështirë. Janë zbatuar 414 vendime, prej të cilave 102 kanë çuar në riposedime fizike, derisa 312 janë vendosur nën administrim të AKP-së. Puna e panelit të Gjykatës Supreme për apele ndaj vendimeve të kontestuara të AKP-së është stopuar deri në emërimin e një gjykatësi vendor. Rastet e pronës vazhdojnë të përbëjnë shumicën e rasteve civile para gjykatave, përfshirë rreth 21,000 kërkesa për kompensim. Gjykimet për rastet pronësore shpeshherë përsëriten për shkak të parregullsive, qoftë në aktgjykim qoftë në procedurë. Kontestet ndër-etnike të pronave zgjaten në mënyrë të parregullt në gjykata vendore. Skema kompensuese e AKP-së për banesat në pronësi shoqërore ende nuk është rregulluar me legjislacion adekuat. Ende nuk ka ligj për shitjen e banesave në rastet kur ka të drejtë të posedimit. Disa libra të regjistrave të tokës ende mbeten në Serbi. Vetëm disa komuna ka regjistra të të drejtave pronësore të lidhura me regjistrin qendror të tokave. Procedurat e eksproprijimit nganjëherë keqpërdoren për qëllime korruptuese duke rezultuar me mungesë të kompensimit për pronarët.

Përgjithësisht, ka pasur progres të kufizuar në fushën e të drejtave pronësore. Zbatimi i dobët i legjislacionit pronësor është pengesa kryesore për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave pronësore, që paraqet një prej prioritetëve kryesore të Partneritetit Evropian.

Respektimi dhe mbrojtja e pakicave dhe të drejtave kulturore

Ka pasur progres të kufizuar në këtë fushë. Kapacitetet e ngritura të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete (MKK) dhe procesi i decentralizimit janë duke ofruar një kornizë të mirë për përmirësim (*shih edhe nën 2.1*). Shumë persona nga komunitetet pakicë vazhdojnë të shfrytëzojnë shërbimet paralele të arsimit, mbrojtjes sociale dhe kujdesit shëndetësor.

Sa i përket zbatimit të të **drejtave kulturore**, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport ka themeluar zyrtarisht Departamentin për Trashëgimi Kulturore. Mandati i tij përfshin mbikëqyrjen e shtatë qendrave rajonale për trashëgimi kulturore. Ministria ka kryesuar një takim të forumit për shkëmbimin e informatave teknike për trashëgimi kulturore, ngritjen e vetëdijes së publikut në këtë temë. Është themeluar Këshilli për Trashëgimi Kulturore. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka vazhduar me kryesimin e grupit punues ndër-ministror për zbatimin e zonave të mbrojtura.

Megjithatë, objektet e trashëgimisë kulturore janë të dëmtuara, shkatërruara dhe me ndërtime ilegale ose joadekuate në afërsi të tyre. Departamenti për trashëgimi kulturore ka nevojë për ngritje të kapaciteteve. Strategjia e integruar e konservimit ende nuk është miratuar. Ligji për trashëgimi kulturore, i cili i jep mandat Kosovës që të mbikëqyrë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore nuk zbatohet në tërësi. Lista e objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ende nuk është miratuar. Ligjet për mbrojtjen e Hoçës së Madhe dhe Qendrës Historike të Prizrenit nuk janë miratuar ende. Ligjet e trashëgimisë kulturore nuk janë të harmonizuara me Ligji për Planifikim Hapësinor. Vetëm disa komuna kanë finalizuar planet zhvillimore të komunave që adresojnë objektet e trashëgimisë. Disa aktivitete ndërtimore të bëra nga Kisha Ortodokse Serbe janë të parregulluara nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Komunikimi joadekuat ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe institucioneve të Kosovës ka kontribuar në cenueshmërinë e shumë objekteve të trashëgimisë kulturore e fetare. Shefi i Zyrës Ndërlidhëse Greke në Prishtinë, në cilësinë e facilitatorit të BE-së, ka bërë përpjekje konstruktive për të adresuar këtë çështje. Duhet të rritet bashkëpunimi ndërmjet ministrive relevante.

Përgjithësisht, ka pasur progres të kufizuar në fushën e trashëgimisë. Shumë objekte mbesin të rrezikuara dhe korniza ligjore është duke u zbatuar dobët dhe mbetet e pakompletuar (shih edhe *Lirinë Fetare*).

Është përmirësuar qasja e komuniteteve pakicë në arsim. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka organizuar konsultime të gjëra për kornizën e plan-programit me qëllim që, *ndërmjet tjerash*, të ofrojë arsimim në gjuhën anëtare si lëndë për komunitetet shqiptare, boshnjake, serbe dhe turke, siç është e garantuar me ligj. Shqyrtimi i materialeve mësimore të plan-programit ekzistues në gjuhën serbe, nga ana e komisionit të pavarur, hap rrugën për hartimin e një plan-programi të reviduar. Plan-programi për gjuhën dhe kulturën Rome është miratuar. Familjet e komunitetit goran kanë pranuar një kompromis që i përgjigjet nevojave të tyre brenda plan-programit që është në përdorim.

Megjithatë, mësimi i gjuhës shqipe ose serbe nuk është e obligueshme për komunitetet shqiptare, përkatësisht serbe. Urgjentisht duhet organizuar trajnime për të siguruar përdorimin e planprogramit të ri gjuhësor, që është kyç për zhvillimin e ndërveprimit ndërmjet komuniteteve.

Zbatimi i ligjit për përdorim të gjuhës në gjyqësi është duke u rritur. Një pjesë e madhe e komunave kanë miratuar rregulloret në bazë të ligjit.

Megjithatë, njohuria në rënie e gjuhës së dytë zyrtare nga shërbyesit civil dhe punonjësit e kompanive publike ngrit shqetësime të arsyeshme. Faqet e internetit të komunave dhe institucioneve publike nuk po ofrojnë informata në të gjitha gjuhët zyrtare në mënyrë sistematike. Kapacitetet dhe resurset e komunave të dedikuara për zbatim të ligjit janë të pakta. Komisioni për gjuhët ka nxjerrë raportin e parë rreth zbatimit të ligjit; mbulon vetëm disa prej administratave. Statusi dhe resurset e komisionit janë të pamjaftueshme për t'i përmbushur të gjitha obligimet ligjore, në veçanti për ngritjen e vetëdijes rreth ekzistencës dhe mandatit të tij.

Fondi për media minoritare dhe shpërndarja e tij nuk vlerësohen nga ndonjë proces transparent. Gjendja e medieve minoritare nuk është përmirësuar. Pas shkyçjes së 26 antenave të pacertifikuara të Telekom Serbia, janë kryer gjashtë sulme mbi antenat që operojnë ligjërisht në Kosovën veriore. Pesë transmetues janë shkatërruar. Antenat e Telekom Serbisë në veri kanë vazhduar të funksionojnë si më parë. Pas mbingarkesës së një sistemi, korporata elektroenergjetike e Kosovës shkyçi veriu nga furnizimi me rrymë. Një kompani është themeluar si burim alternativ për këtë pjesë të Kosovës. Megjithatë, shërbimi serb ka qenë i pasuksesshëm në përpjekjet për faturim dhe inkasim: pavarësisht nga fushatat e përbashkëta realizimi mbetet në më pak se 20%.

Ka pasur pak progres në drejtim të pajtimit të mëtutjeshëm ndërmjet komuniteteve. Statusi i komuniteteve pakicë mbetet i mbrojtur dhe garantuar me ligj. Në përgjithësi, incidentet ndër-etnike janë duke shënuar rënie dhe janë kufizuar në zona të ndjeshme. Institucionet e mandatuara për të adresuar shqetësimet e komuniteteve janë të shumta. Ministria për Kthim dhe Komunitete ka zhvilluar kapacitetet e saj dhe është angazhuar në bashkëpunim konstruktiv me komunat. Këshilli Konsultativ për Komunitete mblidhet rregullisht dhe konsultimi nga organet ekzekutive përkatëse është në rritje.

Megjithatë, tensionet ndërmjet komuniteteve vazhdojnë të pengojnë procesin e pajtimit dhe të integritimit. Institucionet relevante nuk koordinohen si duhet për të adresuar shqetësimet e pakicave. Prania e komuniteteve në administratë dhe kompani publike është i ulët. Mundësitë e punësimit për komunitetet pakicë janë të pakta. Integrimi i komuniteteve kërkon më shumë përqendrim dhe më shumë përkushtim politik.

Në fushën e **refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit**, mund të raportohet për pak progres. Që nga janari i vitit 2010, më shumë se 1600 pjesëtarë të komuniteteve janë kthyer vullnetarisht në Kosovë. Kjo paraqet një rritje të theksuar në kontekstin e vështirësuar rajonal. Strategjia e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete është miratuar me 12 shkurt 2010. Zyrtarët komunal për kthim kanë marrë status stabil ligjor si pjesë e zyrove komunale për komunitete. Qeveria ka ndarë disa resurse financiare për të lehtësuar procesin e kthimit. Qeveria ka promovuar kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit. Disa pjesë të tokës janë ndarë për shfrytëzim afatgjatë (99 vite) për familje të kthyera pa tokë me qëllim të garantimit të qëndrueshmërisë së procesit të kthimit. Qeveria është duke vazhduar me ofrimin e linjave humanitare të autobusit të cilat përdoren nga shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë në zonat e izoluara për të udhëtuar në zonat urbane për blerje dhe shërbime bazë.

Megjithatë, kanë ndodhur disa incidente. Strategjitë komunale për kthim ende nuk janë zbatuar në tërësi. Një nivel i lartë i sinergjisë është i nevojshëm ndërmjet kornizave të miratuara për kthim vullnetar dhe kthim të detyrueshëm. Mundësitë e punësimit në zonat e kthimit janë të pakta.

Në përgjithësi, procesi i kthimit mbetet një sfidë për institucionet e Kosovës. Qasja e kufizuar në pronë, vonesat në restituum të pronës dhe mungesa e mundësive ekonomike vazhdojnë të paraqesin pengesat kryesore për kthim të qëndrueshëm. Shumë persona të zhvendosur ende janë duke jetuar në kushte të vështira.

Sa i përket komuniteteve **Rom, Ashkali dhe Egjiptian**, mund të raportohet për progres të kufizuar. Gjendje e tyre vazhdon të paraqes shqetësim serioz.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka krijuar një mekanizëm për të monitoruar zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Qeveria ka miratuar planin operacional për zhvendosjen e familjeve që jetojnë në kampet e kontaminuara me plumb në Cesmin Llug dhe Osterode. Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe komuna e Mitrovicës

janë konstruktive sa i përket zhvendosjes së familjeve. Qeveria ka promovuar regjistrimin civil të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përfshirë ofrimin e regjistrimit pa pagesë. Sipas kërkesës, Kosova ka marrë pjesë në komitetin drejtues të Dekadës Rome në cilësinë e vëzhguesit duke mundësuar angazhimin e akterëve kryesor për çështjet rajonale të romëve.

Megjithatë, ka nevojë për rritje të gatishmërisë politike. Kushtet e jetesës së këtyre komuniteteve dhe qasja e tyre në arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale paraqesin shqetësime shumë serioze. Ende nuk ka një plan gjithëpërfshirës për rregullimin e vendbanimeve joformale. Komunikimi i dobët ndërmjet autoriteteve qendrore dhe komunale parandalon zgjidhjen e statusit ligjor të vendbanimeve joformale. Mungesa e regjistrimit të statusit civil është një pengesë shtesë për qasje në shërbime. Riintegrimi i të kthyerve të detyrueshëm Rom, Ashkali dhe Egjiptian është shqetësim tjetër i veçantë (shih edhe *politikat e migrimit*).

Autoritetet duhet të rrisin përkushtimin për të adresuar çështjet urgjente që prekin jetët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Në përgjithësi, ka pasur progres të kufizuar rreth integritetit të komuniteteve pakicë, i cili është një prej prioritetëve kryesorë të Partneritetit Evropian.

2.3. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Ka vazhduar bashkëpunimi me **Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish Jugosllavi**. Gjykata ka iniciuar një rigjykim të pjesshëm në rastin kundër Ramush Haradinajt.

Grupi Punues për Personat e Pagjetur, i përbërë nga delegacionet e Beogradit dhe Prishtinës, nën kryesimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), ka vazhduar me takimet e rregullta. Punët në gjermim kanë filluar në Bellaçevc dhe Koshare, ku thuhet se janë të varrosura mbetjet e serbëve të Kosovës. Qeveria ka ndarë fonde dhe ka ofruar mbështetjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për të kryer këto gjermime. Ligji për Themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore (ish Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore) ka riorganizuar këtë të fundit dhe ka hapur rrugën për zhvillimin e kapaciteteve vendore për mjekësi ligjore. Mandati i tij në fushën e mjekësisë ligjore dhe personave të pagjetur mbetet identik.

Megjithatë, në muajin gusht 2010, 14,631 persona mbesin ende të pagjetur si rezultat i konflikteve në rajon. Prej tyre, 10,402 nga konflikti në Bosnje dhe Hercegovinë; 2,392 raste nga konflikti në Kroaci dhe 1,837 nga konflikti në Kosovë, në bazë të shifrave të ofruara nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Gjatë periudhës raportuese, vetëm 48 raste janë zgjidhur. Progresi ka qenë i ngadalshëm dhe i bazuar kryesisht në informata nga arkivat ndërkombëtare dhe policia dhe dokumentet e armatës serbe. Kosova ende nuk iu është përgjigjur kërkesave për lokacione të varrezave. Hulumtimet ende nuk kanë filluar në liqenin e Livoçit. Komisioni për persona të pagjetur është duke punuar dobët edhe pas ndarjes së resurseve njerëzore shtesë për sekretariat. Përveç kësaj, Komisioni vazhdon të jetë i përbërë vetëm nga shqiptarët e Kosovës. Çështja e kompensimit të familjeve të personave të pagjetur nuk është adresuar. Korniza ligjore mbetet joadekuate; nuk i jep personalitet ligjor personave të pagjetur e as nuk njih të drejtën për të ditur për familjet e personave të pagjetur.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të kufizuar; ende mbesin sfida serioze. Është një proces i komplikuar që kërkon rritje të përkushtimit politik si dhe mbështetje me resurse financiare e teknike. Nëse nuk adresohet, çështja e personave të pagjetur do të vazhdojë të nxis urrejtje, duke penguar procesin e pajtimit dhe duke reflektuar negativisht në klimën e përgjithshme politike në Kosovë.

Përfaqësimi i jashtëm i Kosovës vazhdon të mbetet sfidë. UNMIK është nënshkruese e një numri të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe iniciativave rajonale në emër të Kosovës. Disa

prej palëve të këtyre marrëveshjeve insistojnë që Kosova të përfaqësohet nga UNMIK-u. Kosova ka theksuar nevojën për respektimin e Kushtetutës, e cila parasheh që përgjegjësia për përfaqësim ndërkombëtar është e autoriteteve të Prishtinës. Autoritetet kanë theksuar se nuk janë të gatshme të pranojnë pjesëmarrjen në strukturat bashkëpunuese rajonale nën UNMIK.

Kosova ka marrë pjesë rregullisht në takimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR). Po ashtu ka marrë pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë BE-Ballkani Perëndimor, të mbajtur në Sarajevë në muajin qershor. Megjithatë, Kosova nuk ka marrë pjesë në takimin e Bordit të KBR-së në shtator. Autoritetet e Kosovës nuk organizuan takimin e nën-komitetit të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) për dogana dhe rregullat e origjinës, kryesuar nga Kosova gjatë periudhës raportuese.

Kosova duhet të sigurojë pjesëmarrjen efektive në iniciativat bashkëpunuese, siç janë KBR dhe CEFTA, për të mbajtur hapin me zhvillimet rajonale. Posaçërisht, sa i përket CEFTA-së, Kosova duhet të jetë konstruktive në mënyrë që të sigurojë zbatimin e marrëveshjes.

Kosova vazhdon të merr pjesë në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane dhe Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore pa pengesa. Kosova ka marrë pjesë në negociatat teknike për Traktatin e Komunitetit të Transportit, nënshkrimi i të cilës është shtyrë.

Kosova ka vazhduar të merr pjesë, në cilësinë e vëzhguesit, në Marrëveshjen Investuese (Investment Compact) për Evropën Juglindore, e cila është dizajnuar për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në rajon.

Demarkacioni ndërmjet territoreve të Kosovës dhe *ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë* si dhe ndërmjet Kosovës dhe *Shqipërisë* ka përfunduar. Janë duke u bërë përpjekje për të kryer demarkacionin me *Malin e Zi*.

Në përgjithësi, bashkëpunimi rajonal mbetet shqetësim serioz. Sa më shpejt që është e mundur duhet të gjendet një zgjidhje e pranueshme dhe e qëndrueshme për pjesëmarrjen e Kosovës dhe Serbisë në forumet kryesore rajonale. Kjo është esenciale për bashkëpunim rajonal funksional dhe gjithëpërfshirës.

3. KRITERET EKONOMIKE

Gjatë ekzaminimit të zhvillimeve ekonomike në Kosovë, qasja e Komisionit është orientuar nga konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë, në qershor 1993, që deklaroi se anëtarësimi në Union kërkon ekzistencën e ekonomisë funksionale të tregut dhe kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit.

3.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Bazat e politikës ekonomike

Në muajin prill, Qeveria e Kosovës miratoi kornizën afatmesme të shpenzimeve (KAMSH) për vitet 2011 – 2013. Në muajin korrik, është arritur një marrëveshje me FMN-në për një program 18 mujor të mbështetjes me 109 milion € me Marrëveshje *Stand-By* (SBA). Pastaj, është azhurnuar skenari fiskal i KAMSH-it dhe është harmonizuar me marrëveshjen e FMN-së. Objektivat e deficitit fiskal për vitet 2010 dhe 2011 nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale, por përlllogaritjet e të hyrave dhe shpenzimeve janë rregulluar dhe janë bërë më reale. Ka pasur legjislacion të dorëzuar në qeveri që nuk ka lidhshmëri me KAMSH-in. Mekanizmi i mbikëqyrjes fiskale ka vazhduar takimet me Komisionin Evropian që mbahen dy herë në vit. *Në përgjithësi*, është ruajtur konsensusi politik rreth bazave të politikave ekonomike të orientuara kah tregu. Megjithatë, konsistenca e hartimit dhe zbatimit të

politikave duhet të forcohet dhe lidhja ndërmjet prioriteteve të politikave, reformave strukturore dhe shpenzimeve publike mbetet e dobët.

Stabiliteti makroekonomik

Kriza ndërkombëtare ekonomike dhe financiare ka pasur ndikim të kufizuar në ekonominë e Kosovës. Ndikimi më i madh ka qenë rënia e remitançave dhe rënia e kërkesës së jashtme dhe çmimeve për eksportet kryesore të Kosovës. Rritja e vërtetë e GDP-së u ngadalësua nga 5.4% sa ishte në vitin 2008 në 4.0% në vitin 2009. In vitin 2008, rritja ndodhi si rrjedhojë e investimeve të qeverisë dhe konsumit privat. Megjithatë, në vitin 2009 dhe në pjesën e parë të vitit 2010, rritja ishte pothuajse në tërësi e ndikuar nga investimi dhe konsumi qeveritar. Rritja e konsumit privat ra në 2.1% në vitin 2009, ndërsa konsumi i qeverisë u rrit për 16.4%. Sido që të jetë, pjesëmarrja e tyre në GDP ka mbetur pothuajse e pandryshuar, në afër 95%, përkatësisht 18%. Pas më shumë se dyfishimit në vitin 2008, investimi i qeverisë vazhdoi me rritje prej mbi 30% duke arritur rreth 10% të GDP-së, derisa investimet private u rivitalizuan nga rënia në vitin paraprak me rritje reale për 5.0% në vitin 2009. Sektori i donatorëve vazhdoi me rënie të pjesëmarrjes në ekonomi. Importi i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje reale prej 3.5% ndërsa ka shënuar rënie nominale për shkak të efektit të fuqishëm të çmimeve. Eksporti shënoi rënie për 1.8%, kryesisht për shkak të zvogëlimit të kërkesës së jashtme dhe çmimeve më të ulëta ndërkombëtare për metalet bazë dhe artikujt e punuar nga metalet bazë. Edhe pse disponueshmëria e tyre është përmirësuar pak gjatë vitit, statistikat ekonomike mbesin të dobëta dhe nuk mundësojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të situatës ekonomike në Kosovë. GDP për kokë banori³ ka arritur në 1,790 € në vitin 2009, që është 7.6% e mesatares së BE-27, në krahasim me 7.1% in vitin 2008. Në *përgjithësi*, zhvillimi ekonomik i Kosovës ishte i ndikuar kryesisht nga shpenzimet qeveritare. Ka rreziqe në ngritje e sipër rreth qëndrueshmërisë së këtij profili të rritjes.

Eksportimi i mallrave ka filluar të rikthehet në muajt e fundit të vitit 2009 duke iu falënderuar rihapjes së linjës së dytë të prodhimit të Ferronikelit, minierave të plumbit dhe zinkut dhe kompanisë përpunuese, i cili është eksportuesi më i madh i Kosovës. Përgjatë tërë vitit, eksporti arriti në 4.2% të GDP-së, por është ende nën 5.1% të shënuar në vitin 2008. Në shtatë muajt e parë të vitit 2010, eksportimi i mallrave është rritur për 107% nominale në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Importimi i mallrave shënoi një rënie marginale në 49.6% të GDP-së në vitin 2009, nga 50.2% në vitin 2008. Struktura e tyre ka ndryshuar duke lëvizur nga mallrat konsumuese kah makineria dhe pajisjet transportuese të ndërlidhura kryesisht me shpenzimet e rritura për infrastrukturë publike. Deri në fund të muajit korrik 2010, importimi i mallrave ka përbërë 12.3% rritje nominale me më shumë se tri çereket e grupeve të mallrave që kanë regjistruar shkallë pozitive të rritjes.

Shkalla e mbulimit të eksportit të mallrave në përqindje të importit (mesatarja 12 mujore) është rritur pas fundosjes në 7.8% në shtator 2009 dhe qëndroi në 12.1% në korrik 2010, që është ende jashtëzakonisht e ulët. Kur të krahasohet me deficitin prej 43.4% të GDP-së në vitin 2008, bilanci tregtar është përmirësuar lehtë në vitin 2009 me deficit prej 43.3% të GDP-së. Nga janari deri në korrik të vitit 2010, deficitin tregtar është ngritur në 992 milion € në krahasim me 949 milion në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pasi që fitimet e eksportit ishin zbehur nga rritja e importit.

Në vitin 2009, deficitin aktual (përfshirë transferimet zyrtare) u zgjerua në 16.4% të GDP-së, nga 15.7% sa ishte në vitin 2008. Ngritja e deficitit ishte rezultat i politikës fiskale të butë, eksportit të dobët të mallrave dhe nga zvogëlimi serioz në të hyra, të cilat shënuan rënie prej më shumë se gjysmë – nga 4.0% të GDP-së në vitin 2008 në 1.8% në vitin 2009. Faktori kryesor që ka kontribuar në përkeqësimin e llogarisë së të hyrave ishte rënia në të hyrat neto

³ Masa e përdorimit të PPP-së nuk është në dispozicion në Kosovë.

të investimeve. Remitancat e punëtorëve dhe transferimet zyrtare arrinin totalin prej 12.9%, përkatësisht 6.4% të GDP-së. Suficiti në llogarinë e kapitalit dhe të financave (12.7% të GDP) nuk mjaftonte për të mbuluar deficitin aktual të vitit 2009 dhe, si rezultat, edhe asetet rezervë shënuan rënie për 154.0 milion euro. Llogaria kapitale shënoi një suficit prej 2.6% të GDP-së – rritje dhjetëfish në krahasim me vitin e kaluar, kryesisht për shkak të servisimit të borxhit të Bankës Botërore me ndihmën substanciale të donatorëve. Neto investimet e drejtpërdrejta nga jashtë shënuan një rënie nga 19% në 7.1% të GDP-së. Investimet në portofolio (-1.5% të GDP) dhe huat (-1.9% të GDP) u bënë negative. Gabimet dhe lëshimet neto mbetën në nivel të konsiderueshëm prej 2.9% të GDP-së, që tregon se bilanci i statistikave të pagesave nuk pasqyron si duhet të gjitha të hyrat dhe të dalat nga vendi. *Në përgjithësi*, disbalanci i jashtëm mbetet në nivel të konsiderueshëm dhe financimi i tyre ka shkaktuar rënie të rezervave bashkë me rënien e të hyrave kapitale.

Papunësia në vitin 2009 mbeti shumë e lartë dhe qëndroi në 45%, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore. Në pjesën e parë të vitit 2010, numri i të papunëve të regjistruar shënoi rënie prej 0.2% në krahasim me pjesën e parë të vitit 2009. Kjo rënie ishte rezultat i rënies së papunësisë gjysmë të shkathtë dhe të shkathë, ndërsa papunësia e pashkathtë shënoi rritje mesatare prej 0.3%. Deri në fund të muajit qershor 2010, të papunët e pashkathtë përbënin 60% të punëkërkuësve total të regjistruar. Rreth 30,000 të rinj të përllogaritur, kryesisht me shkathtësi të ulëta, hyjnë në tregun e punës çdo vit me pak mundësi punësimi dhe gjasa të zhvillimit profesional. Puna vazhdon të jetë pika më e rëndësishme e eksportit të Kosovës e cila krijon të hyra nga remitancat duke financuar një pjesë të madhe të konsumit të brendshëm. Informatat rreth tregut të punës mbesin të pakta dhe mbizotërojnë dyshime rreth saktësisë së tyre. Për më tepër, të dhënat zyrtare nuk japin një pamje të qartë të tregut të punës për shkak të numrit të madh të punësimit joformal. Intervali kohor ndërmjet dy publikimeve të të dhënave të anketës së fuqisë punëtore dhe periudhës raportuese është shkurtuar dhe anketa e fundit, që mbulon vitin 2009, është publikuar në korrik 2010. Ka pasur disa zhvillime pozitive si rritja e shkallës së pjesëmarrjes dhe punësimit. Megjithatë, shkalla e punësimit ishte vetëm 26% dhe papunësia afatgjatë dhe tek rinia mbetet shumë e lartë me 73% dhe 82% të të gjithë të papunëve. Struktura e punësimit tregon se puna është zhvendosur kryesisht drejt sektorëve jotregtarë – rreth 17% janë punësuar në tregti, 13% në arsim, 10% në administratë, 8% në ndërtimtari dhe vetëm 10% në prodhim. *Në përgjithësi*, pavarësisht nga rritja pozitive, ekonomia nuk është duke krijuar punë të mjaftueshme për të absorbuar të rinjtë që hyjnë në tregun e punës dhe të zvogëlojnë presionin e tregut të punës. Papunësia mbetet shumë e lartë.

Inflacioni vjetor në vitin 2009 ishte negativ me -2.4%. Shkallët e inflacionit mujor u bënë pozitive kah fundi i vitit 2009 dhe deri atëherë janë rritur në 5.9% (vit pas viti) në gusht 2010, kur është arritur kulmi si rrjedhojë e rritjes së çmimit të bukës. Vetëm çmimet e bukës dhe të drithërave kontribuuan me 2.3 % në inflacion. Deri në fund të muajit gusht, mallrat dhe shërbimet me kontribut pozitiv në inflacion arrinin një total afër 75% në tërë shportën e IÇK-së. Ngritja në këtë indikator gjatë muajve veror ka qenë pasqyrim i presioneve të gjera të inflacionit. Modelet e konsumit janë përqendruar në mallra dhe shërbimeve të tregtueshme, të cilat përbëjnë rreth tri çereke të shportës së IÇK-së. *Në përgjithësi*, inflacioni mbetet i paqëndrueshëm, kryesisht për shkak se çmimet e bukës dhe të karburanteve mbështeten fuqishëm në kalkulime.

Kosova përdor euron si valutë zyrtare dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) i ka instrumentet e politikave të kufizuara. Rritja e parasë u ngadalësua nga 23.6% sa ishte në dhjetor 2008 në 11.2% në dhjetor 2009, dhe ka kaluar në negativ në maj 2010, pas reduktimit substancial të depozitave publike të korporatave jofinanciare. Monetizimi i ekonomisë, matur nga shkalla e mesatares së parasë me GDP, është rritur nga 32.4% në vitin 2009 në 38% në vitin 2009. Përpjekjet e bankës qendrore u orientuan kryesisht drejt përmirësimit të

mbikëqyrjes së sektorit financiar. Në muajin qershor, është amendamentuar Ligji për Bankën Qendrore për të forcuar pavarësinë dhe përgjegjësinë e BQK-së dhe për të hapur mundësinë e ndihmës së kufizuar për likuiditet emergjent. *Në përgjithësi*, korniza monetare ka vazhduar të funksionojë mirë dhe stabiliteti financiar është ruajtur.

Deficit buxhetor është rritur nga 0.2% të GDP-së sa ishte në vitin 2008 në 0.8% në vitin 2009. Deficiti i vërtetë ishte shumë më i lartë duke u rritur në 6.0% të GDP-së në 2009 nëse nuk merret parasysh dividendi 200 milionësh i marrë nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK). Të hyrat e përgjithshme (duke përjashtuar dividendët e PTK-së) ka mbetur e pandryshuar nga viti 2008 me 24.5% të GDP-së. Shpenzimet totale janë rritur nominalisht nga 24.1% në 30.5% të GDP-së në vitin 2009. Shpenzimet në paga dhe mëditje janë ngritur nga 5.9% të GDP-së në 6.8% të GDP-së si rezultat i ngritjes së pagave të nëpunësve publik. Si rezultat i nivelit më të mirë të ekzekutimit për investime dhe një huaje shtesë për mbështetjen e Korporatës Elektro Energjetike të Kosovës (KEK), shpenzimet kapitale dhe huadhëniet neto u rritën nga 7.6% të GDP-së në 11.7%. Depozitat e Qeverisë në Bankën Qendrore kanë rënë nga 414 milion (10.8% të GDP) sa ishin në vitin 2008 në 342 milion (8.8% të GDP) në fund të vitit 2009. Në dhjetor të vitit 2009, Kuvendi miratoi ligjin për borxhin publik, i cili vë kufizimet për shumat shtetërore dhe komunale. Në asnjë rast, borxhi total (përfshirë garancitë) nuk guxon të tejkalojë 40% të GDP-së. Në vitin 2009, Kosova morri obligime përballë Bankës Botërore, të cilat qëndruan në 6.4% të GDP-së në fund të muajit dhjetor. Borxhi total i Qeverisë, përfshirë borxhin e pranuar ndërkombëtar dhe huat nga FMN, kanë qëndruar në 6.8% të GDP-së në fund të muajit gusht 2010. Një njësi për menaxhimin e borxhit është funksionalizuar brenda Thesarit (Ministria për Ekonomi dhe Financa).

Në vitin 2010, është pranuar një pagesë dividendë nga PTK, në shumë prej 80 milion euro, pas asaj të marrë në vitin 2009. Deri në fund të muajit gusht, rritja e të hyrave, neto e dividendëve, nominalisht ishte 13.4%. Kjo është mundësuar me realizim të mirë të mbledhjes doganore dhe tatimeve të brendshme. Dukuria e rritjes së shpenzimeve ka mbetur e pandryshuar dhe shpenzimet kapitale bashkë me shpenzime në paga dhe mëditje kanë mbajtur nivelet e rritjes në dyshifrore. Shuma neto e pagave mujore të sektorit publik është rritur për 16.4% në tremujorin e parë të vitit 2010 në krahasim me periudhën përkatëse në vitin 2009. Kryesisht, si rezultat i pagesës së dividendës nga PTK, buxheti ka rezultuar me suficit prej 85 milion € deri në fund të muajit gusht. *Në përgjithësi*, buxheti ballafaqohet me rreziqe në rritje pasi që shpenzimet po rriten shumë më shpejt sesa të hyrat tatimore, dhe çdo herë e më shumë të financuara nga të hyrat e njëhershme dhe reduktime në depozita të akumuluar.

Planifikimi fiskal ka mbetur *ad hoc*, me iniciativat e shpenzimit të qeverisë që në mënyrë të konsiderueshme devijojnë nga planet buxhetore dhe korniza afatmesme e shpenzimeve në fillim të vitit 2010. Në muajin mars, qeveria dha një kontratë për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Merdar. Ky prioritet i infrastrukturës nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2010 e as në KAMSH. Projekti është vlerësuar të arrijë vlerën prej 1 miliardë € (rreth 25% të GDP) dhe pritet të kryhet për katër deri në pesë vite. Në muajin maj, një tendencë për të kufizuar rreziqet fiskale – kryesisht ato që rrjedhin nga projekti i autostradës – dhe për të kthyer qëndrueshmërinë fiskale, është arritur një marrëveshje me FMN për një program 18 mujor, mbështetur nga një Marrëveshje *Stand-By* për 109 milion euro. Është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN në pjesën e dytë të korrikut. Korniza fiskale është azhurnuar për të përfshirë formalisht masat e miratuara në bazë të programit të FMN-së dhe për të pasqyruar kostot e përlogaritura të ndërtimit të autostradës. Për të kufizuar devijimin e deficitit buxhetor, janë rritur disa akciza të caktuara që kanë hyrë në fuqi në fillim të muajit korrik. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë është amendamentuar për të siguruar që çdo iniciativë për shpenzime e miratuar pas shqyrtimit gjashtëmujor të buxhetit në vitin 2011 dhe në vitet pasuese të kompensohet plotësisht nga masat kredibile të të hyrave ose përmes

shkurtimeve buxhetore. Si rezultat e marrëveshjes me FMN-në, deficiti i vitit 2010 mbeti pothuajse i pandryshuar me 3.4% të GDP-së, por përlllogaritjet e të hyrave dhe shpenzimeve janë rregulluar dhe janë bërë më reale. *Në përgjithësi*, parashikueshmëria, konsistenca dhe transparenca e politikave mbetet sfidë.

Për shkak të nivelit relativisht të ulët të integritit të Kosovës në ekonominë globale, politika fleksibile tatimore ishte mbrojtur nga kriza ekonomike globale dhe ka vazhduar njëjtë në vitin 2009. Rritja ekonomike ka qenë rezultat i shpenzimeve qeveritare, derisa disbalancet e jashtme kanë mbetur të konsiderueshme. Rëndësia e politikës fiskale për ruajtje të stabilitetit ekonomik është rritur. Presioni i tregut të punës nuk është zvogëluar dhe ekonomia ende ballafaqohet me probleme të mëdha strukturore. *Në përgjithësi*, përzjerja e politikës makroekonomike ka qenë efektive në ruajtjen e stabilitetit ekonomik, por është shumë e cenueshme si rezultat i rritjes së fuqishme të shpenzimeve qeveritare.

Ndërveprimi i fuqive të tregut

Agjencia e Privatizimit e Kosovës ka vazhduar me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, edhe pse shumica janë biznese të vogla me ndikim të ulët makroekonomik. Në fillim të vitit 2010, Agjencia filloi me likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore për të cilat nuk ka interesim të investitorëve për privatizim. Është arritur progres me privatizimin e ndërmarrjeve publike. Qeveria ka kontraktuar një këshilltar të transaksionit për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Po ashtu, qeveria ka kontraktuar një këshilltar të transaksionit për privatizimin e distribucionit dhe furnizimit të kompanisë elektrike publike (KEK). Privatizimi dhe transaksioni për ndërtimin e një termocentrali të ri në Kosovë ka pasur vonesa, pjesërisht si rezultat i modelit të tregut të energjisë në përdorim. Nuk kanë miratuar dispozita për koncesione në ligjin për prokurim publik, të cilat kanë ndikuar në mjedisin ligjor për këto kompani. *Në përgjithësi*, ka pasur pak progres me procesin e privatizimit, në veçanti rreth ndërmarrjeve publike.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Regjistrimi online i bizneseve ka filluar në qershor. Regjistri i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës tani përfshin rreth 45,000 kompani aktive (ky numër në fund të vitit 2008 ishte 67,950) nga totali i 97,000. Informatat për kompanitë e regjistruara janë në dispozicion online. Në vitin 2009, numri i ndërmarrjeve të reja dhe të reregjistruara ishte rreth 7,500 dhe ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit paraprak. Një projekt i ri për krijimin e instrumenteve *one-stop-shop* (22 sosh), ku kompanitë mund të marrin licenca të ndryshme në të njëjtën kohë, ka filluar në tetë komuna. Pagesat për fillimin dhe mbylljen e biznesit janë të ulëta, por numri relativisht i lartë i firmave joaktive në regjistrin e biznesit sugjeron që rregulloret e daljes nga tregu dhe zbatimi i tyre mund të përmirësohen më shumë. *Në përgjithësi*, sundimi i ligjit dhe zbatimi i dobët, furnizimi i pasigurt me rrymë, qasja e kufizuar në financa, korrupsioni dhe të drejtat pronësore të definuara dobët e kufizojnë hyrjen dhe daljen nga tregu.

Sistemi ligjor

Sistemi ligjor vazhdon të ketë qasje dhe efikasitet të dobët dhe disa zona nuk janë të mbuluar nga gjykatat përkatëse. Ka pasur pak përmirësime në zbatimin e kontratave, edhe pse metodat joformale të zbatimit vazhdojnë të jenë të pranishme gjerësisht. Situata rreth të drejtave pronësore mbetet burim i shqetësimit. Vetëm disa komuna kanë regjistra digjital të të drejtave të paluajtshme pronësore. Këto nuk janë të lidhura me regjistrin qendror të tokave dhe ka mungesë të komunikimit ndërmjet autoriteteve qendrore dhe komunale. Disa libra të regjistrimit të tokave janë ende në Serbi. Në përgjithësi, paaftësia e autoriteteve për të zbatuar legjislacionin në mënyrë gjithëpërfshirëse mbetet pengesë kryesore për mbrojtjen e të drejtave

pronësore. Në bashkëpunim me EULEX-in, gjykatat e Kosovës janë në proces të hetimit të disa rasteve në nivelit të lartë të korrupsionit. *Në përgjithësi*, korniza ligjore ekzistuese mbetet e pazhvilluar sa duhet dhe zbatimi i saj mbetet i dobët. Zbatimi i vështirë dhe i shtrenjtë i kontratave dhe mbizotërimi i korrupsionit vazhdojnë të pengojnë mjedisin e biznesit.

Zhvillimi i sektorit financiar

Sektori financiar është rritur me 24.2% në vitin 2009, duke arritur vlerën totale të aseteve në 2.8 miliardë € ose rreth 72% të GDP-së. Sektori bankar është dominues dhe përbën 78.6% të aseteve, ndjekur nga fondet pensionale (13.6%), institucionet mikrofinanciare (4.7%), kompanitë e sigurimit (2.9%) dhe ndërmjetësuesit financiar (0.2%). Numri i bankave komerciale (tetë) dhe fondeve pensionale (dy) mbesin të njëjta, ndërsa tri institucione tjera mikrofinanciare (duke rritur numrin e tyre në 19) dhe një kompani e re e sigurimeve (duke rritur numrin në 11) kanë nisur aktivitetet në vitin 2009. Niveli i koncentrimit të sistemit bankar ka shënuar rënie por prapë mbetet i lartë, me 81% të aseteve të menaxhuara nga tri banka. Më shumë se 90% të aseteve në sektor mbahen nga bankat në pronësi të huaj. Profiti neto i sektorit bankar ka shënuar rënie prej 30.5% në vitin 2009, duke çuar në kthim më të ulët të aseteve mesatare (1.4% në krahasim me 2.4% në vitin 2008) dhe mesatare të ekuitetit (13% në krahasim me 24.7% në vitin 2008). Huat e porealizuara janë rritur nga 3.3% të huave totale në vitin 2008 deri në 4.3% në 2009, por shkalla adekuate e kapitalit të sistemit bankar ka qëndruar në 18% të sigurta. Bankat kanë mbetur profitabile edhe në vitin 2010. Të hyrat nga interesi kanë mbetur të mira dhe profitet e mbajtura janë rritur për rreth 50% në fund të korrikut. *Në përgjithësi*, ndërmjetësimi financiar është varur nga një ritëm shumë më i ulët, derisa sektori bankar ka mbetur stabil dhe profitabil.

Aktiviteti i kredive ka vazhduar të rritet në vitin 2009, edhe pse më ngadalshëm në krahasim me vitet e kaluara. Huat e sektorit bankar janë rritur nominalisht me 8.9% për të arritur një të tretën e GDP-së në vitin 2009 dhe janë rritur në 11.3% (vit pas viti) deri në fund të gushtit. Në vitin 2009, kreditë për korporata jofinanciare janë rritur për 4.6% dhe kreditë për ekonomi familjare për 22.3%. Deri në fund të gushtit, kreditë për korporata jofinanciare janë ngadalësuar në 4.1%, ndërsa kreditë për ekonomi familjare janë përsheptuar në 28.5%. Si rezultat, struktura e kredisë ka ndryshuar dhe pjesëmarrja e kredisë të ekonomitë familjare është rritur në kurriz të korporatave tjera jofinanciare, pjesëmarrja e të cilave është ulur për më shumë se 3%, pra nën 70%. Niveli i ulët i prodhimit dhe varësia e lartë e ekonomisë së Kosovës nga importi janë reflektuar në distribuimin sektorial të huave për ndërmarrjet private. Sektori i shërbimeve ka vazhduar të tërheqë shumicën e kredive, por pjesëmarrja e saj ka shënuar rënie për 7% në vitin 2009 në total prej 70.7% të kredive për korporatave jofinanciare deri në fund të vitit dhe kanë vazhduar të bien në vitin 2010. Kreditë për industri, sektorin e energjisë dhe ndërtimtari janë zgjeruar gradualisht (47% rritje vjetore në vitin 2009) dhe kanë arritur çerekun e të gjitha kredive për korporatat jofinanciare. Ky trend ka vazhduar në vitin 2010 dhe deri në fund të gushtit arriti në 28% të të gjitha kredive të institucioneve jofinanciare. Struktura e maturitetit të kredive është përmirësuar paska dhe kreditë me maturitet më të gjatë se dy vite janë rritur në 70% të portofolios totale të huave në vitin 2009 (deri në 62% në vitin 2008).

Pas rritjes prej 20.8% në vitin 2009, rritja e depozitave është ngadalësuar në 11.1% (vit pas viti) në fund të gushtit. Depozitat e ekonomive familjare janë rritur për rreth 25% dhe me një pjesëmarrje prej 67%, kanë përbërë shumicën e totalit të depozitave. Deri në fund të vitit 2009, depozitat totale janë rritur për 45.1% të GDP-së nga 37.5% sa ishin në vitin 2008. Shkalla e huave në relacion me depozitat është rritur në 74% përgjatë vitit shumë më poshtë se pritja joformale se huat në relacion me depozitat nuk duhet të tejkalojnë 80%, por prapë u ngritën në 78% në gusht. Niveli mesatar i interesit vjetor është shpërndarë ndërmjet huave dhe depozitave dhe ka shënuar rënie nga 10.6% në 10.1% në vitin 2009, por prapë shumë e lartë.

Rënia është rezultat i zvogëlimit prej 0.4 përqind në nivelin e interesave të kredive pasi që kishte vetëm 0.1% rritje në mesataren e interesit vjetor të depozitave. Sido që të jetë, shkallët mesatare të huadhënies kanë mbetur në nivel të lartë me 14.4%. Shpërndarja mesatare 12 mujore filloi të rritet prapë në vitin 2010 si rrjedhojë e rënies së nivelit të interesit të depozitave dhe qëndroi në 10.4% në muajin gusht. Sikur edhe në vitet paraprake, shpërndarja është më e ngushtë te huat për ekonomitë familjare sesa për korporatat jofinanciare. Në përgjithësi, bankat komerciale janë bërë më të kujdesshme në zgjerimin e kredive dhe kushtet e huadhënies mbesin të shtrënguara.

3.2. Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Stabiliteti makroekonomik është ruajtur, por cenueshmëria fiskale dhe e jashtme janë rritur. Përzjerja e politikave është çdo herë më e brishtë si rezultat i rritjes së madhe të shpenzimeve qeveritare. Papunësia mbetet shumë e lartë duke shfaqur probleme të thella strukturore në ekonomi. Inflacioni mbetet i paqëndrueshëm, ku çmimet e ushqimit dhe karburanteve japin kontribut të madh. Qeverisja e dobët dhe bërja e politikave *ad hoc* kanë kontribuar në nivel të lartë të pasigurisë ekonomike. Në përgjithësi, brishtësia makroekonomike është rritur dhe problemet e thella strukturore vazhdojnë të pengojnë ekonominë. Sundimi i ligjit i dobët, korrupsioni, niveli i lartë i aktiviteteve joformale, infrastruktura e dobët dhe furnizimi me rrymë i pasigurt dhe i subvencionuar pengojnë efikasitetin e mekanizmave të tregut.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Është arritur progres në sektorin e arsimit me certifikimin e mësimdhënësve dhe edukimit profesional. Një sistem i ri i licencimit të mësimdhënësve është vendosur, bashkë me një Bord për trajnim dhe edukim profesional për të siguruar modernizimin efektiv të institucioneve të edukimit profesional në Kosovë. Megjithatë, arsimit mbetet i frenuar nga kufizimet financiare, mungesa e objekteve adekuate dhe cilësia e dobët e mësimdhënies. Ministria e Arsimit është duke hartuar planprogramin e arsimit të lartë për të adresuar mospërputhshmëritë ndërmjet kërkesës dhe shkathtësive në tregun e punës. Disa shkolla vazhdojnë të operojnë me ndërrime të shumta. Gjendja e tyre fizike mbetet e dobët pasi që nuk kanë ndërtesa, materiale mësimore dhe pajisje adekuate. Kapaciteti hulumtues i universiteteve dhe instituteve hulumtuese mbetet shumë i dobët. Në përgjithësi, është bërë pak progres drejt përmirësimit të cilësisë në arsim dhe ka stimulime të ulëta për mësimin përgjatë jetës.

Investimet totale kanë arritur në 26.3% të GDP-së në vitin 2009, që paraqet rritje nga viti paraprak që ishte 24.4%. Investimet private, edhe pse në rritje në aspektin real, kanë shënuar rënie në termat relativ dhe absolut dhe pjesëmarrja e saj në totalin e investimeve ka rënë për rreth 10 përqind duke arritur në 60%. Pjesëmarrja më e madhe e investimeve publike është kanalizuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Vendimi i papritur për të nisur projektin e madh të autostradës ka bërë që qeveria të rishqyrtojë prioritetet e investimit. Në muajin maj, një konzorcium ndërkombëtar është përzgjedhur për zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës nën partneritet publiko-privat me koncesion për njëzet vite. Depërtimi i telefonisë mobile është rritur në 71% dhe katër operatorë mobil (dy operatorë të rrjetit mobil dhe dy operatorë mobil të rrjetit virtual) janë aktiv në treg. Depërtimi i internetit pa tela (wireless) ka qëndruar në 6.4%. Në përgjithësi, ka pasur përmirësime marginale në kapitalin fizik, por rënia e investimeve private në më të ulëta, për pesë vitet e fundit, si pjesëmarrje e GDP-së mund të pengojë përmirësimin e asaj së furnizimit.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Sektori i ndërmarrjeve në Kosovë mbetet i dominuar nga mikrondërmarrjet. Më shumë se 90% të ndërmarrjeve punësojnë më pak se katër persona. Struktura ekonomike është e koncentruar shumë në sektorin me pakicë, me më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve operative në këtë fushë. Ligji për Zonat Ekonomike është miratuar dhe procedura për krijimin e gjashtë zonave, një në nivel qendror dhe pesë në nivel komunal, ka filluar. Sektori joformal mbetet i madh. Kjo është rezultat i politikave tatimore dhe shpenzuese të dobëta si dhe zbatimit të dobët të ligjit. Kjo redukton bazën tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike. Si masë për të luftuar ekonominë joformale, administrata tatimore ka filluar aplikimin e numrave fiskal dhe instalimin e arkave fiskale. Furnizimi i sigurt me rrymë elektrike mbetet një sfidë për zhvillimin e sektorit privat. Pavarësisht disa përmirësimeve në faturim dhe inkasim në vitin 2009, rreth 42% të energjisë në rrjetin e KEK-ut nuk paguhet. *Në përgjithësi*, po thuhet se nuk ka pasur fare ndryshime në strukturën e ndërmarrjeve dhe shtrirja e gjerë e informaliteteve është mbizotëruese në ekonomi. Sektori i madh joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Autoritetet rregullative mbesin të dobëta. Ligji i ri për miniera dhe minerale i miratuar në korrik e rrezikon seriozisht pavarësinë e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale duke bartur përgjegjësinë për licencim dhe emërim të kryeinspektorit të Inspektoratit të Minerave të Qeveria. Qeveria ka propozuar Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të miratojë një moratorium pesëvjeçar për lëshimin e licencave tjera të telefonisë mobile, i cili, nëse miratohet, do të dëmtojë interesat e konsumatorëve dhe do të zvogëlojë konkurrencën në sektor. Transferimet dhe subvencionet e buxhetit kanë mbetur të pandryshuara nga viti 2008 me 3.5% të GDP-së. Kompania publike e energjisë, KEK-u, vazhdon të tërheq subvencione substanciale për import të energjisë nga buxheti shtetëror dhe hua për financime të programit të investimeve. Qeveria ka ndërmarrë hapat e parë për të adresuar një numër të mangësive në sistemin e prokurimit publik. *Në përgjithësi*, roli i shtetit në ekonomi është rritur.

Integrimi ekonomik me BE-në

Hapja e ekonomisë, e matur nga vlera e importit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si pjesëmarrëse e GDP-së, është rritur në 70.9% nga 68.9% sa ishte në vitin 2008. Eksporti në Shtetet Anëtare të BE-së ka shënuar rënie të theksuar në 24.7% nga 48% sa ishte në vitin 2008 dhe 41.5% të eksportit total në vitin 2009. Kjo vjen si rezultat e rënies së kërkesës së jashtme dhe të çmimeve për eksportin e nikelit të Kosovës. Eksporti në vendet e CEFTA-së ka rënë për 15.3% por pjesëmarrja e tyre në eksportin e përgjithshëm ka qëndruar pothuajse e pandryshuar në 32.0% gjatë vitit 2009. Vendet e BE-së dhe CEFTA-së mbesin origjina kryesore e importit të Kosovës me pjesëmarrje prej 38.7% (36.4% në vitin 2008), përkatësisht 36.1% (37.2% në vitin 2008). Vështirësitë rreth njohjes së vulave doganore pengojnë tregtinë me disa vende të CEFTA-së. Me pothuajse se tri të katërtat e të hyrave të investimeve të huaja në vitin 2009, vendet e BE-së mbesin investitorët më të mëdhenj në Kosovë. *Në përgjithësi*, integrimi ekonomik me BE-në mbetet i ulët.

4. STANDARDET EVROPIANE

Ky seksion ekzaminon kapacitetin e Kosovës për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me ato të *acquis* në lidhje me tregun e brendshëm, politikat sektoriale dhe drejtësinë, lirinë e sigurinë, në përputhje me Procesin e Stabilizim Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Po ashtu analizon kapacitetin administrativ të Kosovës. Në secilin sektor, vlerësimi i Komisionit mbulon progresin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe përmbledhë nivelin e përgjithshëm të përgatitjes së Kosovës.

4.1. Tregu i brendshëm

4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Ka pasur pak progres në fushën e **standardizimit**. Ligji i ri për standardizim është miratuar në tetor 2009, shoqëruar me një akt nënligjor për funksionimin e Agjencisë Standardizuese të Kosovës (ASK) brenda Ministrisë për Tregti dhe Industri. Komitete të reja teknike (në të cilat kompanitë marrin pjesë aktive) janë krijuar në pesë fusha të produkteve, duke arritur në total katërbëdhjetë.

Agjencia për Standardizim e Kosovës nuk është anëtare e organizatës evropiane ose ndërkombëtare të standardizimit. Në ndërkohë, sipas një memorandumi të mirëkuptimit me Ministrinë për Ekonomi, Tregti dhe Energji të Shqipërisë, ASK është në gjendje të miratojë dhe shpërndajë standardet Evropiane (EN) brenda Kosovës. Deri tani, rreth 2,180 EN dhe standarde të bazuara ISO/IEC janë miratuar si standarde të Kosovës, prej të cilave një e treta janë harmonizuar me standardet evropiane. Konsiderohet se ASK nuk ka staf të mjaftueshëm.

Ka pasur progres për **vlerësimin e konformitetit**. Gjatë periudhës raportuese, njëmbëdhjetë organe të reja të vlerësimit të konformitetit janë themeluar, duke u bërë total pesëmbëdhjetë. Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit ende duhet të shqyrtohet me qëllim të përfshirjes së *acquis* horizontale të vitit 2008 për marketing të produkteve.

Është arritur pak progres rreth **akreditimit**. Përveç komitetit teknik ekzistues për laboratorët testues dhe kalibruer, është krijuar një komitet i ri teknik për organet certifikuese dhe inspektuese. Një memorandum i mirëkuptimit për akreditim është nënshkruar me Turqinë në muajin nëntor 2009. Në muajin nëntor 2009, Drejtori i Akreditimit në Ministrinë për Tregti dhe Industri ka nënshkruar një kontratë me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim (EA). Ky është hapi i parë drejt anëtarësimit në EA.

Ka pasur pak progres në **metrologji**. Udhëzime të reja administrative mbulojnë konvertimin e grupeve matëse, autorizimin e subjekteve përgjegjëse për kontrollimin teknik të veturave dhe autorizimin e institucioneve përgjegjëse për verifikim, vlerësim të konformitetit dhe matjen zyrtare të lëngjeve. Është miratuar strategjia për zhvillimin e infrastrukturës metrologjike të Kosovës për vitin 2010-2014 në muajin qershor. Laboratori i ri Qendror për Metrologji i Kosovës ka filluar punën në muajin mars 2010. Veç kësaj, është krijuar edhe një laborator i veçantë për kontrollin e cilësisë së metaleve të çmueshme.

Ka pasur pak progres rreth **mbikëqyrjes së tregut**. Është miratuar ligji i ri për inspektionin e tregut në korrik që bën harmonizimin e procedurave dhe përgjegjësive për mbikëqyrjen e tregut në bazë të *acquis* horizontale të vitit 2008.

Është themeluar një Njësi e re për Sigurinë e Produkteve të Përgjithshme në Inspektoratin e Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe tani merret me mbikëqyrjen e tregut për produktet e ndërtimitarisë, makinerisë, lodrat dhe pajisjet elektrike me tension të ulët. Staf i total i Inspektoratit të Tregut është rritur dhe numri i rasteve vjetore të inspeksionit është ngritur, edhe pse nga një bazë e ulët.

Ka pasur pak progres në fushën e **mbrojtjes së konsumatorëve**. Në dhjetor 2009, Programi për Mbrojtjen e Konsumatorëve për vitet 2010-2014 është miratuar dhe ka filluar zbatimin e tij. Ky program synon të forcojë legjitimitetin e Këshillit për Mbrojtje të Konsumatorëve dhe aktivitetet e tij mbikëqyrëse, bashkë me transparencën dhe përgjegjësinë e institucioneve përgjegjëse para konsumatorëve. Është themeluar një Qendër për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Prishtinë, ku konsumatorët mund të marrin këshilla falas rreth produkteve dhe shërbimeve të konsumatorëve. Kapaciteti administrativ mbetet i ulët. Zyra për Mbrojtje të Konsumatorëve në Ministrinë për Tregti dhe Industri ka të punësuar vetëm një punonjës.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në kornizën ligjore. Megjithatë përafrimi me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është e kufizuar dhe kapaciteti administrativ për transpozim dhe zbatim është i pamjaftueshëm. Ka nevojë për më shumë angazhim në këtë drejtim.

4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **lëvizjes së lirë të personave**.

Pak progres është bërë në reformimin e *koordinimit të sistemeve të sigurisë sociale*. Puna ka filluar për një kornizë strategjike, por ka mungesë të ekspertëve dhe resurseve në këtë fushë.

Pak progres është arritur në **ofrimin e shërbimeve**. Është themeluar një grup punues për koordinimin e harmonizimit të legjislacionit brenda **Ministritë për Tregti dhe Shërbime**. Korniza ligjore nuk është në përputhje me *acquis*. Statistikat për shërbime janë të pakompletuara, duke e bërë hartimin e politikave në këtë fushë më të vështirë. Rregullimi administrativ për të arritur përputhshmërinë graduale me Standardet Evropiane është i pamjaftueshëm.

Pak progres është arritur me **shërbimet postare**. Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Shërbimet Postare, që zëvendëson Ligjin për Shërbime Postare të vitit 2003. Është synuar themelimi i një autoriteti rregullativ përgjegjës për shërbimet postare.

Ka pasur progres të kufizuar në shërbimet financiare. Ligji për Bankën Qendrore është amendamentuar në korrik. Ky ligj forcon pavarësinë dhe përgjegjësinë, modernizon qeverisjen e përbashkët dhe ofron një bazë për ndihmën e kufizuar të likuiditetit emergjent. Ligji për Skemat e Garantimit të Depozitave, i miratuar në fillim të muajit tetor, ofron një nivel të mbulimit prej 2,000 euro, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Lëvizjet e stafit në mbikëqyrjen e bankave janë stabilizuar dhe janë organizuar trajnime të stafit. Mbikëqyrja ka lëvizur nga rregullat e bazuara në CAMEL (mjaftueshmëri të kapitalit, cilësi të aseteve, menaxhim, fitime dhe likuiditet) në një qasje më të hapur të bazuar në rrezik. Dy komitete të brendshme janë themeluar për të vlerësuar situatën ekzistuese rreth zbatimit të Basel I dhe Solvenca I. Mbikëqyrje e konsoliduar është zbatuar në praktikë, por ende mungon baza ligjore formale e plotë.

Nuk ka pasur zhvillime të veçanta për t'u raportuar sa i përket fushave jobankare, tregut të sekuritetëve dhe fondeve të investimeve.

Nuk ka pasur progres në të **drejtën e vendosjes**. Përputhshmëria me standardet e BE-së rreth njohjes së kualifikimeve profesionale është e kufizuar.

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **ligjit mbi kompanitë**. Një projekt për të krijuar *one-stop-shops* për themelimin e kompanive ka vazhduar të zbatohet. Nuk ka progres rreth **auditimit**.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e lëvizjes së personave, shërbimeve dhe të drejtën e vendosjes si dhe ligji mbi kompanitë janë në fazë fillestare.

4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Kosova tanimë ka një regjim shumë liberal sa i përket lëvizjeve të kapitalit. Sa i përket **lëvizjes së lirë të kapitalit**, nuk ka kufizime për pronësi ose investim të huaj në sektorin financiar ose në asetet tjera. Në vitin 2010, investimet e huaja të drejtpërdrejta janë rritur në krahasim me nivelin në vitin 2009 që ishte një vit i prekur nga kriza ekonomike globale. Bankat e huaja menaxhojnë rreth 80% të aseteve në sektorin bankar. Kosova nuk ka bursë ose një treg financiar.

Është arritur progres rreth **sistemeve të pagesave**. Bordi i Bankës Qendrore miratoi Strategjinë e Pagesave Nacionale që ishte hartuar në bashkëpunim me Qeverinë në shtator 2009. Strategjia përqendrohet në aplikimin e sistemit real bruto të vendosjes dhe si pjesë e kësaj, zëvendësimin e mundshëm të sistemit aktual elektronik të verifikimit bankar përmes një sistemi të integruar të pagesave. Sa i përket pagesave ndërkombëtare, Kosova është në proces të negocimit të një kodi të përkohshëm SWIFT (kodi i caktuar i përdoruesit ISO 3166-1) në mungesë të anëtarësimit në KB.

Në përgjithësi, sistemi për lëvizjen e kapitalit është shumë liberal, por përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për aplikimin gradual të kërkesave të rrezikut Basel II dhe të menaxhimit të kapitalit si dhe për të vendosur një kornizë ligjore në përputhshmëri me standardet e BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit.

4.1.4. Doganat dhe tatimet

Ka pasur progres në fushën e **doganave**. Në fund të vitit 2009, janë miratuar udhëzimet administrative për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizës dhe për inspektimin e brendshëm. Shërbimi doganor ka azhurnuar kornizën strategjike të operimit për periudhën 2010-2012. Ky është një dokument kryesor për kornizën afatmesme të shpenzimeve të qeverisë, duke marrë parasysh se mbi 65% të të hyrave publike të Kosovës vazhdojnë të mbliidhen në kufi. Duke marrë parasysh këtë, pavarësia operationale e Shërbimit Doganor, jashtë ndikimit politik, mbetet esenciale. Janë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me Francën, Finlandën, Turqinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Këto synojnë të luftojnë deklaratimet jokorrekte të importeve të Kosovës dhe çojnë në harmonizimin e statistikave tregtare me vendet në fjalë.

Niveli i përgjithshëm i stafit të Shërbimit Doganor është duke u rritur në mënyrë progresive deri në fund të vitit 2010. Njësia Ndërkombëtare, brenda Shërbimit Doganor, është bërë përgjegjëse për monitorimin e progresit drejt mbylljes së zbrazëtisë përballë standardeve të BE-së, siç është identifikuar në planin e vitit të kaluar. Shërbimi Doganor ka përshpejtuar përpjekjet për të luftuar korrupsionin. Numri i stafit që punon në auditimin e brendshëm është rritur. Memorandumet e mirëkuptimit për një qasje të koordinuar kundër korrupsionit janë nënshkruar me policinë, Administratën Tatimore dhe Agjencinë kundër Korrupsionit. Në janar është miratuar një plan i veprimit i përbashkët i doganave dhe tatimeve kundër korrupsionit. Veç kësaj, Shërbimi Doganor dhe Policia janë duke rritur bashkëpunimin për menaxhimin e integruar të kufijve me qëllim të ngritjes së sigurisë në zinxhirin e furnizimit. Kjo përfshin konvertimin e sallës doganore të kontrollit 24 orësh në qendër nacionale për kontroll kufitar, ku të dy institucionet do të punojnë së bashku.

Njësitë e Shërbimit Doganor kanë vazhduar patrullimin në të gjitha rrugët, përveç në Kosovën veriore. Kjo ka reduktuar kontrabandën. Duke filluar nga muaji mars, EULEX-i ka shtrënguar kontrollet në portat 1 dhe 31 në Kosovën veriore, duke përdorur kamera shtesë dhe një server të ri të rrjetit. Verifikimi aktual bëhet në terminalin e Mitrovicës. Të dhënat ndahen me Shërbimin Doganor të Kosovës dhe Administratën Doganore të Serbisë, duke kontribuar në vazhdimin e hetimeve kriminale në të dy anët. Të hyrat totale nga Shërbimi Doganor për shtatë muajt e parë të vitit 2010 ishin rreth 445 milion euro, d.m.th 11% më të larta sesa periudha e njëjtë në viti 2009.

Sistemi aktual i TI-së është duke u zëvendësuar me sistemin *Asycuda World* (Sistemi i Automatizuar për të Dhëna Doganore, të siguruar nga UNCTAD) që do të mbështesë, ndërmjet tjerash, përdorimin e tarifave të integruara të Kosovës. Puna e mëtutjeshme është e domosdoshme për të siguruar përputhshmëri me sistemet e TI-së të BE-së.

Të gjithë anëtarët e Bordit të Pavarur Shqyrtues janë emëruar. Bordi duhet të merr hapa të menjëhershëm për t'u marrë me apelet nga bizneset dhe tatimpaguesit kundër vendimeve të

Shërbimit Doganor dhe Administratës Tatimore. Që nga viti 2008, është bërë një mbingarkesë prej rreth 1,000 rasteve.

Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nuk njohin vulat doganore të Kosovës, pavarësisht që janë siguruar nga PSSP i KB-ve se janë në përputhshmëri me RKS KB 1244/99. Administrata Tatimore e Serbisë që operon në veri të Kosovës është duke lëshuar dokumentacion për firmat serbe në Kosovës, që iu mundëson atyre të shesin produktet e tyre në Serbi. Ky dokumentacion paralel është në kundërshtim me konceptin e Kosovës si një zonë e vetme doganore, në të cilin vetëm institucionet e Kosovës janë të autorizuar të lëshojnë dokumentacion të tillë.

Në përgjithësi, legjislacioni doganor i Kosovës vazhdon të jetë në masë të madhe në përputhje me standardet e BE-së. Fushat specifike që kërkojnë vëmendje janë lufta kundër kontrabandës dhe falsifikimit, ku duhet rritur kapacitetet zbatuese si dhe rritjen e mëtutjeshme të kontrolleve dhe mbikëqyrjes në veri të Kosovës. Bordi i Pavarur Shqyrtues duhet urgjentisht të funksionalizohet në tërësi dhe duhet të reduktohet ngarkesa e rasteve.

Ka pasur pak progres në fushën e **tatimeve**. Në muajin janar 2010, janë miratuar amendamentet në ligjet mbi tatimet në të hyra personale dhe atë të korporatave, duke qartësuar tatimin e personave dhe firmave rezidente dhe jorezidente, duke shmangur tatimin e dyfishtë dhe specifikimin e procedurave të deklarimit të tatimit. Një ligj i ri për TVSH-në ka hyrë në fuqi me 1 janar 2010, i cili siguron shkallë më të lartë të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së. Kufiri i regjistrimit të TVSH-së ka mbetur në 50,000, që i len shumë kompani jashtë TVSH-së. Përveç kësaj, janë miratuar udhëzime administrative në dhjetor 2009 rreth zbatimit të amendamenteve të ligjit për administratën tatimore të Kosovës që ka hyrë në fuqi në vitin 2009. Në muajin maj 2010, një strategji për përputhshmëri tatimore është miratuar që synon reduktimin e mundësive për evazion dhe shmangie, ngrit mbledhjen e hershme dhe efektive dhe përmirëson edukimin e tatimpaguesve.

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, Administrata Tatimore filloi lëshimin e numrave fiskal për bizneset. Deri tani, janë lëshuar 44,000 numra. Në këtë proces, më shumë se 31,000 biznese joaktive janë fshirë nga baza e të dhënave të Administratës Tatimore. Në muajin mars 2010, ka filluar instalimi i arkave fiskale për bizneset. Si përgatitje për sistemin e ri të TI-së, avancimi i SIGTAS (sistemit të integruar për menaxhim të tatimit) është bërë në korrik të vitit 2010. Format e deklarimit elektronik për të gjitha llojet e tatimit tani janë në dispozicion në faqen e internetit të Administratës Tatimore. Po ashtu, sistemi i dosjeve elektronike të Administratës Tatimore tani është funksional.

Në shkurt të vitit 2010, është themeluar Zyra për Planifikim Strategjik dhe Modernizim, brenda Administratës Tatimore, për të zhvilluar projektet strategjike siç janë aplikimi i sistemit të ri të TI-së dhe të arkave fiskale dhe veprimet për të zbatuar planin e vitit të kaluar të BE-së. Në po këtë muaj, është themeluar një Njësi e re e Hetimit të Tatimeve. Me qëllim të ngritjes së nivelit të mbledhjes së tatimeve, janë instaluar shkëmbimet automatike të informatave në korrik të vitit 2010 të Thesarit dhe Shërbimit Doganor, bashkë me një instrument për menaxhim të borxhit që do të lehtësojë shqyrtimin e centralizuar të debitorëve.

Të hyrat tatimore ishin 131 milion € në shtatë muajt e parë të vitit 2010, që është 13% më e lartë sesa periudha e njëjtë në vitin 2009.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në fushën e tatimeve, në veçanti rreth përputhshmërisë legjislative. Megjithatë, janë të nevojshme përpjekjet shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit, zbatimin e pagesave tatimore dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale.

4.1.5. Konkurrenca

Ka pasur pak progres në fushën e **konkurrencës**. Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është miratuar në fillim të muajit tetor. Qëllimi i ligjit është përputhshmëria e rregullave të konkurrencës së Kosovës me *acquis* të Bashkimit Evropian, në veçanti përmes qartësimit të rregullave të keqpërdorimit të dominimit dhe aplikimit të rregullave të shkrirjes si dhe forcimin e procedurave të zbatimit.

Sa i përket kapacitetit administrativ, Komisioni i Pavarur i Konkurrencës ka vazhduar me aktivitetet e veta dhe ka hetuar disa shkelje të dyshuara të rregullave të konkurrencës. Kapaciteti i tij është rritur me staf mbështetës për pesë anëtarët e Komisionit. Komisioni i Konkurrencës ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit me autoritetet e konkurrencës së Shqipërisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Nuk ka progres rreth ndihmës shtetërore. Projektligji për **ndihmën shtetërore** është në Kuvend, i cili parasheh, ndërmjet tjerash, themelimin e një komisioni të pavarur shtetëror për miratimin e ndihmës.

Progres i kufizuar është arritur sa i përket kornizës legjislative. Pak progres është bërë rreth kapacitetit administrativ dhe në përgjithësi rreth kapacitetit për zbatimin e politikës **anti-trust**. Megjithatë, në përgjithësi, zbatimi i konkurrencës dhe politikës së ndihmës shtetërore në Kosovë është në fazë të hershme. Ka mungesë të stafit të specializuar dhe me përvojë. Procedurat për bashkëpunim me subjektet tjera të përfshira në çështjet e konkurrencës, siç janë rregullatorët ekonomik duhet të forcohen. Ka nevojë për ngritjen e vetëdijes për njoftimin e sektorit privat me rregullat e konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës duhet të jetë më shumë i përfshirë në aspektet e konkurrencës në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha publike (p.sh. PTK-së.).

4.1.6. Prokurimi publik

Mund të raportohet për progres të kufizuar në fushën e prokurimit publik. Qeveria ka prezantuar draftin e ri të ligjit për prokurim publik para Kuvendit. Ligji ende nuk është miratuar. Dispozitat rreth koncesioneve në këtë kornizë ligjore ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga *acquis*.

Sa i përket kapacitetit administrativ, puna e Organit Shqyrtues të Prokurimit është përmirësuar përmes një publikimi më sistematik të vendimeve si dhe në aspektin e argumentimit ligjor të vendimeve. Kredibiliteti i këtij institucioni mbështetet në ndërtimin e një regjistri autoritativ të shqyrtimit të vendimeve në të ty gjuhët zyrtare si dhe në shmangien e konfliktit të interesave që rezultojnë nga ndërveprimi me hartuesit e politikave. Po ashtu, kredibiliteti varet nga transparenca e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, përfshirë mënyrën se si merren vendimet.

Një plan i ri për certifikimin e zyrtarëve të prokurimit është përgatitur; do të ofrohen certifikata të përhershme për personat që kanë kryer trajnimin për tri vite të njëpasnjëshme. Megjithatë, zyrtarët e prokurimit mbesin në një pozitë të vështirë dhe i nënshtrohen frikësimit. Mekanizmat koordinues të palëve kryesore me interes në sistemin e prokurimit publik duhet të forcohen tutje, në veçanti reduktimi i hapësirës për korrupsion

Prandaj, përgjegjësia për proceset e prokurimit duhet të zgjerohet për të përfshirë jo vetëm zyrtarët e prokurimit, por edhe eprorët e tyre, si në nivel administrativ ashtu edhe në atë politik. Gjithashtu, duhet të përmirësohet trajnimi dhe certifikimi i personave aktiv në fushën e prokurimit, posaçërisht duke marrë parasysh numrin e vogël të zyrtarëve të licencuar të prokurimit në Kosovë në krahasim me buxhetin total të shpenzuar në prokurim.

Sfidat e tjera përfshijnë lëvizjet e shumta të zyrtarëve të prokurimit në nivele qendrore dhe lokale dhe monitorimin e zbatimit të kontratave të prokurimit.

Shumë organe publike nën buxhetin e qeverisë ende kryejnë proceset e tyre të prokurimit dhe nuk shfrytëzojnë Agjencinë për Prokurim Publik si autoritetin kryesor kontraktues dhe ekzekutues, pavarësisht nga fakti se është nxjerrë udhëzimi administrativ përkatës në qershor. Në rastet e mallrave dhe shërbimeve bazë, sikur t'i kishte zbatuar kjo agjenci marrëveshjet dhe të organizojë prokurimet në tërë qeverinë, resurset buxhetore do të shfrytëzoheshin në mënyrë më efikase sesa kur secila organizatë kryen procedurat e veta individuale të prokurimit.

Vlera e kontratave të prokurimit publik të dhëna ka mbetur në nivel të njëjtë me atë të vitit 2009 rreth 20% të GDP-së së Kosovës. Procedurat e hapura janë rritur në 85% të vlerës totale të kontratave të nënshkruara në vitin 2009 dhe procedurat e negociuara kanë shënuar rënie në 11%, ndërsa procedurat tjera përdoren vetëm margjinalisht.

Auditori Gjeneral ka rekomanduar forcimin e monitorimit dhe përcjelljes së aktiviteteve të prokurimit, përfshirë veprimet që synojnë të sigurojnë që rekomandimet e agjencive mbikëqyrëse të zbatohen dhe që zyrtarët të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre.

Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kornizën ligjore në fushën e koncesioneve, të forcojë pozitën e zyrtarëve të prokurimit publik përballë hierarkisë së tyre, të rrit trajnimin me qëllim të krijimit të ekspertëve të pavarur të prokurimit në pozitat kryesore dhe të zbatojë rregulloret e fazës implementuese të kontratës së proceseve të prokurimit publik. Kapaciteti administrativ dhe mekanizmat koordinues të të gjitha palëve me interes në sistemin e prokurimit publik duhet të forcohen më shumë, në veçanti ngushtimi i hapësirës për korrupsion.

4.1.7. Ligji për pronën intelektuale

Ka pasur progres të kufizuar në fushën e **të drejtave në pronë intelektual**. Strategjia dhe Plani i Veprimit për DPI për vitet 2010 – 2013 është miratuar në muajin qershor.

Ka pasur pak progres rreth të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme. Ligji për mbrojtjen e topografive dhe qarqeve të integruara është miratuar në muajin qershor. Zyra për të Drejtat e Autorit është themeluar në muajin qershor 2010 por ende nuk është plotësisht funksionale. Ligji ekzistues i të drejtave të autorit duhet të amendamentohet më tutje për t'u përputhur me standardet e BE-së.

Ka pasur progres të kufizuar në fushën e **të drejtave të pronës industriale**. Këto projektligje rreth Patentave, Markave Tregtare dhe Dizajnit Industrial janë në pritje në Kuvend. **me qëllim të sigurimit të nivelit më të lartë të përputhshmërisë me *acquis*, Marrëveshja TRIPS dhe standardet tjera ndërkombëtare**. Është krijuar një bazë e të dhënave për regjistrimin elektronik të markave tregtare, dizajnit dhe patentave për zëvendësimin e sistemit të bazuar në letër.

Kapaciteti për zbatimin e legjislacionit mbi patentat, markat tregtare dhe dizajnin industrial mbetet i ulët, pavarësisht nga rritja e stafit në Zyrën për Pronë Industriale. Regjistrimi i markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale është arritur, por jo aq sa për të përballuar numrin e kërkesave.

Pak progres është vërejtur rreth zbatimit të drejtave në pronë intelektuale. Në janar 2010, ligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave në pronë intelektuale është miratuar, bashkë me një udhëzim administrativ për zbatim të tij. Stafi që punon për të drejtat në pronë industriale në Shërbimin Doganor është rritur në mënyrë substanciale, duke siguruar praninë e zyrtarëve për të drejta intelektuale në çdo pikë doganore. Nivelet e larta të falsifikimit dhe

piratërisë janë të pranishme. Megjithatë, kapaciteti administrativ për zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale dhe të drejtave në pronë industriale mbesin të pamjaftueshme si dhe janë të nevojshme dispozitat zbatuese. Përgjegjësitë për organet e ndryshme që merren me zbatim, bashkë me ndarjen e përgjegjësive ndërmjet tyre, nuk janë definuar si duhet. Ngritja e vetëdijes për çështje të ndërlidhura me të drejtat e pronës intelektuale duhet të ngritet si brenda qeverisë ashtu edhe te popullata.

Në përgjithësi, korniza legislative e të drejtave në pronë industriale ende nuk është finalizuar. Pak progres është arritur rreth legjislacionit dhe kapacitetit administrativ. Megjithatë, zbatimi mbetet shumë i dobët. Janë të nevojshme angazhime të konsiderueshme për zbatim dhe ngritje të vetëdijes. Sistemi i të drejtave të pronës intelektuale në Kosovë mbetet në një fazë fillestare.

4.1.8. *Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik*

Kosova ka shënuar përparim të kufizuar drejt harmonizimit me standardet evropiane në këtë sektor.

Kosova ka miratuar një program zhvillimor të **punësimit** të qëndrueshëm me qëllim të krijimit të shpejt të punësimit përmes një programi të punëve publike. Ajo ka miratuar strategjinë e saj të punësimit 2010-2012 përfshirë një plan operacional dhe një Plan të Veprimit për Rininë. Është miratuar ligji mbi trajnimet profesionale, ri-trajnimet dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Regjistrimi i të papunëve është përmirësuar, përfshirë edhe femrat nga komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian si dhe personave me aftësi të kufizuara. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmjetësuar në punësimin e 524 punëkërkuesve nga të gjitha komunitetet pakicë, përfshirë komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian si masë për të ushtruar një ndikim pozitiv në tregun e punës.

Megjithatë, politikat e punësimit kërkojnë më shumë zotim nga qeveria. Shërbimi publik i punësimit ka kapacitete të ulëta. Plani për ngritje të kapaciteteve për ministrinë dhe shërbimet publike të punësimit ende nuk është miratuar. Partnerët social janë të angazhuar jo sa duhet në politikat dhe masat e punësimit. Tregu i punës është i pazhvilluar me një segment të konsiderueshëm të ekonomisë joformale. Pjesëmarrja dhe shkalla e punësimit mbetet në mënyrë dramatike e ulët. Papunësia vazhdon të mbetet e lartë sidomos mes femrave dhe të rinjve. Kohëzgjatja e periudhave të papunësisë është e ekstreme dhe shumica e të papunëve janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës. Ekzistojnë stimulime të kufizuara për punëkërkuesit dhe punëdhënësit. Grupet e marginalizuara po ashtu kanë nevojë për më shumë vëmendje.

Progres i kufizuar mund të raportohet në lidhje me **politikat sociale**. Dokumenti (Letra e Bardhë) mbi politikat sociale nuk është miratuar duke e lënë Kosovën pa prioritetet strategjike në këtë fushë.

Korniza ligjore mbetet e dobët dhe e joadekuate për t'u ballafaquar me sfidat praktike. Në veçanti, *Ligji i Punës* duhet të miratohet.

Ka pasur progres të kufizuar në harmonizimin me standardet evropiane në fushën e *shëndetit dhe sigurisë në punë*. Inspektorati i punës ka nevojë të përmirësojë kapacitetet e veta për monitorim efektiv dhe implementim të legjislacionit relevant. Komunat e reja nuk mbulohen me inspektorë të punës.

Dialogu social është përmirësuar me miratimin e Ligjit mbi Grevat. Megjithatë, është bërë pak në fushën e dialogut social. Për shkak të mungesës së Ligjit të Punës, si një akt kyç ligjor, miratimi i pjesëve të tjera themelore të legjislacionit, siç janë Ligji mbi Sindikatat dhe Ligji mbi Këshillin Socio-Ekonomik janë shtyrë. Kriteret e qarta për pjesëmarrjen e këtyre të fundit

nuk janë caktuar ende. Sindikatat e shërbimeve publike kanë organizuar protesta gjatë kësaj periudhe raportuese.

Në fushën e mundësive të barabarta, janë krijuar disa instrumente për të promovuar të drejtat e grave, por përparimi në arritjen e vërtetë të barazisë gjinore dhe zbatimit të ligjit ka nevojë të avancohet më tej. Pjesëmarrja e femrës në tregun e punës mbetet jashtëzakonisht e ulët dhe përfaqësimi i femrave në vendimmarrje mbetet një sfidë.

Është shënuar pak progres në fushën e *gjithëpërfshirjes sociale dhe anti-diskriminimit (shih po ashtu 2.2)*. Decentralizimi i shërbimeve të vendit ka vazhduar të mos shënojë përparim. Korniza e nevojshme ligjore për të rregulluar ofrimin efikas të këtyre shërbimeve ende është në fazë të hartimit. Shërbimet vazhdojnë të ofrohen kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile. Këshilli për Shërbime Sociale dhe Familjare, subjekti përgjegjës për licencimin e ofruesve të shërbimeve publike, ende nuk është plotësisht funksional – struktura e tij financiare dhe operationale nuk është e rregulluar si duhet dhe korniza e nevojshme ligjore nuk është në dispozicion. Seminari i parë mbi mbrojtjen sociale dhe gjithëpërfshirjen sociale mes përfaqësuesve të Komisionit, autoriteteve dhe shoqërisë civile u mbajt në shtator të vitit 2010. Mungesa e mundësive për punësim është një sfidë e përgjithshme që ndikon negativisht në gjithëpërfshirjen sociale. Veprimet adekuate për të adresuar gjithëpërfshirjen sociale të grupeve specifike, përfshirë edhe të kthyerit rom, ende mungojnë.

sa i përket *mbrojtjes sociale*, mungesa e një ligji për sigurim social, e si pasojë edhe sistemit të sigurimit social, vë kufizime shtesë mbi familjet kosovare. Shumë shërbime shëndetësore duhet të paguhen drejtpërsëdrejti nga qytetarët në vend se të mbulohen nga një skemë e sigurimit shëndetësor.

Megjithatë, duket sikur mekanizmat kryesor financiar sipas këtij ligji bazohen në kontributet nga punësimi formal, që është mjaft i ulët në Kosovë.

Është shënuar progres i kufizuar në fushën e shëndetit publik. Ministria e Shëndetësisë ka miratuar strategjinë e re shëndetësore (2010-2014) në vitin 2009, duke u përqendruar në uljen e morbiditetit dhe mortalitetit përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Cilësia e ulët e të dhënave shëndetësore në nivelet qendrore dhe komunale dhe sistemet paralele të serbëve të Kosovës mbesin pengesë për zhvillimin e politikave. Ministria e Shëndetësisë duket të specifikojë në mënyrë të qartë ndarjet buxhetore për përkujdesjen ndaj nënave dhe foshnjave. Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013, burimet financiare do të përqendrohen në infrastrukturë dhe rindërtim, përderisa shumë pak buxhet ndahet për shëndetin primar dhe parandalimin. Përkujdesja shëndetësore për nënat dhe foshnjat në Kosovë konsiderohet si më i dobëti në Evropë dhe në vendet fqinje. Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave konsiderohet të jetë mes 35 deri në 49 në çdo 1,000 lindje të gjalla. Në veri, kontaminimi me plumb është ende kërcënues për shëndetin e të gjithë qytetarëve që jetojnë afër zonave të kontaminuara. Në përgjithësi, sektori shëndetësor mbetet shumë i dobët dhe vërtetë ka nevojë për një vëmendje më të madhe nga autoritetet.

Në përgjithësi, pak përparim mund të raportohet në sektorët e punësimit, politikave sociale dhe shëndetit publik. Kapacitetet e dobëta administrative dhe mungesa e një kornize adekuate ligjore mbesin pengesa serioze për zgjerimin e këtyre sektorëve.

4.1.9. *Arsimi dhe hulumtimet*

Pak progres mund të raportohet në fushën e **arsimit** kur është fjala për harmonizimin me standardet evropiane. Konsultime të gjera janë bërë në përpjekje për të modernizuar si Ligjin mbi Arsimin Para-Universitar ashtu edhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë. Ministria e Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë ka udhëhequr procesin për të modeluar kornizën e re të plan-programeve. Qeveria ka miratuar një strategji për mbrojtjen e shëndetit nëpër shkolla.

Është themeluar Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Ushtruesi i funksionit të drejtorit është emëruar krahas katër pjesëtarëve të stafit dhe bordit të tij. Këshilli për Arsim Profesional dhe Trajnime (CVET) është bërë operacional. Kosova ka trajtuar më tej çështjen e mësimin me shumë ndërrime, gjë që kërkon vëmendje dhe burime të vazhdueshme për ndërtimin e më shumë objekteve shkollore.

Megjithatë, burimet në nivel komunal mbesin të dobëta duke penguar zbatimin e dispozitave ligjore kyçe që janë në përgjegjësi të komunave. Trajnimet para shërbimit aktualisht janë të kufizuara brenda një fakulteti i cili ka nevojë të modernizohet. Licencimi i mësimdhënësve dhe korniza e re e plan-programeve kërkojnë investime të mëdha për zhvillimin institucional të trajnimit të mësimdhënësve para dhe gjatë marrëdhënies së punës.

CVET përballlet me kufizime në kapacitetet dhe funksionalitetin e tij. Ai ka nevojë të rrisë përpjekjet për të modernizuar në mënyrë efektive institucionet e trajnimeve profesionale, në veçanti për të trajnuar studentët në përputhje me kërkesën e tregut të punës, standardet evropiane dhe kornizën kosovare të kualifikimeve. Kriteret për kualifikim në sektorin e AAP nuk janë sa duhet të lidhura me ato të arsimit të përgjithshëm dhe të lartë.

Kosova ka zhvilluar dhe miratuar plan-programet e saj të para të lëndëve për gjuhën rome, histori dhe kulturë për shkollat fillore. Një varg i debateve publike janë mbajtur për të promovuar dhe ngritur vetëdijen për këtë. Materialet për mësimdhënie janë në përdorim për plan-programet në gjuhët rome, boshnjake dhe turke.

Megjithatë, tekstet shkollore në gjuhën rome ende nuk janë në dispozicion. Komunitetet pakicë janë shpesh të pasqyruara negativisht në libra të historisë (Shih po ashtu pjesën *kriteret politike, të drejtat kulturore*).

Hulumtimi është bërë prioritet. Këshilli për hulumtime ka zhvilluar Strategjinë Kombëtare për Shkencë për pesë vjetët e ardhshme duke synuar që gradualisht të rriten investimet në hulumtim dhe në stimulimin e bashkëpunimit me industrinë dhe me BE-në dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Si partnerë ndërkombëtarë të hulumtimeve, entitetet hulumtuese kanë mundësi të aplikojnë për projekte të hulumtimit sipas Programit të Kornizës së Shtatë për Hulumtime (FP7). Kosova ka organizuar disa sesione informative mbi FP7 dhe ka emëruar pikat kontaktuese për FP7. Ministria ka themeluar një fond për hulumtime shkencore duke ndarë një milion € për fushat kyçe për zhvillim ekonomik.

Në përgjithësi, mund të raportohet për pak përparim në lidhje me harmonizimin me standardet evropiane në fushën e arsimit dhe hulumtimeve. Megjithatë, të gjitha përpjekjet duhet të jenë me çmime të përballueshme dhe të bashkërenduara. Kapacitetet menaxhuese janë të dobëta, sikur edhe mundësia për të drejtuar procesin arsimor në nivel lokal. Kontrolli i cilësisë, përfshirja e pakicave dhe plan-programet mësimore janë të gjitha çështje që duhet adresuar. Përpjekjet për të forcuar kapacitetet hulumtuese janë të domosdoshme për të jetësuar strategjinë kombëtare.

4.1.10. Çështje që lidhen me OBT-në

Kosova nuk është anëtare e OBT-së dhe nuk ka ndërmarrë hapa zyrtarë për t'u anëtarësuar në të.

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Është shënuar pak përparim në fushën e **industrisë dhe NVM-ve**.

Regjistri i biznesit tash përfshin rreth 45,000 kompani aktive. Informacionet mbi kompanitë e regjistruara mund të sigurohen automatikisht nga interneti (online). Regjistrimi online i

bizneseve është bërë i mundshëm nga muaji qershor. Një pilot projekt për hapjen e një *one-stop-shop* ka filluar në tetë komuna dhe është duke u zgjeruar në mënyrë progresive.

Kosova është zotuar të jetësojë Aktin e Bizneseve të Vogla për Evropë dhe ka identifikuar prioritetet: promovimin e ndërmarrësisë, përmirësimin e qasjes online për NVM-të dhe përfitimet nga një treg i vetëm. Në mungesë të një kornize të qartë strategjike për zhvillimin e **NVM-ve**, aktivitetet e Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë udhëhiqen nga një Akt i Bizneseve të Vogla. Kapacitetet administrative të agjencisë mbesin të kufizuara.

Në dhjetor të vitit 2009, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë hartoi strategjinë industriale të Kosovës për periudhën 2010–2013. Qëllimi kryesor i saj është të rritet cilësia e politikave industriale. Dokumenti ofron një analizë të sektorëve industrial të Kosovës bashkë me ide për të përmirësuar konkurrencën e tyre dhe mundësitë për punësim. Strategjia parasheh një rol më të madh për industrinë përkitazi me kontributin e saj për GDP, eksport dhe investime. Megjithatë, kjo strategji nuk është miratuar nga qeveria dhe si e tillë nuk përmban një plan për implementim ose masa për politika.

Janë hartuar udhëzime administrative për të ndihmuar implementimin e Ligjit mbi Zonat Ekonomike. Numri i kompanive aktive në parqet e biznesit në Drenas dhe Mitrovicë është rritur.

Në fillim të vitit 2010, u nënshkruan marrëveshje për mbrojtjen e investimeve me Austrinë, Belgjikën dhe Luksemburgun.

Pengesat kryesore me të cilat përballen bizneset në Kosovë mbesin mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me energji, qasja e kufizuar në financa dhe sundimi i pamjaftueshëm i ligjit.

Në përgjithësi, kapacitetet administrative dhe korniza strategjike për zhvillimin e NVM-ve duhet të forcohet edhe më tej. Këshillohet një bashkërendim adekuat mes strategjive dhe planeve që lidhen me zhvillimin e këtij sektori. Strategjia e sapo hartuar industriale e Kosovës duhet të zhvillohet dhe të shndërrohet në masa efektive të politikave.

4.2.2. *Bujqësia dhe peshkataria*

Aktivitetet e vazhdueshme legjislative në fushat e mbuluara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë rezultuar me miratimin e disa dokumenteve nga Kuvendi. Në shkurt u miratuan ndryshimet në Ligjin mbi Pyjet duke pasqyruar bartjen e përgjegjësi për menaxhimin e pyjeve tek niveli komunal. Projektligji mbi organizmat e modifikuar gjenetikisht është tërhequr. Ndryshimet e planifikuara në Ligjin mbi bujqësinë organike, si përpjekje për të marrë parasysh legjislacionin më të ri të BE-së, ende nuk janë miratuar. Këto ndryshime po ashtu synojnë të themelojnë inspektoratin kombëtar të Kosovës dhe organet certifikuese për bujqësinë organike. Certifikimi aktualisht kryhet nga dy kompani të akredituara ndërkombëtare. Ligji mbi ujitjen e tokave bujqësore u amendamentua në muajin korrik.

Është themeluar regjistri i vreshtave. Rrjeti i të dhënave për kontabilitetin e fermave (FADN) është zhvilluar edhe më tej. Megjithatë, të dhënat nuk shfrytëzohen për hartimin e politikave. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave tregtare bujqësore duhet të përmirësohet edhe më tej.

Ministria ka filluar të implementojë Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2009-2013. Ai ka paraqitur një skemë që përbëhet nga pagesa të dyfishta për bujqit, në sektorët e drithërave dhe blegtori si dhe asistencë për sektorët e produkteve të qumështit, pemëve dhe perimeve në nivel të fermës. Për këtë qëllim, një Njësi për Pagesa është themeluar në Ministri dhe është përgjegjëse për pranimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për asistencë nacionale, pagesën dhe verifikimet në terren, ndonëse përzgjedhja e përfituesve

kërkon përmirësime të mëtejme dhe pengohet nga mungesa e një regjistri të fermave dhe titullarëve të paqartë pronësorë.

Në shkurt të vitit 2010, qeveria miratoi strategjinë zhvillimore të pyjeve për periudhën 2010-2020 dhe planin e veprimit. Fushat prioritare për këtë strategji përfshijnë menaxhimin dhe mbrojtjen e pasurive të pyjeve dhe zhvillimin e industrisë pyjore. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të rritur bashkërendimin dhe transparencën ndërmjet institucioneve në çështjet si nxjerrja e gurëve dhe zhavorrit nga toka pyjore. Janë nënshkruar memorandume të mirëkuptimit mbi çështje të pyjeve nga 37 komuna, të cilat duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të menaxhuar kompetencat e transferuara në këtë fushë. Ligji i ri i rrit dënimet për prerjen ilegale të drunjve por ende mbetet një burim i shqetësimeve dhe aplikimi i këtyre dënimeve varet nga kapacitetet e policisë dhe gjykatave për të ndjekur rastet penalisht.

Në muajin shtator, Qeveria miratoi rregulloren për organizimin dhe kompetencat e Bordit Monitorues dhe Rregulloren mbi themelimin e bordit shkencor të Agjencisë për Veterinari dhe Ushqim e Kosovës (AVUK); dhe anëtarët e të dy organeve ende nuk janë emëruar. Po ashtu në shtator, Qeveria miratoi Udhëzimin Administrativ mbi strukturën e re organizative dhe funksionimin e Agjencisë. Një memorandum i mirëkuptimit është nënshkruar mes institucioneve relevante dhe Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari për bartjen e disa organeve ekzistuese të kontrollit tek Agjencia. Megjithatë, bartja e autoritetit inspektues nga komunat tek Agjencia, siç parashihet nga Ligji i Ushqimit, ende nuk është kompletuar.

Është arritur pak përparim në krijimin e infrastrukturës së teknologjisë informative (IT) për sistemin e identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit të lëvizjeve të kafshëve. Sistemi nuk është plotësisht operacional. Futja e të dhënave ka filluar për disa lloje, por kjo ende nuk është bërë sistematike dhe disa lindje të kafshëve dhe lëvizje të tyre nuk raportohen. Kontrollat në tregjet e kafshëve janë të pamjaftueshme dhe pasqyra e përgjithshme është e turbullt nga therja ilegale dhe kontrabanda me kafshë. Nuk ekzistojnë objekte për përpunimin e nënprodukteve të kafshëve. Një studim i para-realizueshmërisë (para-fizibilitetit) për themelimin e një fabrike riprodhuese është kryer. Ndërkohë, këto nënprodukte të kafshëve do të duhet të hidhen nëpër deponi të mbeturinave.

Rregulloret për transpozimin e pakos higjienike të BE-së ende nuk janë miratuar. Përmirësimi i planifikuar i objekteve agro-ushqimore mbetet në një fazë të hershme, ndonëse është bërë përparim në vlerësimin dhe kategorizimin e fabrikave të produkteve të qumështit, thertoreve dhe objekteve të përpunimit të mishit. Një grup i ekspertëve është caktuar të vlerësojë objektet ekzistuese agro-ushqimore në frymën e praktikave të BE-së për higjienë, prodhim dhe trajtim të ushqimit. Ky vlerësim pritet të rezultojë me një strategji për të përmirësuar institucionet agro-ushqimore të Kosovës. Infrastruktura dhe pajisjet e pikave kufitare të përzgjedhura paraprakisht për inspektime veterinarie mbetet e dobët.

Ligji mbi mbrojtjen dhe prodhimin e bimëve ka nevojë të harmonizohet edhe më shumë me standardet e BE-së. Pajisjet dhe stafi i laboratorit të AVUK janë të pamjaftueshme për t'i mundësuar agjencinë që të kryejë rolin e vet.

Shumica e standardeve evropiane mbi **peshkatarinë** nuk janë të aplikueshme për Kosovën, meqë ajo nuk ka peshkim detar.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë një progres të kufizuar legjislativ në fushën e bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit. Përderisa korniza ligjore ka nevojë të përmirësohet, sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve dhe strategjive, pasi që kapacitetet

administrative në institucione të ndryshme mbesin të dobëta dhe burimet njerëzore nuk shfrytëzohen në mënyrën më efikase. Duhet rritur përpjekjet për të forcuar dhe siguruar një regjistrim më sistematik të kafshëve dhe përmirësimin e institucioneve agro-bujqësore.

4.2.3. Mjedisi

Është shënuar progres substancial në fushën e **legjislacionit horizontal**, me Ligjet mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor të miratuar në shtator, si dhe me implementimin e rregullave për pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin e ndikimeve në mjedis. Bashkëpunimi mes OJQ-ve mjedisore dhe ministrisë ka vazhduar dhe rreth 20% e projekteve të parapara në planin e veprimit për mjedis janë përfunduar.

Në fushën e **cilësisë së ajrit**, mund të raportohet për pak progres, me miratimin e Ligjit mbi mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe implementimin e masave për të monitoruar shkarkimin e gazrave nga burimet mobile. Strategjia për cilësinë e ajrit ende nuk është miratuar. Një nga katër stacionet e planifikuara për monitorimin e ajrit është futur në punë. Lista e ndotësve të ajrit ende nuk është hartuar. Nuk është shënuar progres në definimin e roleve institucionale dhe përgjegjësi në këtë fushë.

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e **menaxhimit të mbeturinave**. Ligji i ri për mbeturinat parasheh decentralizimin e kompetencave në këtë fushë por duhet të miratohet harmonizimi i mëtejme me standardet e BE-së. Legjislacion shtesë për implementim është miratuar. Ende nuk ka filluar krijimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të hedhurinave. Parimi 'ndotësi paguan' ende aplikohet pak dhe shkalla e inkasimit për mbeturina nga shërbimet komunale mbetet e ulët.

Sa i përket **cilësisë së ujit**, mund të raportohet pak progres. Ligji i ri për ujërat i cili duhet të rregullojë pronësinë e burimeve të ujit dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhimin e ujit si dhe ndërtimin e pellgjeve të lumenjve dhe një institut kosovar të ujit nuk është miratuar ende. Një raport i fizibilitetit për cilësinë e ujit të pijshëm është hartuar dhe rekomandon themelimin e një departamenti për cilësinë e ujit të pijshëm brenda Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik. Ekziston një mungesë e qartë e burimeve njerëzore në këtë fushë dhe investime të pamjaftueshme në infrastrukturë: ekziston vetëm një fabrikë për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë. Vetëm 70% e popullatës janë të lidhur me sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe një e treta në sisteme të kanalizimit. Shkalla e pagesës së faturave për shërbime të ujit ka rënë. Përgjegjësitë institucionale për menaxhimin e digave nuk janë të ndara qartë. Siguria e infrastrukturës së madhe, si digave, pendëve dhe tubave të ujit, kërkojnë menaxhim dhe monitorim të duhur i cili nuk sigurohet në mënyrë adekuate për momentin.

Angazhime të mëtutjeshme janë të nevojshme për të rritur bashkërendimin dhe transparencën mes institucioneve për licencimin dhe kontrollin e nxjerrjes së gurëve dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve (pas dëmtimeve nga nxjerrja në lumin Drini i Bardhë) dhe nga toka në pyje (në Novobërdë, një zonë e mbrojtur nga UNESCO).

Në fushën e **mbrojtjes së natyrës**, Ligji mbi mbrojtjen e natyrës u miratua në muajin shtator. Disa aktivitete janë kryer për të identifikuar zonat e zogjve të rëndësishëm.

Është bërë pak progres në fushën e **kontrollit të ndotësve industrial dhe menaxhimit të rrezikut** me miratimin e Ligjit mbi parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Legjislacioni për implementim mbetet të hartohet.

Nuk mund të raportohet për progres në fushën e **materieve kimike** dhe **mbrojtjes civile**. Në fushën e **zhurmës**, disa udhëzime administrative janë miratuar për të implementuar ligjin për mbrojtje nga zhurma.

Në fushën e **ndryshimeve klimatike**, Kosova nuk është pjesë as e Konventës Kornizë të KB-ve mbi ndryshimet klimatike e as e Protokollit të Kyotos. Kosova nuk ka strategji për ndryshime klimatike dhe nuk ka themeluar ndonjë listë të gazrave të liruara nga serrat. Ajo vazhdon të ketë mungesë të burimeve dhe mungesë të stafit. Implementimi i legjislacionit për ndryshime klimatike mbetet problematik.

Sa i përket **kapaciteteve administrative**, janë bërë disa përpjekje për të përmirësuar bashkërendimin mes ministrive dhe organeve të ngarkuara me përgjegjësi mjedisore. Udhëzimi administrativ që e vë Institutin Hidro-Meteorologjik nën Agjencinë për Mbrojtje Mjedisore nuk është nënshkruar. Departamentet administrative përgjegjëse për mjedis vazhdojnë të përballen me një mungesë akute të resurseve. Buxheti i ministrisë është më i ulëti nga të gjitha ministritë e tjera në Kosovë, madje është zvogëluar në raport me vitin 2009 (si rezultat i reduktimeve të fondeve për të siguruar financim për programin e ndërtimit të rrugës së korridorit 7). Mungesa e stafit e bën të vështirë për Ministrinë dhe për Agjencinë të kryejnë përgjegjësitë e tyre. Disa detyra janë bartur tek niveli komunal, por komunat shpesh kanë mungesë stafi dhe ekspertize. Autoritetet janë zotuar të angazhojnë shoqërinë civile në proces të harmonizimit të legjislacionit me *acquis*, megjithatë kjo nuk është siguruar plotësisht.

Në përgjithësi, harmonizimi me standardet mjedisore të BE-së është ende në një fazë të hershme, ndonëse mund të vërehet progres në miratimin e legjislacionit. Për më tepër, implementimi dhe zbatimi i legjislacionit mjedisor mbetet problematik. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të themeluar një infrastrukturë administrative dhe institucionale efektive dhe për të përmirësuar kanalet e bashkërendimit mes institucioneve me përgjegjësi mjedisore në të gjitha nivelet dhe me shoqërinë civile. Shkalla e faturimit dhe inkasimit për shërbime të ujit dhe të mbeturinave duhet të përmirësohet. Investimet në fushën e mjedisit, e në veçanti në infrastrukturën mjedisore, kanë nevojë për t'u shtuar në mënyrë të konsiderueshme.

4.2.4. *Politikat e transportit*

Ka pasur pak progres në **rrjetet transportuese trans-evropiane**. Kosova ka vazhduar të marrë pjesë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 për zhvillimin e Rrjetit Transportues Rajonal për Evropën Juglindore dhe në Observatorin e Transportit në Evropën Juglindore. Puna ka filluar në projektin kryesor të infrastrukturës rrugore në Kosovë, ndërtimin e autostradës nga kufiri me Shqipërinë deri në Prishtinë. Megjithatë, madhësia dhe shtrirja e projektit nuk është proporcionale me rrjedhën e parashikuar të trafikut dhe kostoja e këtij projekti çuar në reduktime buxhetore në ministri të tjera dhe burime të pamjaftueshme janë ndarë për mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve.

Në fushën e **transportit rrugor**, ka pasur pak progres në ngritjen e kapaciteteve të Njësisë për Planifikim të Transportit brenda Ministrisë. Megjithatë, ministria vazhdon të jetë tepër e angazhuar në aspektet praktike të menaxhimit të rrugëve në vend se të përqendrohet në zhvillimin e strategjive dhe politikave. Departamenti për Infrastrukturë Rrugore është duke u riorganizuar për të bërë një dallim më të qartë mes mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes dhe zhvillimit të rrjetit rrugor. Në rrugën drejt Traktatit të Komunitetit të Transportit u nënshkruan marrëveshje bilaterale të qasjes në tregjet transportuese me Shqipërinë, Bullgarinë dhe Turqinë. Një plan veprimi shumëvjeçar për sigurinë rrugore u miratua në muajin maj; një plan

i veprimet duhet të përgatitet për të implementuar strategjinë. Inspektorati i Transportit Rrugor duhet të forcohet. Për shkak të një numri të kufizimeve që lidhen me statusin (dhe pamundësia për t'u anëtarësuar në AETR), Kosova ende nuk ka qenë në gjendje të implementojë takografin digjital.

Mund të raportohet për pak progres **në transportin hekurudhor**. Një ligj i konsoliduar që mbulon të gjitha aspektet e sektorit hekurudhor është në hartim e sipër, me qëllim të tërheqjes së investimeve në hekurudha dhe në hapjen e tregut hekurudhor. Organi rregullativ për hekurudha ende nuk është operacional. Kryetari i bordit të tij është emëruar, porse drejtori i përgjithshëm nuk është përzgjedhur ende. Akti ligjor që ndan anën e infrastrukturës dhe atë operacionale në Hekurudhat e Kosovës (KR) është nënshkruar. Dokumentet ligjore për shthurjen e Hekurudhave të Kosovës në një ndërmarrje hekurudhore dhe caktimi i një menaxheri për infrastrukturë janë në përgatitje e sipër. Paralelisht, po përgatitet edhe deklarata për rrjetin 2010.

Marrëveshja me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për kalimin hekurudhor të kufijve, bazuar në një model të harmonizuar rajonal, të përgatitur nga SEETO, është në fazën përfundimtare të procedurave në të dy ministritë e jashtme. Flota e transportit të udhëtareve është modernizuar. Transporti hekurudhor i mallrave është rritur për 11% në vitin 2009, kryesisht falë rritjes së tregtisë nga eksportuesi më i madh i Kosovës, prodhuesi i nikelit, Ferronikeli. Hekurudhat e Kosovës shënuan rezultate pozitive financiare falë një menaxhimi strikt të kostos dhe përmirësimeve në trafikun e mallrave (ndonëse transporti hekurudhor nuk ishte një prioritet qeveritar). Megjithatë, sektori i hekurudhave ka mungesë të personelit të kualifikuar dhe pavarësisht menaxheriale.

Si një vend pa dalje në det e pa një flotë, shumica e legjislacionit të *acquis* për **transportin detar** nuk vlejnë për Kosovë. Është miratuar azhurnimi i strategjisë multimodale në muajin dhjetor. Kjo do të përcillet nga strategji të veçanta sektoriale. Nuk ka pasur progres në lidhje me **transportin e kombinuar**.

Ka pasur progres të konsiderueshëm në **transportin ajror**. Legjislacioni substancial, sipas Marrëveshjes Evropiane për një Zonë të Përbashkët të Aviacionit (ECAA), tashmë është integruar në legjislacionin e vendit dhe implementimi i plotë i fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes mund të jetë i mundshëm deri në fillim të vitit 2011, me kusht që përpjekjet të vazhdojnë në të gjitha fusha, përfshirë ndihmën shtetërore dhe orarin e punës. Siguria e aviacionit kombëtar dhe programet e kontrollit të cilësisë u miratuan në dhjetor të vitit 2009. Përparimi vazhdoi në fushën e menaxhimit të trafikut ajror ku legjislacioni i vetëm i fluturimeve evropiane është transpozuar në shkallë të lartë. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të kompletuar harmonizimin rregullativ me hapësirën e vetme evropiane brenda Programit ISIS. Qeveria duhet të forcojë kapacitetet e saj për të tërhequr profesionistë në rregullimin e transportit ajror dhe në implementimin e standardeve të aviacionit për të përmbushur kriteret nga ECAA.

Në muajin maj, një konzorcium ndërkombëtar u përzgjedh për të zhvilluar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës si pjesë e një partneriteti publiko-privat me një koncesion prej njëzet vjetësh. Një Komision Hetues për Aksidentet e Avionëve është themeluar në Zyrën e Kryeministrit. Në muajin dhjetor, Ministria e Punëve të Brendshme miratoi Programin Kombëtar për Sigurinë e Aviacionit Civil, që përcakton praktikën, procedurat dhe rregulloret për të mbrojtur sigurinë e udhëtareve, ekuipazhit dhe personelit të aeroportit në Kosovë.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në investimet në rrugët ekzistuese dhe të reja. Megjithatë, infrastruktura e transportit ngelet e pazhvilluar. Kontrata për të ndërtuar korridorin 7, e nënshkruar këtë vit, është aq e madhe sa që po i redukton investimet në fushat e tjera. Zhvillimet në fushën e aviacionit kanë qenë pozitive. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit nuk ka kapacitete për t'u marrë me të gjitha çështjet në sektorin e transportit dhe themelimi i ngadalshëm i agjencive rregullatore po e pengon implementimin e standardeve të BE-së nga ana e Kosovës. Duhet të bëhen përpjekje shtesë për të përmirësuar sigurinë rrugore dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor duhet të jetë prioritet më i lartë.

4.2.5. *Energjia*

Sektori i energjisë vazhdon të përballet me probleme serioze. Niveli i ulët i faturimit dhe inkasimit vazhdon të ngarkojë edhe më tej financat e furnizuesve me rrymë. Rrjedhimisht, furnizimi me rrymë në Kosovë mbetet i pasigurt, me reduktime të rrymës të shpeshta.

Strategjia e qeverisë për energji për periudhën 2009-2018 u miratua në muajin prill. Shtyllat kryesore të strategjisë përbëhen nga sigurimi i furnizimit, ristrukturimi i sektorit, zhvillimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve gjeneruese, zhvillimi i transmisionit dhe distribucionit, promovimi i investimeve të huaja, promovimi i energjisë efikase dhe shfrytëzimi i energjisë së ripërtërishme si dhe zhvillimi i infrastrukturës së gazit.

Nuk ka pasur fare zhvillim gjatë vitit të fundit lidhur me **sigurimin e furnizimit**. Nuk ka ligj ose strategji për **rezervat e naftës**; niveli i rezervave të naftës së Kosovës është i panjohur. Si pasojë e pengesave nga Serbia, operatori i sistemit të transmisionit të rrymës i Kosovës (KOSTT) vazhdon ta ketë të vështirë të marrë pjesë si partner i barabartë në mekanizmat komercial të rajonit. Humbjet e shkaktuara si pasojë e kësaj barten tek konsumatorët. KOSTT ka bërë një ankesë tek EMS (Operatori Serb i Sistemit të Transmisionit) me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në pikëpamjet e tij preliminare, konsideron se EMS 'ka dështuar të përmbushë obligimet e tij që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Me mbështetjen e BE-së dhe të donatorëve të tjerë, operatori ka bërë progres të mirë në rritjen e kapaciteteve të rrjetit të transmisionit dhe sigurisë së rrjetit. Megjithatë, deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Serbinë, operatori nuk mund të marrë pjesë në mekanizmat rajonal.

Është bërë progres në lidhje me **tregun e brendshëm të energjisë** dhe implementimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). Planet për zhvillimin e termocentralit Kosova e Re (projekt për prodhimin e rrymës nga linjiti) janë rikonfiguruar. Kapaciteti fillestar i instaluar do të jetë dy njësi prej nga 200-300 MW, fusha e linjtit në Sibovc do të zhvillohet menjëherë dhe pjesëmarrja në termocentralin Kosova B do të përfshihet në pakon që do t'u ofrohet investuesve me qëllim të renovimit të tij. Ndarja ligjore e funksioneve të distribucionit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) parashihet të bëhet në fund të vitit 2010 me synim të privatizimit. Deri në përfundimin e projektit për termocentralin Kosova e Re, funksionet e tjera do të mbesin të integruara në KEK. Shkalla e faturimit dhe inkasimit e KEK-ut mbetet shumë e dobët. Përveç humbjeve të larta teknike dhe komerciale, në vitin 2009 KEK-u mblodhi pagesa vetëm për 65% të energjisë të cilën e ka ofruar, që ka rezultuar me një humbje prej rreth 36 milionë eurosh. Shkalla e parave të grumbulluara është rritur. Megjithatë, kjo shkaktohet pjesërisht nga rritja e energjisë së konsumuar. Nivelet e ulëta të inkasimit (dhe tarifave pa kthim të kostos) vazhdojnë të ushqejnë një rritje të paqëndrueshme të kërkesës për rrymë.

Një studim dhe një plan i veprimit për shuarjen e njësisë operuese të Kosovës A janë finalizuar në mars të vitit 2010. Kosova ka themeluar një varg grupesh punuese për t'u

përgatitur për këtë shpërbërje, për të cilën Kryeministri është zotuar të arrihet deri në vitin 2015 me qëllim të harmonizimit me Direktivën për Djegie të Mëdha.

Një pako e tri ligjeve (për energjinë, rrymën elektrike dhe rregullatorin e energjisë) u miratua në muajin tetor. Pako u parapri me diskutime të gjera me partnerët e Kosovës për modelin e tregut për të tërhequr angazhimin e sektorit privat në gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin me rrymë. Ligjet e reja synojnë të harmonizojnë legjislacionin e Kosovës me pakon e dytë të brendshme të tregut të BE-së për energji ndonëse ky harmonizim kërkon edhe implementimin e legjislacionit dhe forcimin e rolit të rregullatorit. Modeli i tregut të ri parasheh edhe pronësi private në gjenerim dhe furnizim me rrymë me qëllim që t'u mundësohet më shumë palëve të futen në tregjet e rrymës në Kosovë. Një Ligj i ri Kornizë mbi gazin natyror u miratua në muajin nëntor. Ndonëse Kosova nuk ka një treg të gazit, politikat qeveritare duhet të promovojnë pjesëmarrjen në projektet rajonale të furnizimit me gaz, me synim të sjelljes së një gypi furnizues me gaz në Kosovë.

Një rënie e theksuar në çmimet e importit dhe subvencionet e vazhdueshme qeveritare për KEK-un e shtynë Zyrën e Rregullatorit për Energji (ERO) që të vazhdojë me tarifat aktuale për transmisionet ekzistuese të rrymës dhe rrymën elektrike me pakicë. Megjithatë, një rritje graduale në tarifa është e nevojshme për të pasqyruar nivelet reale të kostos dhe për të tërhequr investimet private në funksionet e distribucionit dhe furnizimit. Zvogëlimi gradual i subvencioneve të qeverisë do të lehtësonte këtë proces. Kapacitetet institucionale dhe legjislative si të ministrisë ashtu edhe të rregullatorit duhet të forcohen më tutje. Tërheqja dhe mbajtja e stafit të kualifikuar mbetet një problem.

Në fushën e **energjisë efçiente dhe energjisë së ripërtërishme**, ligji mbi energjinë efçiente ende nuk është miratuar. Përveç harmonizimit me *acquis* për etiketimin, eko-dizajnin, performancën e energjisë në ndërtesa dhe shfrytëzimin efikas të energjisë, ligji synon të sigurojë bazën ligjore për themelimin e një agjencie për energji efçiente dhe për të caktuar procedurat për themelimin e fondit për energji efçiente për të promovuar projektet me energjinë efçiente dhe burimet e energjisë së ripërtërishme. Ministria ka përgatitur një draft plan kombëtar për energji efçiente që mbulon periudhën 2010-2018, me synim të rritjes së efçiensës për 9% deri në vitin 2018.

Sa i përket energjisë së ripërtërishme, janë duke u bërë përgatitje për të shpallur tenderin për hidrocentralin e Zhurit. Rregullatori veçse ka autorizuar tri turbinat e para të erës në Kosovës me një kapacitet të përgjithshëm prej 1.35 MW, i cili po ashtu ka pranuar edhe shtatë aplikacione të tjera për ndërtimin e turbinave me erë në Kosovë. Rregullatori ka miratuar tarifa konkurruese e stimuluese për hidrocentrale të vogla dhe ato energji të erës. Megjithatë, kërkojnë përpjekje të mëtejme drejt krijimit të një mjedisi të përshtatshëm rregullativ për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtërishme në të gjithë sektorët e kërkuar nga *acquis* e BE-së për energji të ripërtërishme. Masat rregullative dhe veprimet mbështetëse duhet të synojnë që të bëjnë promovimin e shfrytëzimit të materieve ripërtërishme për të gjitha qëllimet energjetike.

Në fushën e **sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga rrezatimet**, Ligji për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues dhe siguria nukleare u miratua në muajin shkurt. Ai parasheh themelimin e një agjencie për mbrojtje nga rrezatimet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo nuk ka ndodhur ende. Veç kësaj, ligji është i natyrës shumë të përgjithshme: transpozimi i *acquis* së BE-së për sigurinë nukleare dhe mbrojtjen nga rrezatimi në legjislacionin kombëtar ende nuk ka filluar.

Në përgjithësi, Kosova më në fund ka bërë progres në harmonizimin ligjor dhe është përpjekur të harmonizojë nevojat për të plotësuar obligimet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë me tërheqjen e investitorëve privat. Mbesin sfida të mëdha për t'u adresuar në lidhje me implementimin e ligjeve dhe politikave të energjisë, duke përfshirë zbatimin e pagesave të rrymës, menaxhimin e kërkesës duke harmonizuar tarifat me koston dhe krijimin e kushteve për investime të jashtme në industrinë e energjisë së Kosovës si bazë për zhvillim ekonomik.

4.2.6. *Shoqëria informative dhe mediet*

Është bërë pak progres në lidhje me **komunikimet elektronike dhe teknologjinë e informimit**. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) miratoi planin e tij të punës për vitin 2010 në muajin janar. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka hartuar një strategji dhe një plan të veprimit për të krijuar një pikë shkëmbimi të internetit. Kosova as nuk ka emër të domenit të nivelit të lartë të kodit shtetëror të internetit e as një kod ndërkombëtar telefonik.

Rregullatori ka miratuar një Rregullore për përzgjedhjen dhe parapërzgjedhjen e bartësve dhe po ashtu Rregullatori mbi radio stacionet për të cilat nuk kërkohet licencë e spektrit të frekuencave. Shtrirja e telefonisë fikse, me dy operatorë të licencuar është ende e ulët me 5%. Depërtimi i telefonisë mobile ishte 71% (në fund të vitit 2009) me katër operatorë mobil (dy operatorë të rrjeteve mobile dhe dy operatorë virtualë të rrjeteve mobile) aktiv në treg. Depërtimi i rrjetit pa tela (wireless) është 6.4%. Njëmbëdhjetë operatorë të licencuar ofrojnë shërbime të internetit, katër prej të cilëve janë operatorë nacional ndërsa të tjerët lokal.

Ka pasur pak aktivitete rreth rregullimit të tregut. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit përballet me kufizime substanciale për përgatitjen dhe implementimin e legjislacionit si rrjedhojë e mungesës së burimeve njerëzore, ekspertizës dhe kufizimeve të pavarësisë së tij financiare. Si pasojë, ART-ja nuk ka kapacitetin dhe autoritetin e nevojshëm për të kryer detyrat e veta plotësisht si një autoritet i pavarur rregullativ.

Procesi i privatizimit të PTK (Postës dhe Telekomit të Kosovës) ka filluar dhe pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2010. Ky privatizim është pjesë e marrëveshjes mes Kosovës dhe FMN-së.

Është arritur progres i kufizuar në fushën e **shërbimeve të shoqërisë informative**. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale është miratuar. Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e krimeve kompjuterike (cybercrime) është miratuar në muajin qershor. Ligji i vitit 2005 mbi shërbimet e shoqërisë informative nuk është implementuar plotësisht dhe shërbimet e e-geverisë nuk janë zhvilluar ende.

Ka pasur progres substancial në **politikat audiovizuele dhe media**, kryesisht përmirësime në fushën e financimeve dhe kapaciteteve administrative për Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Numri i punonjësve është rritur nga 21 në 28. Këshilli ka lëshuar një Rregullore mbi komunikimet komerciale audiovizuele me qëllim të harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me Direktivën e Shërbimeve të Medieve Audiovizuele për reklamimin. Këshilli ka kompletuar procesin e ri-licencimit të transmetuesve. Megjithatë, Kuvendi ende nuk e ka përfunduar emërimin e anëtarëve të KPM-së. Qeveria ka iniciuar amendamentimin e ligjit për KPM-në. Drafti aktual nuk ia del të ruajë pavarësinë e Këshillit në përputhje me standardet evropiane për rregullimin e medieve. Kosova nuk ka bërë progres drejt përmbushjes së objektivave për digjitalizim, me qëllim të përfundimit të këtij procesi deri më 2015 (në përputhje me qasjen rajonale të digjitalizimit deri në vitin 2015). Kosova ende nuk është

anëtare e Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion dhe ka ndarje të pamjaftueshme të frekuencave për këtë qëllim.

Në muajin shkurt, producentët nga televizioni serb lansuan një rrjet TV Mreza duke lidhur katër stacionet televizive në gjuhën serbe nga Kosova dhe duke mbuluar 80% të pakicës serbe të Kosovës.

Pavarësia e transmetuesit publik (RTK) dhe qëndrueshmëria e tij financiare nuk janë siguruar plotësisht, duke e bërë atë të brishtë ndaj ndikimeve politike. Fondi emergjent për gjashtë muaj i siguruar nga Kuvendi mendohej si një zgjidhje e përkohshme për të shpëtuar RTK-në nga falimentimi deri në gjetjen e një zgjidhje afatgjate. Ky fond emergjent është zgjatur edhe për gjashtë muaj dhe Kuvendi ka bërë pak progres drejt gjetjes së zgjidhjes. Meqë kuotat e pagesës nga publiku për RTK-në ishin pezulluar, transmetuesi nuk mund të ndante 5% të kësaj pagese për fondin e mbështetjes së medieve të pakicave, shumetnike dhe të medieve tjera speciale, siç kërkohet me ligj. Shpërndarja e fondit, që rifilloi vitin e kaluar, si pasojë e kësaj u ndërpre sërish.

Mospërputhjet mes Ligjit mbi Shpifjet dhe Fyerjet dhe Kodit Penal ende nuk janë zgjidhur. Sipas standardeve evropiane, shpifja nuk duhet të jetë vepër penale. Kosova nuk aplikon dispozita penale ndaj shpifjes, por meqë ato janë në dokumentin e statutit, vazhdon të krijojë paqartësi ligjore. Kjo do të zgjidhet përmes procesit të amendamentimit të Kodit Penal të Kosovës.

Shoqata e Pavarur e Medieve Transmetuese të Kosovës, e cila përfshin të gjitha mediet elektronike, si shqiptare ashtu edhe të serbëve të Kosovës, është një shembull i bashkëpunimit konstruktiv mes komuniteteve.

Në përgjithësi, është bërë progres i kufizuar në fushën e shoqërisë informative dhe medieve. Niveli i konkurrencës është ende i ulët dhe pavarësia e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit duhet të forcohet. Përpjekjet e rregullatorit në fushën e politikave audiovizuale dhe mediale dallojnë me paaftësinë e hartuesve të politikave për të gjetur një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit publik, që tashmë po ushtron ndikim në pluralizmin e medieve në Kosovë. Është e rëndësishme të ruhet dhe ri-forcohet pavarësia e Komisionit të Pavarur të Medieve gjatë amendamentimit të Ligjit për KPM-në.

4.2.7. *Kontrolli Financiar*

Ka pasur pak progres në **kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP)**. Puna është duke vazhduar për të azhurnuar dokumentin ekzistues të politikës së KBFP. Janë miratuar udhëzimet administrative për të mbështetur zbatimin e Ligjit për Auditim të Brendshëm. Ato përfshijnë licencimin e përkohshëm të auditorëve, funksionimin e njësive audituese dhe të komiteteve të auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm është duke lëvizur ngadalë nga testimi i thjeshtë i përputhshmërisë drejt shfrytëzimit si mjet menaxherial. Është miratuar rregulla e Thesarit mbi parimet e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar. Rregulla numër një e Thesarit për kontrollin e brendshëm të financave publike është rihartuar për ta forcuar menaxhimin financiar dhe praktikën e kontrollit si dhe funksionet përkatëse të Njesisë Qendrore të Harmonizimit. Njësia Qendrore e Harmonizimit për menaxhim dhe kontroll financiar është përforcuar dhe janë kryer pilot aktivitete duke përfshirë shfrytëzuesit e buxhetit në nivele qendrore dhe lokale. Trajnimi i auditorëve ka vazhduar, duke rezultuar në një numër më të madh të auditorëve të certifikuar.

Sa i përket **auditimit të jashtëm**, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm miratoi mjete të reja operationale, duke përfshirë manualin e auditimit të rregullsisë, udhëzimet e auditimit të

performancës, kornizën e cilësisë dhe auditimet e përkohshme, të gjitha me synim të vendosjes së një dialogu më të mirë me organet e auditimit. Në qershor të vitit 2010, kanë përfunduar auditimet e jashtme për 33 komuna. Në vitin auditues 2009/2010, auditimet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë dyfishuar. Zbatimi i raporteve dhe rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga organizatat buxhetore janë përmirësuar, duke iu falënderuar pjesërisht bashkëpunimit më të mirë me Komisionin Parlamentar për mbikëqyrjen e menaxhimit të financave publike dhe bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Pavarësia financiare e zyrës ka nevojë të fuqizohet. Qeveria edhe më tutje mund të ndikojë në buxhetin dhe shpenzimet e saj.

Në përgjithësi, ka pasur progres në këtë fushë, edhe pse Kosova edhe më tutje mbetet në një fazë fillestare të aplikimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. Kosova duhet të përqendrohet më shumë në zhvillimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, duke e ngritur vetëdijen për politikën e saj të KBFP dhe duke filluar me aplikimin e auditimit të brendshëm si një mjet këshillues e konsultues për menaxhment. Zhvillimi i auditimit të jashtëm është në rrugën e duhur. Pavarësia financiare e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm mbetet një burim shqetësimi.

4.2.8. *Statistikat*

Ka pasur pak progres në fushën e **infrastrukturës statistikore**. Bashkëpunimi me disa prodhues dhe shfrytëzues të statistikave është përmirësuar. Një memorandum mirëkuptimi është nënshkruar me Ministrinë e Bujqësisë. Megjithatë, Entit Statistikor të Kosovës ende i mungojnë resurset njerëzore dhe financiare. Hapësira në zyrë mbetet e pamjaftueshme dhe situata e stafit në departamentin e TI-së, në veçanti, është jo e mirë.

Ka pasur progres të kufizuar në **klasifikime** dhe regjistra. Ka filluar aplikimi i klasifikimit NACE Rev.2 të aktiviteteve ekonomike në regjistrin e biznesit. Regjistri i biznesit është operacional, por nuk azhurnohet rregullisht. Të dhënat e nevojshme administrative nuk sigurohen nga Administrata Tatimore. Ligji mbi procedurat tatimore edhe më tutje ka nevojë të ndryshohet me qëllim që të mundësojë bartjen e të dhënave individuale në Entin Statistikor të Kosovës.

Ka pasur progres në fushën e **statistikave sektoriale**. Ligji i Regjistrimit të Popullatës është miratuar në fillim të tetorit. Kanë vazhduar përgatitjet për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë dhe të ekonomive familjare në muajin prill 2011. Megjithatë, ende duhet të sigurohet financimi për regjistrim dhe fushatat e informimit duhet të intensifikohen. Në lidhje me fushat e tjera të statistikave sociale, përgatitjet për aplikimin e analizës tremujore të fuqisë punëtore janë kompletuar dhe afatet kohore të hulumtimit të buxhetit familjar janë përmirësuar.

Ka pasur pak progres sa i përket statistikave makroekonomike. Afatet kohore të llogarive nacionale në përputhje me qasjen e shpenzimeve janë përmirësuar dukshëm. Një plan veprimi për zhvillim të mëtejshëm të llogarive nacionale është hartuar në shkurt të vitit 2010, por Enti Statistikor ende nuk i bën llogaritë nacionale tremujore. Banka Qendrore ka filluar të bëjë publikimin e bilancit të pagesave në baza tremujore. Shporta për indeksin e çmimeve të konsumit është azhurnuar.

Progres është bërë në fushën e statistikave bujqësore. Treguesit e çmimit bujqësor janë azhurnuar në vitin 2005 si viti i ri bazë si dhe cilësia e hulumtimit të ekonomive familjare bujqësore është rritur më tej. Statistikat e mbeturinave komunale janë publikuar për të parën herë. Kërkohen përmirësime të mëdha në statistikën e biznesit. Cilësia e të dhënave të tregtisë së jashtme nga autoritetet doganore duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Përgatitjet në fushën e statistikave të sektorit janë avancuar mesatarisht.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në statistikat sektoriale, por përpjekje të konsiderueshme shtesë janë të nevojshme për ta përmirësuar statistikat e biznesit dhe ato makro-ekonomike në veçanti. Situata e burimeve mbetet e dobët. Puna përgatitore për regjistrimin e përgjithshëm të vitit 2011 duhet të përforcohet.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi

Kosova nuk e ka **politikë të vizave**. Ligji mbi të huajt që rregullon hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Kosovë nuk është zbatuar plotësisht. Udhëzimet administrative për zbatimin e ligjit janë nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme. Shumica e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut kanë skaduar në gusht të vitit 2010. Pasaportat e vjetra jugosllave kanë mbetur të vlefshme gjatë periudhës raportuese, mirëpo numri i bartësve të këtyre pasaportave është zvogëluar. Është bërë amendamenti i ligjit për dokumentet e udhëtimit për t'u përgatitur për lëshimin e pasaportave biometrike. Pasaportat, letërnjoftimet dhe dokumentet e gjendjes civile të Kosovës kanë standarde të larta teknike të sigurisë. Është arritur progres në digjitalizimin e regjistrave të gjendjes civile dhe në lidhjen e zyrave të gjendjes civile me internet. Megjithatë, ligji për gjendjen civile duhet të miratohet dhe udhëzimet administrative të mëtjshme për zbatimin e ligjit duhet të aprovohen. Cilësia e të dhënave, sigurisë dhe kontrollit të gjendjes civile për mbledhjen e të dhënave të gjendjes civile dhe lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile është një brengë e rëndësishme. Këto mangësi duhet të adresohen para se të fillohet me lëshimin e pasaportave biometrike. Për më tepër, një sistem i adresave për tërë-Kosovën duhet të vendoset dhe duhet bërë funksional për të siguruar të dhëna të besueshme për qëllime të regjistrimit civil.

Sa i përket **menaxhimit të kufijve**, Kosova ka bërë pak progres. Hapa të mëtejme janë ndërmarrë për zbatimin e strategjisë së menaxhimit të integruar të kufijve. Megjithatë, duhet të përshpejtohet zbatimi i saj. Është krijuar një qendër e përbashkët operacionale ndërmjet policisë dhe doganave. Qasje në këtë Qendër kanë edhe shërbimet e ushqimit dhe veterinarisë në Kosovë, e cila duhet të shfrytëzohet nga këto shërbime në praktikë. Një strukturë e përbashkët një-ndalje (Policia, Dogana dhe Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë) është përruar në pikën e kalimit kufitar Gllloboqicë. Kjo e çon numrin e pikave kufitare me strukturë një-ndaljeje në dy sosh.

Është hartuar një plan për transferimin e përgjegjësisë për kufirin e gjelbër/mbikëqyrjen kufitare. Policia e Kosovës e ka marrë përsipër përgjegjësinë prej KFOR-it për mbikëqyrjen e kufirit me Shqipërinë. Stafit nga Policia e Kosovës është ka marrë këto detyra të reja me sukses. Shërbimi Doganor i Kosovës ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore me Shqipërinë, Finlandën, Francën, Malin e Zi dhe Turqinë. Policia e Kosovës dhe EULEX-i kanë vizituar Frontex-in.

Megjithatë, zbatimi i plotë i strategjisë për menaxhimin e integruar të kufijve kërkon përpjekje të mëtjshme dhe pjesëmarrje e përgjegjësi të barabartë të të gjitha agjencioneve të përfshira. Ligji përkatës nuk është zbatuar plotësisht. Nuk janë miratuar të gjitha udhëzimet administrative në lidhje me ligjin. Kontrollat kufitare nuk janë kryer në përputhje me standardet e BE-së. Autoritetet e Kosovës nuk e kanë aftësinë e planifikimit dhe të pronësisë, kur është fjala për identifikimin e zgjidhjeve të TI-së për menaxhim kufitar. Kosova ka nevojë për t'u siguruar se sistemi i menaxhimit kufitar në pajtim me BE-në të bëhet operacional sa më shpejt që të jetë e mundur. Kosova nuk arriti të demonstroj vullnet politik për të siguruar zbatimin e këtij projekti të financuar nga BE-ja. Nuk është bërë demarkacioni i kufirit me Malin e Zi. Ka pasur incidente në kufirin në mes të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës, që kanë ilustruar dallimet e bashkëpunimit policor ndërmjet tyre. Kapaciteti zbatues i Shërbimit Doganor të Kosovës dhe policisë kufitare duhet të përmirësohet dhe

duhet të intensifikohet lufta kundër krimit ndër-kufitar. Kufijtë/kufiri administrativ i Kosovës ende nuk janë siguruar plotësisht, duke përfshirë edhe sfidat në zbulimin dhe trajtimin e rasteve të dokumenteve të falsifikuara.

Veriu mbetet sfida e veçantë. EULEX-i ka intensifikuar operacionet e patrullimit, regjistrimit dhe kontrollimit të operacioneve në portat 1 dhe 31 dhe përgjatë kufirit me Serbinë. Të dhënat e mbledhura nga të dy portat janë ndarë me Shërbimin Doganor të Kosovës dhe Doganën e Serbisë. Megjithatë, kontrollet e plota doganore në portat 1 dhe 31 nuk janë rivendosur, për shkak të rrethanave politike.

Në përgjithësi, Kosova është në një fazë të hershme të adresimit të sfidave të menaxhimit të integruar të kufijve. Duhet të arrihet progres në politikën e vizave në pajtim me standardet e BE-së.

Në fushën e **azilit**, është arritur progres i kufizuar. Janë aprovuar disa udhëzime administrative për zbatimin e Ligjit për Azil. Numri i kërkesave për azil është ende i vogël, por është rritur në mënyrë të konsiderueshme (nga 31 në 2009 në 131 në Janar-Shtator 2010) duke shkaktuar sfida për autoritetet e Kosovës. Një strehimore e përkohshme për vendosjen e 20 deri 30 azilkërkuessve është hapur. Kjo është e pamjaftueshme. Disa vendime mbi statusin e azilit janë nxjerrë me ndihmën e EULEX-it. Është emëruar ushtruesi i detyrës së shefit të divizionit për azil në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim. Po ashtu të gjithë anëtarët e organit administrativ të apelit janë emëruar dhe kanë mbajtur takimin e parë në muajin korrik. Shumë nga azil-kërkuessit që kanë arritur në Kosovë gjatë periudhës raportuese kanë shkuar në destinacione tjera pa kontroll adekuat nga autoritetet e Kosovës. Janë raportuar raste ku përcaktimi i statusit të refugjatit nuk është arritur brenda një kohe të arsyeshme.

Duhet të hartohet një udhëzim shpjegues për të drejtat dhe obligimet e azil-kërkuessve. Kapaciteti i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim në Ministrinë e Brendshme dhe të Policisë për t'u marrë me azil-kërkuessit dhe aplikacionet e tyre mbetet i dobët. Trajnimi duhet të rritet. Kosova edhe më tutje duhet ta zhvilloj një bazë të besueshme të të dhënave për azil kërkuessit. Nuk u është lëshuar asnjë dokument identifikimi aplikuesve për azil nga autoritetet e Kosovës, siç është paraparë në ligjin për azil. Në vitin 2009, Kosova ishte e pesta në listën e vendeve të origjinës së aplikuesve për azil në Shtetet Anëtare të BE-së.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e azilit janë ende në një fazë të hershme.

Kosova ka arritur progres në fushën e **migrimit**. Zyra për lëshimin e lejeve për qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm për të huajt është hapur në korrik. Një numër i marrëveshjeve është nënshkruar për ripranimin e personave në Kosovë. Në qershor, është miratuar ligji për ripranim. Ligji i plotëson kërkesat e BE-së në masë të madhe. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim ka vazhduar t'i trajtoj kërkesat e ripranimit nga vendet Evropiane në mënyrë efikase dhe duhet të vazhdoj me këtë trend. Ndihma e ofruar për të kthyerit e detyrueshëm jepet për vetëm shtatë ditë pas arritjes së tyre në Kosovë. Strategjia e rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe një plan veprimi janë miratuar gjatë periudhës raportuese duke u bazuar në një vlerësim të detajizuar të zbrazëtive. Plani i veprimit përbën një bazë të mirë për përmirësim në këtë fushë. Është formuar një bord ekzekutiv për ri-integrim bashkë me grupet punuese përkatëse për të forcuar koordinimin e përpjekjeve për ri-integrim. Po ashtu, është miratuar rregullorja, e cila e qartëson rolin e zyrtarëve komunal të kthimit në procesin e ri-integrimit. Është krijuar një fond dhe janë ndarë 500,000 € për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Financimi i qëndrueshëm i ri-integrimit duhet të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Megjithatë, riintegrimi mbetet një sfidë dhe përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme nga autoritetet e Kosovës. Kapaciteti për ta trajtuar riintegrimin e të kthyerve me forcë duhet të forcohet. Komunikimi midis niveleve qendrore dhe komunale për ripranim është i pamjaftueshëm. Komunitet nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm njerëzor e financiar për të siguruar ndihmë të mjaftueshme për personat e riatdhesuar. Divizioni për të Huajt, Vizat dhe lejet e qëndrimit në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim ka ende nevojë për personel. Procesi i bartjes së detyrave administrative si lëshimi i lejeve të qëndrimit nga policia kufitare te Departamenti është në vazhdim e sipër. Për më tepër, promovimi i migrimit të ligjshëm dhe luftimi i migrimit të parregullt mbetet sfidë e madhe, edhe përkundër disa arrestimeve të emigrantëve të parregullt. Nuk ka objekte të përshtatshme të paraburgimit për emigrantët e parregullt apo azil-kërkuesit në pritje të dëbimit të tyre.

Në përgjithësi, Kosova ka filluar të merret me disa nga sfidat e migrimit, por edhe më tej është në fazën fillestare të procesit. Kërkesat për ripranim nga vendet Evropiane kanë vazhduar të trajtohen në mënyrë efektive nga autoritetet e Kosovës. Përpjekjet dhe kapacitetet e Kosovës për t'i riintegruar personat e riatdhesuar duhet të shtohen edhe më tej. Lufta kundër migrimit të parregullt dhe trajtimi i të huajve mbetet një sfidë kryesore për agjencitë relevante.

4.3.2. Pastrimi i Parave

Progres i kufizuar është arritur në trajtimin e krimit ekonomik/financiar dhe pastrimit të parave, i cili është një prioritet kyç i Partneriteti Evropian. Ligji kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është miratuar në shtator. Në qershor, Ministria për Ekonomi dhe Financa ka nënshkruar një marrëveshje teknike për transferimin e përgjegjësive të Qendrës së Inteligjencës Financiare nga EULEX-i te Njësia e Inteligjencës Financiare në Ministri, brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kosova duhet të jetë e gatshme për të marrë përsipër këtë obligim para se të bëhet transferimi.

Bashkëpunimi në mes të Shërbimit Doganor dhe Qendrës së Inteligjencës Financiare është përmirësuar. Gjithashtu, Qendra e ka përmirësuar bashkëpunimin me bankat. Është themeluar Drejtorati kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e. Hetuesit nga ky Drejtorat janë ricaktuar në task forcën speciale nën autoritetin e Zyrës së Prokurorisë Speciale. Në bashkëpunim me EULEX, një operacion ka nisur me qëllim të identifikimit të aktiviteteve ilegale që kanë të bëjnë me importin dhe eksportin e sasive të mëdha të parave të gatshme në aeroportin e Kosovës.

Megjithatë, në praktikë, kapaciteti i Kosovës për t'i hetuar dhe ndjekur krimet ekonomike mbetet i kufizuar. Shuma të mëdha vazhdojnë të investohen në pasuri të patundshme, restorante dhe kazino pa mbikëqyrje adekuate. Transaksionet financiare të biznesin të ekzekutuara në llogaritë private dhe një numër i madh i subjekteve që bëjnë biznes pa e regjistruar biznesin janë gjerësisht të përhapura. Janë bërë shumë pak hetime dhe asnjë nuk është përcjellë me ndjekje penale nga autoritetet e Kosovës në lidhje me pastrimin e parave dhe krimet e ngjashme.

Departamenti përkatës brenda Policisë së Kosovës nuk është kompletuar me kuadro ndërsa njësive rajonale iu mungon ekspertiza dhe pajisjet. Policia duhet të rrisë përpjekjet e saj në mënyrë të konsiderueshme për të trajtuar pastrimin e parave. Prokurorët dhe gjyqtarët nuk kanë ekspertizën e duhur financiare për të trajtuar e zgjidhur problemin. Burime të pamjaftueshme kanë qenë të dedikuara për çështje financiare në kuadër të Zyrës së Prokurorisë Speciale.

Duke pasur parasysh statusin heterogjen të OJQ-ve në Kosovë, mungesa e raportimit sistematik nga ana e zyrës për regjistrimin e OJQ-ve, brenda Ministrisë së Administratës Publike, te Qendra e Inteligjencës Financiare paraqet një shqetësim. Organizatat e biznesit

nuk i raportojnë sistematikisht te Qendra transaksionet me para në dorë më të larta se sa 10,000€. Ka mungesë transparence në lidhje me rezultatet e Qendrës. Përgatitje adekuate duhet të bëhen nga autoritetet e Kosovës për të siguruar funksionim efektiv të Qendrës nën autoritetin e Kosovës. Kosova duhet ta bëjë agjencinë plotësisht operacionale që t'i menaxhoj asetet e konfiskuara.

Në përgjithësi, pastrimi i parave mbetet një çështje e shqetësimit serioz dhe Kosova është në një fazë të hershme në këtë fushë. Kosovës edhe më tutje i mungojnë burimet e mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të qenë në gjendje të ballafaqohet me këtë krim të komplikuar. Në këto rrethana, Kosova duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme për të qenë e aftë që të merr përsipër përgjegjësitë e transferuara nga EULEX-i, që duhet të ndodh vetëm kur Kosova të jetë e gatshme.

4.3.3. Narkotikët

Kosova ka bërë një përparim të kufizuar në luftën kundër trafikut të drogës. Ato përfshijnë heroinën dhe drogat sintetike që vijnë nga Lindja e Mesme përmes Greqisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë si njëra nga rrugët kryesore të Ballkanit për tregjet Evropiane. Ekziston edhe një treg i brendshëm në rritje i marihuanës dhe narkotikëve të tjerë. Në Kosovë ka rritje edhe të prodhuesve të drogës. Grupet e krimit të organizuar që veprojnë në Kosovë janë të përfshirë në kontrabandimin e kokainës prej Amerikës Jugore në Evropë.

Sigurimi i dhomës së ruajtjes, nga e cila ishte vjedhur droga vitin e kaluar, është përmirësuar. Policia e Kosovës ka kryer një numër të operacioneve gjatë periudhës raportuese. Të gjitha njësitë hetuese rajonale të policisë për hetimet e narkotikëve janë centralizuar në një Drejtori kundër Trafikimit të Drogës. Kjo ka sjellë rezultate pozitive sa i përket rrjedhës së informacionit. Autoritetet kanë kryer një numër të trajnimeve për organet e zbatimit të ligjit dhe ngjarjeve të lidhura me ngritjen e vetëdijes së publikut për rreziqet e abuzimit me drogën.

Megjithatë, konfiskimet, arrestimet dhe aktvendimet e suksesshme gjyqësore mbeten në nivel të ulët në krahasim me sfidën me të cilën po ballafaqohet Kosova. Dobësitë në menaxhimin e kufirit, korrupsioni brenda agjencioneve të zbatimit të ligjit dhe mungesa e pajisjeve e pengojnë luftën kundër trafikimit të drogës. Pajisje të mirëfillta për kontrolle doganore që mundësojnë skanimin e kamionëve gjinden vetëm në një pikë të kalimit kufitar. Me gjithë rritjen e kapaciteteve, njësitë me qen nuk po shfrytëzohen në pikat kufitare. Pas grabitjes në dhomën e ruajtjes vitin e kaluar, rasti mbetet pezull dhe kryesit e veprës nuk janë gjetur. Nuk ka udhëzues të politikave për hetime të fshehta në lidhje me narkotikët. Aktivitetet që rrjedhin nga plani i veprimit kundër narkotikëve janë edhe më tej në fazën fillestare të zbatimit. Statistikat për konfiskimet, arrestimet, dhe ndjekjet penale nuk janë të besueshme. Ndarja e të dhënave me shumicën e vendeve fqinje është e dobët. Nuk ka mjaft policë Serb në Kosovë në forcat hetuese policore për narkotikë. Kapacitetet për hetimin e trafikimit të narkotikëve në Veri mbeten të kufizuara. Nuk ka plane gjithëpërfshirëse për menaxhimin e numrit në rritje të përdoruesve të drogës nga individë në burg.

Bashkëpunimi me Qendrën Mbikëqyrëse Evropiane për Narkotikë dhe Varësi të Narkotikëve ka filluar në vitin 2010. Kosova është e përkushtuar për ta zhvilluar bashkëpunimin me Qendrën. Planin e punës për aktivitete të përbashkëta është përgatitur dhe Raporti i parë i Vlerësimit i Nevojave të përbashkëta është përpiluar në korrik të vitit 2010.

Në përgjithësi, lufta e Kosovës kundër trafikut të drogës është edhe më tej në një fazë të hershme. Përpjekje serioze janë të nevojshme për ta adresuar këtë çështje.

4.3.4. Policia

Kosova ka bërë progres për sa i përket policisë. Një numër i udhëzimeve administrative në lidhje me ligjin për policinë janë miratuar (p.sh. në përdorimin e forcës, përdorimin e armëve

të zjarra apo procedurave promovuese). Policia e ka miratuar planin e saj zhvillimor strategjik për vitet 2010-2015. Ata kanë kontribuar në hartimin e strategjive të ndryshme si parandalimin e krimit, policinë e komunitetit dhe inteligjencës, kontrollin dhe mbledhjen e armëve të vogla e të lehta. Policia ka vazhduar të reagojë në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve, përfshirë konfiskimin e tyre. Kosova e ka miratuar një strategji për sistemin e integruar të menaxhimit të emergjencave. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të policisë ka lëshuar një numër të urdhëresave për operacione emergjente.

Policia e Kosovës ka marrë përsipër detyra të reja nga KFOR-i që solli sfida operationale të tilla si sigurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe sigurimi i kufirit me Shqipërinë. Policia e Kosovës e ka menaxhuar mirë sigurinë gjatë ceremonisë së emërimit të Patriarkut të Kishës Ortodokse Serbe. Marrëveshjet për bashkëpunim ndërkombëtar policor janë nënshkruar me Shqipërinë, Austrinë, Kroacinë, Francën dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Gjithashtu, policia e ka përmirësuar aftësinë e saj të kontrollit të turmave dhe trazirave. Rrjedha e informacionit brenda policisë është përmirësuar pas krijimit të njësive rajonale të centralizuara dhe pas ndryshimeve në zinxhirin komandues.

Përshkrimet e punës së menaxhmentit të lartë, duke përfshirë edhe për dy Zëvendësdirjtorët, janë miratuar dhe nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme së bashku me strukturën e re të policisë. Një sistem i ri i pagave për zyrtarët është miratuar, duke përfshirë shpenzimet shtesë të buxhetit.

Megjithatë, policia ka nevojë që ta ndërtoj inteligjencën policore të saj të aftë për ta trajtuar krimin serioz, pasi që efektshmëria e saj në trajtimin e krimeve të organizuara dhe komplekse vazhdon të jetë e kufizuar. Policia duhet të jetë më shumë pro-aktive në qasjen kundër krimit. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës duhet të azhurnohet për të shërbyer si një zgjidhje operationale e TI-së në përputhje me standardet e BE-së. Aktualisht, sistemi informativ i automjeteve në Kosovë nuk është i lidhur me këtë sistem që e kufizon punën e policisë në lidhje me rastet e automjeteve të vjedhura. EULEX-i ka qasje në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës. Megjithatë, limitet e vendosura në këtë qasje e komplikojnë ushtrimin e pavarur të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në disa raste.

Duke pasur parasysh përlllogaritjet për sasi të mëdha të armëve në posedim të publikut, policia duhet t'i shtoj aktivitetet e saj për t'i konfiskuar dhe shkatërruar ato. Përpjekjet në ndjekjen ligjore të krimeve të urrejtjes dhe ato etnike duhet të shtohen. Të gjitha komunat e sapo krijuara nuk janë të pajisura ende me stacione policore, ndërsa prania e policisë është ruajtur.

Greva në kuadër të policisë gjatë periudhës raportuese ka vënë në pah mangësi menaxheriale, sindikatat jofunksionale të punës dhe ndërhyrjet politike. Ristrukturimi i policisë është një proces sfidues që duhet të shoqërohet nga një rishikim gjithëpërfshirës të alokimit të resurseve. Në këtë kontekst, duhet të krijohet sistemi i treguesve i bazuar në performancë.

Mekanizmat disiplinor brenda policisë dhe mekanizmat mbikëqyrës të policisë duhet të forcohen. Korrupsioni, nepotizmi dhe ndërhyrjet politike mbesin çështje të shqetësimit serioz. Një ndarje më e mirë e përgjegjësive midis Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Njesisë për Standarde Policore është e nevojshme. Ushtruesi i detyrës së Drejtorit për Inspektoratin Policor të Kosovës, i emëruar rishtazi, duhet të kontribuoj në këto përpjekje. Gjithashtu, policia duhet t'i përmirësoj proceset e prokurimit me qëllim që të jetë plotësisht në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Bashkëpunimi ndërkombëtar policor është penguar nga rrethanat politike, duke e parandaluar Kosovën nga integrimi në mekanizmat bashkëpunues ndërkombëtar dhe rajonal. Kjo është një çështje shqetësuese pasi që zyrtarët policor ende nuk janë të autorizuar për të arrestuar,

përkohësisht, një person të kërkuar ndërkombëtarisht në bazë të njoftimit të lëshuar nga Interpol-i. EULEX-i vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm në lehtësimin e shkëmbimit të informacionit veçanërisht me Europol-in.

Në përgjithësi, Policia e Kosovës e ka menaxhuar mirë sigurinë e përgjithshme publike, ndonëse në situata të vështira. Ata kanë marrë përgjegjësi të shtuara në një numër fushash (p.sh., mbrojtjen e objekteve kulturore) dhe i kanë kryer ato në mënyrë profesionale. Megjithatë, në aspektin e kapaciteteve hetuese, aftësisë për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit apo ndonjë tipi tjetër kompleks të krimit dhe përdorimit të mjeteve dhe procedurave moderne, Policia e Kosovës mbetet në një fazë fillestare të zhvillimit.

4.3.5. *Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit*

Është arritur progres i kufizuar në luftimin e **krimit të organizuar**. Strategjia për parandalimin e krimit është aprovuar. Është miratuar Ligji për krimin kompjuterik i cili është në pajtueshmëri me standardet e BE-së. Janë emëruar edhe prokurorë special shtesë për t'u marrë me rastet e krimit të organizuar. Prokurorët special kosovar janë përfshirë në hetimin rasteve serioze të krimit të organizuar dhe krimit financiar dhe e kanë përfaqësuar Prokurorinë Speciale gjatë gjykimeve. Në disa raste, ata kanë punuar në ekipe të përziera me prokurorët special të EULEX-it të cilët po ashtu i kanë ushtruar funksionet e tyre ekzekutive në mënyrë të pavarur. Ekspertë nga Eurojust do ta vizitojnë Kosovën në javët në vijim. Ministria e Drejtësisë e ka miratuar strukturën organizative të agjencisë për menaxhimin e pasurisë kriminale të konfiskuar dhe të sekuestruar. Buxheti është ndarë dhe kryeshefi ekzekutiv po ashtu është emëruar. Megjithatë, agjencia ende nuk është bërë funksionale.

Kosova duhet të shtojë në masë të konsiderueshme edhe angazhimet e saja për luftimin e krimit të organizuar. Rrjetet kriminale të organizuara që janë aktive në Kosovë janë të përfshira në trafikimin ndërkombëtar të drogës, kontrabandën me emigrantë, trafikimin e automjeteve të vjedhura dhe armëve të zjarrit si dhe kontrabandën me cigare. Nuk ekziston ndonjë sistem adekuat për shpërblimin e informatorëve. Mungesa e kornizës për mbrojtjen e dëshmitarëve vazhdon t'i pengojë aktivitetet në këtë fushë. Ende nuk ekziston mundësia që telefonat mobil të njërit operator të përgjohen për qëllime hetimore. Drejtoratit të policisë kundër krimit të organizuar i mungojnë pajisjet. Ndërhyrjet politike dhe bashkëpunimi i dobët ndërmjet agjencive pengon luftimin efektiv të krimit të organizuar. Shërbimi Doganor dhe policia kufitare duhet ta përforcojnë kapacitetin e tyre për zbatimin e ligjit. Kosovës i mungojnë shënimet e regjistruara lidhur me krimin e organizuar. Është tepër shqetësues fakti se gatishmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovar për të marrë pjesë, madje edhe për të prirë në gjykimin e rasteve të korrupsionit apo të krimit të organizuar nganjëherë paralizohet nga kërcënimet kundër tyre apo familjeve të tyre.

Në përgjithësi, nevojiten angazhime të pandërprera, të mbështetura nga një vullnet i qartë politik, që të luftohet krimi i organizuar që mbetet një çështje mjaft brengosëse dhe që ndikon në sundimin e ligjit dhe në mjedisin e biznesit. Në veri, përpjekjet e policisë dhe të gjyqësorit mbesin të penguara nga situata politike.

Ka pasur progres të kufizuar në luftimin e **trafikimit të qenieve njerëzore**. Kosova mbetet vendi i origjinës, transitit dhe destinacionit të viktimave të trafikimit për eksploatim komercial seksual. Grupi ndërministror ka vazhduar të takohet një herë në muaj. Në një rast të kohëve fundit, Policia e Kosovës ka reaguar mirë ndaj një kërkesë të Interpolit lidhur me një rast të trafikimit. Ka pasur një numër arrestimesh që ndërldihen me rastin e trafikimit të qenieve njerëzore përgjatë lumit Tisa. Standardet minimale për përkujdesje ndaj viktimave të trafikimit janë aprovuar. Janë bërë angazhime në fushën e parandalimit me anë të një fushate informuese në institucionet arsimore dhe në vendkalimet kufitare, duke përfshirë edhe aeroportin. Numri i dënimeve ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës raportuese.

Megjithatë, numri i viktimave të identifikuara të trafikimit mbetet i vogël dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë shkallën e këtij fenomeni edhe pse ka pasur një rënie në numrin e personave të trafikuar në tërë regjionin. Shumica e viktimave kanë qenë femra vendore të trafikuar për qëllime seksuale. Trafikimi i fëmijëve dhe eksploatimi i tyre për lypje të detyrueshme është një problem në rritje. Kapaciteti i institucioneve të Kosovës për të hetuar, ndjekur penalisht, gjykuar dhe dënuar trafikimin e qenieve njerëzore duhet të forcohet më tepër. Niveli i dënimit të kryesve të veprave nuk është gjithmonë adekuat. Janë kryer një numër operacionesh policore dhe bastisjesh të objekteve gjatë periudhës raportuese, por rezultatet janë të kufizuara. Njësitë e policisë rajonale kanë vazhduar të ballafaqohen me

vështirësi në identifikimin e viktimave të supozuara. Ekzistojnë procedura që viktimave u mundësojnë të japin dëshmi anonime, por frikësimi i dëshmitarëve ka mbetur një problem serioz dhe mbrojtja e dëshmitarëve nuk ekziston fare. Vetëm një numër i vogël i viktimave kanë ndihmuar në hetimin e trafikantëve të tyre gjatë periudhës raportuese. Korrupsioni i ndërlidhur me trafikimin gjithashtu duhet të adresohet. Ekzistojnë disa objekte për strehimin e viktimave, por shërbimet e ri-integrimit mbesin të fragmentuara.

Në përgjithësi, angazhimet e Kosovës për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore ndodhen në fazën e hershme dhe duhet të bëhet shumë më tepër. Në veçanti, veprimet gjyqësore pas operacioneve të policisë janë joefektive dhe kryesit e veprave duhet të marrin dënimin e merituar. Kosova duhet t'i rrisë veprimet e veta në identifikimin dhe ofrimin e ndihmës për të gjitha viktimat, duke përfshirë ato të trafikuar për punë të detyrueshme dhe për lypje të detyrueshme.

Kosova ka arritur pak progres në **luftimin e terrorizimit**. Është rritur kapaciteti i njësisë kundër terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës. Është miratuar ligji kundër shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Terrorizmi është përfshirë në strategjinë nacionale të sigurisë të aprovuar gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, kapacitetet operative të policisë mbesin të vogla dhe janë arritur vetëm pak rezultate praktike.

Në përgjithësi, Kosova mbetet në fazën e hershme të të qenit në gjendje të luftojë terrorizimin në mënyrë strategjike.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Kosova ka arritur progres të kufizuar në mbrojtjen e të dhënave personale. Në muajin prill, Kosova ka miratuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Kosova gjithashtu i ka emëruar anëtarët e agjencisë nacionale për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, agjencia nuk është funksionale. Parimet e përcaktuara në kornizën ligjore kanë nevojë për rregullime të mëtejshme, veçanërisht në mbrojtjen e të dhënave në sektorin e zbatimit të ligjit. Themelimi i organeve të sigurisë, inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit dhe përmirësimi i bazave të të dhënave nuk është përcjellë me masa paralele për mbrojtjen e të dhënave. Rishikimi adekuat i implikimeve të ligjit të ri në agjencitë e ndryshme në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme nuk është bërë ende. Personat në Kosovë nuk njoftohen për të drejtat e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

Në përgjithësi, mungesa e mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë është një çështje shumë shqetësuese. Krijimi i mbrojtjes adekuate të të dhënave personale është qelës për ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Kosova ka ende shumë angazhime për të bërë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Shtojca statistikore

Të dhënat statistikore (deri me 14 tetor 2010)

Kosova sipas Rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Të dhënat themelore

| | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Popullsia (në mijëra) | | : | : | : | 1 985 | 2 016 | 2 041 | 2 100 | 2 127 | 2 153 | 2 181p |
| Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km ²) | | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 |

Llogaritë kombëtare

| | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|-------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Bruto produkti vendor (GDP) (në milion të valutës kombëtare) | 1) | : | 1 624 | 1 735e | 1 797e | 3 007e | 3 068e | 3 192e | 3 434e | 3 841e | 3 902p |
| GDP (në milion euro) | 1) | : | 1 624 | 1 735e | 1 797e | 3 007e | 3 068e | 3 192e | 3 434e | 3 841 | 3 902p |
| GDP (euro për kokë banori) | | : | : | : | 905e | 1473e | 1 482e | 1 520e | 1 612e | 1 784e | 1 790p |
| GDP (në Standardet e Fuqisë Blerëse (SFB për kokë banori) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| GDP për kokë banori në SFB (EU-27 = 100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Rritja e normës reale të GDP (norma e rritjes së vëllimit të GDP, valuta kombëtare, % ndryshimi nga viti paraprak) | | : | : | 1.2e | 3.1e | : | : | : | : | : | : |
| Rritja e punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshimi nga viti paraprak) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Rritja e produktivitetit të punës: rritja e GDP për persona të punësuar (% ndryshimi nga viti paraprak) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Rritja reale e çmimit të njësisë së punës (llogaritë kombëtare, % ndryshimi nga viti paraprak) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Rritja e produktivitetit të punës për persona të punësuar (GDP në SFB për person të punësuar, EU-27 = 100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesor (%) | | | | | | | | | | | |
| Bujqësi dhe peshkatori | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Industri | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Ndërtimtari | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Shërbimet | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Shpenzimet përfundimtare të konsumit, si pjesë e GDP (%) | | : | 163.1 | 151.6 | 147.5 | 109.7e | 111.9e | 111.5e | 114.0e | 112.8e | 109.9p |
| Krijimi i bruto kapitalit fiks, si pjesë e GDP (%) | 2) | : | 40.7 | 34.5 | 29.3 | 19.4e | 19.3e | 20.6e | 21.7e | 24.4e | 26.3 |
| Ndryshimet në inventarë, si pjesë e GDP (%) | | : | : | : | : | 3.9 | 4.2 | 4.4 | 4.3e | 4.1e | 3.6 |
| Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në lidhje me GDP (%) | | : | 16.6 | 12.5e | 10.4e | 7.1e | 7.0e | 8.9e | 10.4e | 13.8e | 15.5p |
| Importet e mallrave dhe shërbimeve, në lidhje me GDP (%) | | : | 120.4 | 98.6e | 87.1e | 40.1e | 42.5e | 45.5e | 50.3e | 55.1e | 55.4p |

Industria

| | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |

Norma e inflacionit

| | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Norma vjetore mesatare e inflacionit (IÇK, % ndryshimi nga viti paraprak) | | : | : | -1.0 | 0.3 | -0.8 | -2.1 | -1.5 | 2.8 | 12.4 | 9.7 |

| Bilanci i pagesave | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Bilanci i pagesave: totali i llogarisë rrjedhësve (milion euro) | | : | 228 | -104 | -204 | -209 | -248 | -226 | -331 | -602 | -642 |
| Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: bilanci tregtar (milion euro) | | : | -646 | -890 | -941 | -983 | -1 079 | -1 173 | -1 368 | -1 668 | -1 690 |
| Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: shërbimet neto (milion euro) | | : | 10 | -23 | -14 | -18 | -8 | 29 | 51 | 82 | 172 |
| Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: të hyrat neto (milion euro) | | : | 141 | 154 | 152 | 138 | 139 | 159 | 186 | 156 | 70 |
| Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: transferet rrjedhëse neto (milion euro) | | : | 723 | 655 | 599 | 655 | 700 | 759 | 800 | 829 | 806 |
| nga të cilat transferet qeveritare (milion euro) | | : | 809 | 661 | 490 | 372 | 348 | 320 | 301 | 289 | 319 |
| Investimet e huaja direkte neto (IHD) (milion euro) | | : | : | : | : | 43 | 108 | 289 | 431 | 341 | 278 |
| Investimet e huaja direkte neto (IHD) jashtë vendit (milion euro) | 3) | : | : | : | : | 0 | 0 | -6 | -10 | -25 | -10 |
| nga të cilat IHD të ekonomisë raportuese në vendet EU-27 (milion euro) | | : | : | : | : | : | : | : | 0 | 2 | 1 |
| Investimet e huaja direkte neto (IHD) në ekonominë raportuese (milion euro) | 3) | : | : | : | : | 43 | 108 | 295 | 441 | 366 | 288 |
| Nga të cilat IHD të vendeve të EU-27 në ekonominë raportuese (milion euro) | | : | : | : | : | : | : | : | 72 | 64 | 66 |

| Financat publike | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Deficiti/suficiti i përgjithshëm qeveritar, në lidhje me GDP (%) | | : | : | 8.4 | 2.2 | 2.7 | : | : | : | : | : |
| Borxhi i përgjithshëm qeveritar, në lidhje me GDP (%) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |

| Treguesit financiar | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Borxhi i huaj bruto i tërë ekonomisë, në lidhje me GDP (%) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Borxhi i huaj bruto i tërë ekonomisë, në lidhje me eksportet e përgjithshme (%) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Furnizimi me para: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat e mbrëmjes, milion euro) | 4) | 761 | 971 | 998 | 891 | 713 | 572 | : | : | : | : |
| Furnizimi me para: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vite, milion euro) | 4) | 761 | 1 096 | 1 126 | 1 111 | 1 128 | 1 092 | : | : | : | : |
| Furnizim me para: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion euro) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Kreditë e përgjithshme nga institucionet monetare financiare për rezidentët (të konsoliduara) (milion euro) | | 3 | 26 | 87 | 233 | 374 | 514 | 637 | 892 | 1 183 | 1 289 |
| Norma e interesit: norma ditore e interesit, norma vjetor (%) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Norma e interesit të huadhënies (një vit), vjetore (%) | 5) | : | : | : | : | 14.7 | 14.4 | 14.5 | 14.6 | 14.8 | 14.1 |
| Norma e interesit të depozitave (një vit), vjetore (%) | 5) | : | : | : | : | 2.8 | 2.9 | 3.0 | 3.3 | 4.2 | 4.0 |
| Norma e këmbimit të euros: mesatare për periudhë - 1 € = ... valuta kombëtare | 1) | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 |
| Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2000=100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Vlera e mjeteve rezervë (duke përfshirë arin) (milion euro) | | 62 | 296 | 337 | 423 | 311 | 278 | 356 | 647 | 670 | 501 |

| Tregtia e jashtme | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|---------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro) | | : | : | : | : | 1 050.4 | 1 180.0 | 1 314.6 | 1 576.1 | 1 930.0 | 1 933.8 |
| Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro) | | : | : | : | : | 56.6 | 48.9 | 81.7 | 147.3 | 196.4 | 165.3 |
| Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro) | | : | : | : | : | -993.8 | -1 131.1 | -1 232.9 | -1 428.8 | -1 733.6 | -1 768.5 |
| Kushtet e tregtisë (indeksi i çmimit të eksportit /indeksi i çmimit të importit) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Pjesëmarrja e eksportit në vendet e EU-27 në vlerën e eksporteve të përgjithshme (%) | | : | : | : | : | 29.3 | 37.9 | 35.7 | 42.6 | 47.7 | 43.1 |
| Pjesëmarrja e importit nga vendet e EU-27 në vlerën e importeve të përgjithshme (%) | | : | : | : | : | 40.3 | 38.4 | 34.2 | 35.2 | 36.2 | 39.0 |

| Demografia | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Norma e rritjes natyrale, ndryshimi natyral (lindjet minus vdekjet) (në 1000 banorë) | | : | : | : | 12.8 | 14.1 | 14.5 | 12.6 | 12.4 | 12.7 | 12.5 |
| Norma e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një vjeçare për 1000 lindje të gjalla | | : | : | 11.2 | 15.1 | 11.8 | 9.6 | 12.7 | 11.1 | 9.8e | 8.4p |
| Jetëgjatësia e parashikuar : mashkull (vitet) | | : | : | : | 67.0 | : | : | : | : | : | : |
| Jetëgjatësia e parashikuar: femër (vitet) | | : | : | : | 71.0 | : | : | : | : | : | : |

| Tregu i punës | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Norma e aktivitetit ekonomik (15-64): pjesa e popullsisë në moshën 15-64 e cila është ekonomikisht aktive (%) | | : | 45.6 | 52.8 | 50.3 | 46.2 | 49.2 | 52.3 | 46.8 | 46.2 | 48.1 |
| Norma e punësimit (15-64): pjesa e popullsisë në moshën 15-64 e cila është e punësuar(%) | | : | 19.6 | 23.8 | 25.3 | 27.7 | 28.5 | 28.7 | 26.2 | 24.1 | 26.1 |
| Norma e punësimit të meshkujt (15-64) (%) | | : | 31.1 | 39.4 | 42.8 | 46.4 | 45.8 | 46.1 | 40.1 | 37.7 | 39.7 |
| Norma e punësimit të femrat (15-64) (%) | | : | 8.1 | 8.8 | 8.3 | 9.9 | 11.7 | 11.8 | 12.7 | 10.5 | 12.5 |
| Norma e punësimit të punëtorëve të vjetër (55-64): pjesa e popullsisë në moshën 55-64 e cila është e punësuar (%) | | : | 16.7 | 18.4 | 20.1 | 23.9 | 25.2 | 26.3 | 24.6 | 23.8 | 27.9 |
| Punësimi sipas sektorëve kryesor (%) | | | | | | | | | | | |
| Bujqësi | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Industri | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Ndërtimtari | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Shërbime | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Norma e papunësisë: pjesa e fuqisë punëtore që është e papunësuar (%) | | : | 57.1 | 55.0 | 49.7 | 39.7 | 41.4 | 44.9 | 43.6 | 47.5 | 45.4 |
| Pjesa e fuqisë punëtore të meshkujt që është e papunësuar (%) | | : | 51.8 | 45.2 | 40.3 | 31.5 | 32.9 | 34.6 | 38.5 | 42.7 | 40.7 |
| Pjesa e fuqisë punëtore të femrat që është e papunësuar (%) | | : | 69.9 | 74.5 | 71.9 | 60.7 | 60.5 | 61.6 | 55.2 | 59.6 | 56.4 |
| Norma e papunësisë së personave< 25 vite: pjesa e fuqisë punëtore në moshën <25 e cila është e papunësuar (%) | | : | 80.0 | 77.7 | 74.9 | 66.5 | 70.5 | 75.5 | 70.0 | 73.0 | 73.0 |
| Norma e papunësisë afatgjatë: pjesa e fuqisë punëtore e cila është e papunësuar për 12 apo më shumë muaj (%) | | : | 47.6 | 47.3 | 42.7 | 34.9 | 34.7 | 41.1 | 37.1 | 38.9 | 37.1 |

| Kohezioni social | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|---------|---------|------|---------|---------|---------|---------|---------|------|
| Pagat dhe pagesat mujore nominale mesatare (valuta kombëtare) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Indeksi i pagave dhe pagesave reale (indeksi i pagave dhe pagesave nominale pjesëtuar me IÇK) (2000=100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Personat që lënë shkollën para kohe – Pjesa e popullsisë në moshën 18-24 shumica me shkollim të mesëm të ulët dhe që nuk ndjekim ndonjë shkollim apo trajnim të mëtejshëm (%) | | : | 5 304.0 | 5 005.0 | : | 3 011.0 | 2 988.0 | 2 195.0 | 2 124.0 | 2 530.0 | : |

| Standardi i jetesës | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|-------|-------|------|------|------|-------|-------|
| Numri i veturave të udhëtarëve për 1000 banorë | | : | : | : | : | : | 50.2 | 69.9 | 68.7 | 74.1 | : |
| Numri i abonimeve për shërbimet e telefonave celular për 1000 banorë | | : | : | : | 158.7 | 169.5 | : | : | : | 376.2 | 369.1 |

| Infrastruktura | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Densiteti i rrjetit të hekurudhave (linjat në funksion, për 1000 km ²) | | : | : | : | : | 39.5 | : | : | : | : | : |
| Gjatësia e rrugëve automobilistike (mijëra km) | | : | : | : | : | : | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |

| Zbulimet dhe kërkimet | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Shpenzimet në burimet njerëzore (shpenzimet publike për arsim në % të GDP) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Shpenzimet e brendshme bruto për zbulime dhe kërkime në % të GDP | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Përqindja e ekonomive familjare që kanë qasje në internet në shtëpi (%) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |

| Ambienti | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Lirimet e gazit në atmosferë, CO2 baras me (tonë, 1990=100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg e naftës baras me 1000 € GDP) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Energjia e gjeneruar nga burimet natyrore në % të bruto konsumit të energjisë | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Transporti i brendshëm i mallrave përmes rrugëve (% e tonave-km) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |

| Energjia | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|--------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Prodhimi primar i të gjitha produkteve energjike (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Prodhimi primar i antracit dhe linjtit (mijëra TOE) | 6) | : | : | 3 853 | 4 507 | 3 944 | 4 455 | 4 553 | 4 681 | 5 466 | 7 842 |
| Prodhimi primar i gazit natyror (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Importet neto të të gjitha produkteve energjike (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Bruto konsumi i brendshëm i energjisë (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Prodhimi i energjisë (Mijëra GWh) | | : | : | 3.2 | 3.2 | 3.5 | 4.0 | 4.0 | 4.3 | : | 5.3 |

| Bujqësia | Shënim | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor të mallrave dhe shërbimeve (çmimet e prodhuesit, viti paraprak=100) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së punueshme bujqërisë (mijëra hektarë) | | : | 539 | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Bagëti: gjedha (mijëra kokë, fundit i periudhës) | | 289 | 347 | 319 | : | 335 | 352 | 382 | 322 | 342e | : |
| Bagëti: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës) | | 59 | 75 | 110 | : | 55 | 47 | 68 | 40 | 27e | : |
| Bagëti: dele dhe dhi (mijëra kokë, fundi i periudhës) | | 193 | 230 | 116 | : | 106 | 152 | 113 | 152 | 180e | : |
| Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në fermë (sasia e përgjithshme e qumështit, mijëra tonë) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Të mbjellat bujqësore: drithërat, (duke përfshirë orizin) (mijëra tonë, prodhimet e mbledhura) | | : | 459 | 396 | : | 408 | 441 | 392 | 295 | 438e | : |
| Të mbjellat bujqësore: panxhar sheqeri (mijëra tonë, prodhimet e mbledhura) | | : | : | : | : | : | : | : | : | : | : |
| Të mbjellat bujqësore: perimet (mijëra tonë, prodhimet e mbledhura) | | : | 169 | 135 | : | 150 | 159 | 172 | 117 | 177e | : |

: = nuk janë në dispozicion

p = vlera e përkohshme

e = vlera e llogaritur

1) Nuk ekziston ndonjë valutë zyrtare kombëtare. Euro është valutë në përdorim.

2) Investimi: duke përfshirë sektorin e donatorëve, qeverinë e përgjithshme, investimin privat (ndërtim dhe të tjera).

3) Janë shfrytëzuar parimet e shenjave të bilancit të pagesave. Për IHD jashtë vendit shenja minus nënkupton se investimi jashtë vendit nga ekonomia raportuese e ka tejkaluar mos-investimin në këtë periudhë, ndërsa shënimi pa shenjë nënkupton se mos-investimi e ka tejkaluar investimin. Për IHD në ekonominë raportuese shënimi pa shenjë nënkupton se investimin në ekonominë raportuese e ka tejkaluar mos-investimin, ndërsa shenja minus tregon se mos-investimi e ka tejkaluar investimin.

4) Sektori bankar në Kosovë në vitin 2000 ishte në fazën fillestare të themelimit të tij. Prandaj, të gjitha depozitat në bankat komerciale në atë kohë kanë qenë të transferueshme.

5) Që nga janari i vitin 2008 norma e interesit për kredi përfshinë edhe tarifën e disbursimit që caktohet nga bankat.

6) Të dhëna të mbledhura nga Korporata Energjetike e Kosovë (KEK).